- IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Individ i shëndoshë

- V.5. Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Qytetar i përgjegjshëm

- VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar

Rezultatet e fushës së kurrikulës**3. Komunikimi në/përmes matematikës**

- 3.1. Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore.
- 3.2. Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën, duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor;
- 3.3. Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.
- 3.4. Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.
- 3.5. Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.
- 3.6. Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi punë.

Tema: Sipërfaqja**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:****Komunikues efektiv**

- I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup, në një kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Mendimtar kreativ

- II.1. Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
- II.7. Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës, në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

Nxënës i suksesshëm

- III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si: letrën, plastelinën, shkopinjte, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
- III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.3. Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
- III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- III.6. Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale

Kontribuues produktiv

IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

Individ i shëndoshë

V.5. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj

Qytetar i përgjegjshëm

VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e fushës së kurrikulës

1.Zgjidhja e problemeve:

1.1. Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta.

6. Modelimi matematik

6.1. Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.

6.2. Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive.

6.3. Krijon modele të thjeshta, duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme.

6.4. Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore, duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës :

Komunikues efektiv

I.1 Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruar, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.

I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup, në një kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Mendimtar kreativ

II.1. Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe më pas krahason në grup, gjetjet e veta.

- II.4. Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër. Përshkruan pozitat që zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
- II.7. Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës, në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

Nxënës i suksesshëm

- III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si: letrën, plastelinën, shkopinjte, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
- III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.3. Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
- III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- III.6. Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kontribuues produktiv

- IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
- IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Individ i shëndoshë

- V.2. Merr pjesë në aktivitete fizike (si, rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, bën lojë të ndershme, si dhe menaxhon emocionet e veta si në rast fitoreje apo humbjeje (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
- V.5. Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Qytetar i përgjegjshëm

- VI.2. Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit, vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si: rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
- VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar

Rezultatet e fushës së kurrikulës

1. Zgjidhja e problemeve:

1.1. Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta.

2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike:

2.1. Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve.

2.3. Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.

3. Komunikimi në/përmes matematikës

3.3. Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.

3.4. Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.

3.5. Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.

3.6. Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune.

6. Modelimi matematik

6.1. Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.

6.2. Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive.

Tema: Modelet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës

Komunikues efektiv

I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup, në një kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Mendimtar kreativ

II.2. Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore), me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.

II.7. Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

Nxënës i suksesshëm

- III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
- III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.6. Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kontribuues produktiv

- IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
- IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Individ i shëndoshë

- V.5. Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Qytetar i përgjegjshëm

- VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar

Rezultatet e fushës së kurrikulës**6. Modelimi matematik**

- 6.1. Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.
- 6.2. Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive.
- 6.3. Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme.
- 6.4. Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situatë konkrete.

Tema: Shprehjet shkronjore

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës

Komunikues efektiv

- I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup, në një kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Mendimtar kreativ

II.2. Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.

Nxënës i suksesshëm

III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër, për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

Kontribuues produktiv

IV.2. Kontrollon mjetet/materiallet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Individ i shëndoshë

V.5. Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Qytetar i përgjegjshëm

VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e fushës së kurrikulës

2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike:

2.1. Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve.

2.2. Zbaton shprehi të arsytimit për të bërë hamendësime.

2.3. Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.

Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës

Komunikues efektiv

I.1 Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.

I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup, në një kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Mendimtar kreativ

II.2. Sqaron me anë të të folurit, procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore), me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore

Nxënës i suksesshëm

III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër, për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

Kontribuues produktiv

IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Individ i shëndoshë

V.5. Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Qytetar i përgjegjshëm

VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar

Rezultatet e fushës së kurrikulës**1.Zgjidhja e problemeve:**

- 1.1. Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta.
- 1.3. Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë.
- 1.4. Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave.
- 1.5. Bën vrojtime dhe hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.

8. Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë

- 8.1. Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.
- 8.2. Përdor kalkulatorin për të verifikuar saktësinë e zgjidhjes së problemit.

Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës

Komunikues efektiv

I.1 Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.

I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup, në një kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Mendimtar kreativ

II.1. Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.

II.2. Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore), me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.

II.7. Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

Nxënës i suksesshëm

III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si: letrën, plastelinën, shkopinjte, ngjyrat, numëroren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.

III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër, për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

III.3. Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.

III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemën, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

III.6. Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kontribuues produktiv

IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Individ i shëndoshë

V.2. Merr pjesë në aktivitete fizike (si, rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, bën lojë të ndershme, si dhe menaxhon emocionet e veta në rast fitoreje apo humbjeje (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).

V.5. Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Qytetar i përgjegjshëm

- VI.2. Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si: rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
- VI.3. Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
- VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e fushës së kurrikulës**1.Zgjidhja e problemeve:**

- 1.1. Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta.
- 1.2. Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme.
- 1.3. Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë.
- 1.4. Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave.
- 1.5. Bën vrojtime dhe hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.

2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike:

- 2.1. Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve.
- 2.2. Zbaton shprehje të arsyetimit për të bërë hamendësime.

Tema: Puna me të dhëna**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës****Komunikues efektiv**

- I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup, në një kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Mendimtar kreativ

- II.2. Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore), me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
- II.7. Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

Nxënës i suksesshëm

- III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si: letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
- III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.6. Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kontribuues produktiv

- IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
- IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Individ i shëndoshë

- V.5. Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Qytetar i përgjegjshëm

- VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e fushës së kurrikulës

6. Modelimi matematik

- 6.1. Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.
- 6.2. Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive.
- 6.3. Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme.
- 6.4. Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

7. Strukturimi i të menduarit matematik: Ndërton strukturat themelore

- 7.1. Relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtë shkollor.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
Orientimi (2 orë)	Përshkruan rrugën nga një vend (pikënisja) në një vend tjetër (pikëarritja) dhe anasjelltas;	Vendndodhja Lëvizja dhe vendndodhja Brenda-jashtë Aktivitetet: Brenda-jashtë	(46 orë)	Mësimdhënia dhe të nxënimit me fëmijën në qendër dhe gjithëpërfshirja Mësimdhënia dhe të nxënimit e integruar Mësimdhënia dhe të nxënimit e bazuar në arritjen e kompetencave Mësimdhënia dhe të nxënimit e diferencuar Teknikat: Teknika e pyetjeve DRTA <i>Brainstorming</i> Mendo-Puno në çift- Ndaj me të tjerët Mësimdhënia reciproke	Vlerësimi i vazhdueshëm Prezantime me gojë, Pjesëmarrja në aktiviteve, Vlerësimi me shkrim ose testimi Vlerësimi i ndërrojellë Portofolio Listë kontrolli Vëzhgim Semafori Informata kthyesë Turi i galerisë Dy yje, një dëshirë Rubrika Kontrolli para fluturimit	Gjuhë amtare Shoqëria dhe mjedisi Shkathësi për jetë Edukatë figurative Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Çështjet ndërkurrikulare Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Edukimi për paqe Globalizmi dhe ndërmarrësia	Libri dhe fletore pune “Matematika 1”. Lidhëza nga interneti
Sipërfaqja (2 orë)	Ngjyros sipërfaqet brenda figurave të ndryshme (katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi, rrethi); Dallon sipërfaqen brenda, jashtë dhe në figurë.	Cilësia e përbashkët Krahasimi i bashkësive Cilësitë e përbashkëta Diagrami i Venit Aktivitetet: Bashkësitë					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
Bashkësitë dhe relacionet (5 orë)	<p>Përshkruan bashkësinë si një grumbull objektësh;</p> <p>Identifikon objektet që janë brenda ose jashtë bashkësisë;</p> <p>Paraqet bashkësinë përmes diagramit të Venit;</p> <p>Krijon bashkësi bazuar në cilësitë e objekteve (elementeve);</p> <p>Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet: më shumë, më pak, aq sa;</p> <p>Shoqëron objektet (elementet) e një bashkësie të dhënë me objektet (elementet) e një bashkësie tjetër;</p> <p>Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna.</p>	<p>Krijimi i modeleve</p> <p>Aktivitetet: Krijimi i modeleve</p> <p>Shprehjet numerike</p> <p>Shprehjet shkronjore</p> <p>Aktivitetet: Shprehjet numerike dhe shkronjore</p> <p>Barazime dhe jobarazime</p> <p>Jobarazimet</p>		<p>Të nxënit në bashkëpunim</p> <p>Lexo në çift/</p> <p>Përmblihdh në çift</p> <p>Mendo/Puno në çift/Shkëmbe mendime</p> <p>Turi i Galerive</p> <p>Mbledhja e të dhënave</p> <p>Pema e mendimeve</p> <p>Bashkëbisedim</p>			

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
Modellet (2 orë)	Vizaton figurën e radhës duke vëzhguar vargun e figurave paraprake; Modelon katrorin dhe drejtkëndëshin me plastelinë dhe mjete të tjera; Klasifikon objektet sipas vetive të tyre;	Jobarazimet Aktivitete me barazime dhe jobarazime					
Shprehjet shkronjore (3 orë)	Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike; Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave; Modelon problema me shprehje shkronjore;	Krahasimi i gjatësive Matja e gjatësive Aktivitete: Matja e gjatësive Centimetri, metri Më i rëndë, më i lehtë Aktivitete: Më i rëndë, më i lehtë Krahasimi i peshave. Kilogrami.					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
Ekuacionet dhe inekuacionet lineare (4 orë)	Zgjidh probleme nga jeta e përditshme duke shfrytëzuar shprehjet shkronjore; Shndërron shprehjet me simbole në shprehje me fjalë dhe anasjellas; Identifikon mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur (numra nga 1 deri në 20); Zgjidh probleme me fjalë duke përdor numrat nga 1 deri në 20 Përkufizon ekuacionet (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe zgjidhjet përkatëse të tyre;	Aktivitetet: Krahasimi i peshave Ngjarje brenda ditës Koha dhe ora Aktivitetet: Dita ime në orë të caktuara Koha dhe ditët e javës Muajt e vitit Aktivitetet: Ditët e javës dhe muajt e vitit Monedhat Problema Aktivitetet: Shitorja në klasë Vëllimi Klasifikimi dhe regjistrimi i të dhënave Aktivitetet:					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
Njësitë matëse (18 orë)	<p>Zgjidh ekuacione dhe inekuacione lineare me një të panjohur (duke përdorur vetitë aditive dhe multiplikative);</p> <p>Gjen bashkësinë e zgjidhjeve të jobarazimeve (numra nga 1 deri në 20);</p> <p>Zgjidh probleme të thjeshta nga jeta, duke shfrytëzuar ekuacionet dhe inekuacionet.</p> <p>Mat gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde (pëllëmba e dorës, hapi, lapsi, shkopinjtj.).</p> <p>Krahason drejtpërdrejt objekte sipas gjatësisë, duke përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtër po aq;</p>	<p>Klasifikimi dhe regjistrimi i të dhënave</p> <p>Grafikët dhe interpretimi i të dhënave</p> <p>Aktivitetet: Grafikët dhe interpretimi i të dhënave</p> <p>E mundur, e pamundur</p> <p>Aktivitetet: E mundur e pamundur</p>					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
	<p>Krahason me sy gjatësitë e dy ose më shumë sendeve; Bën lidhje ndërmjet numrave dhe matjeve; Vlerëson dhe radhit objektet sipas madhësiave; Krahason drejtpërdrejt objekte sipas peshës duke përdorur shprehjet; më i rëndë, më i lehtë, po aq; Përdor njësi matëse standarde si: m, cm, kg, orë, ditë, javë, muaj, vit dhe të monedhave; Orientohet në kohë duke përdorur fjalët e duhura (p.sh., dje, para një jave, tani, nesër, pas disa ditësh pas dy muajsh etj.) në përcaktimin e kohës së shkuar, të tashme ose të ardhme;</p>						

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
	<p>Rendit ditët e javës, muajt e vitit;</p> <p>Rendit ngjarje që kanë lidhje me jetën e tyre të përditshme, brenda një periudhe kohore prej një dite, disa ditësh, disa muajsh;</p> <p>Përdor terminologjinë përkatëse (“më i rëndë”, “më i lehtë”, “po aq i rëndë”, “më i rëndi”, “më i lehti”), për të shprehur masën e sendeve nga jeta e tij e përditshme;</p> <p>Demonstron peshimin me anë të balancës duke përdor sende të ndryshme;</p> <p>Përdor monedhat, nga 1€ deri në 20€ për të llogaritur çmime e sendeve nga jeta e tij e përditshme;</p>						

TEMA 1: NUMRAT DHE NUMËRIMI DERI NË 10

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1,3; II. 1,2,7; III. 1,2,3,4,6; IV. 2,5; V. 2,5; VI. 2,3,6.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 1.1 Unë do të mësoj...		Fjalët kyçe: numër, ngjyrë, figurë.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore			
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - tregon se çfarë do të mësojë në të ardhmen; - ngjyros figurat e dhëna sipas dëshirës; - numëron figurat e dhëna në foto; - lidh grupin e gjësendeve me numrin që i përgjigjet. 			
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> - ngjyros figurat e dhëna në tekst, sipas dëshirës; - numëro figurat e dhëna në çdo grup; - lidh grupin me numrin që i përgjigjet. 			
Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: makina, kukulla, zare, numra në kube, ngjyra etj.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi rreth familjes dhe anëtarëve të saj), Edukatë figurative (ngjyrosja e figurave në libër).			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
Hapi 1 Mësuesi/ja u parashtron nxënësve pyetjen:			
<ul style="list-style-type: none"> • Çfarë do të mësoni nga lënda e matematikës, në klasën e parë? <p>Duke u bazuar në përgjigjet e nxënësve, zhvillon një diskutim me ta rreth lëndës së matematikës dhe rëndësinë e saj në jetën tonë. Fillojmë të krijojmë perceptimin te nxënësit, që matematika është pjesë e jetës dhe që ajo na e bën secilën punë më të lehtë.</p>			
Hapi 2 Nxënësit punojnë në libër detyrën e dhënë. Udhëzohen nxënësit të hapin librat dhe të vrojtojnë figurat.			

Pyeten se çfarë dinë rreth tyre dhe më pas udhëzohen t'i ngjyrosin sipas dëshirës.

Rëndësi të veçantë i kushton mënyrës se si nxënësit ngjyrosin, u kujtojmë që figurat e dhëna janë pjesë e matematikës dhe me to do të punojmë vazhdimisht.

Gjatë gjithë kohës që nxënësit kryejnë detyrën, mësuesi/ja i vëzhgon dhe bashkëbisedon rreth punës së bërë.

Hapi 3 Udhëzohen nxënësit të nxjerrin gjësendet nga kutitë

Udhëzohen nxënësit të nxjerrin gjësendet që i kemi futur në kuti (kube, etiketat me figura, kukulla të vogla, makina, zare etj.) dhe të ndarë në dyshe, të luajnë duke bërë grupimin e gjësendeve të njëjta. Më pas, u shpërndahen etiketat me numrat 1 deri në 10 dhe u kërkohet të vendosin numrin përkatës afër grumbullit të gjësendeve. Loja mund të përsëritet duke u ndërruar çifteve kutitë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kësaj ore, te nxënësit do të vlerësohen përgjigjet e dhëna gjatë bashkëbisedimit, ngjyrosja e vizatimeve, numërimi i gjësendeve dhe lidhja e numrave me sendet që tregojnë të njëjtin numër.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1,3; II. 1,2,7; III. 1,2,3,4,6; IV. 2,5; V. 2,5; VI. 2,3,6.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.2 Kuptimi për numrat 1 dhe 2	Fjalët kyçe: familje, një, dy, rregullat e lojës.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - dallon simbolet e numrave 1 dhe 2. - identifikon bashkësitë me 1 dhe 2 elemente në mesin e bashkësive të tjera. - krijon bashkësi me një ose dy elemente, duke u bazuar në kërkesën e detyrës. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - trego për familjen gjatë diskutimit; - ngjyros bashkësinë me 1 ose me 2 elemente; - shkruaj numrat 1 dhe 2 të shoqëruar me rrahë. 	
Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube, materiale të ndryshme (fasule, misër etj.), etiketa me numrat 1 dhe 2.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi rreth familjes dhe anëtarëve të saj), Edukatë figurative (ngjyrosja e figurave në libër).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1 Mësuesi/ja u parashtron nxënësve pyetjet:

- Cilët janë anëtarët e familjes suaj?
- Sa fëmijë jeni në familje?

Duke u bazuar në përgjigjet e nxënësve, zhvillon një diskutim me ta rreth familjes. Ndalet më shumë tek anëtarët e familjeve, ku ka nga një ose nga dy pjesëtarë, si për shembull: një vëlla, dy motra, dy gjyshër etj. Më pas, përcakton objekte të tjera që janë analoge me numrat 1 ose 2, si për shembull: 1 tabelë, 1 derë, 2 dritare, 2 duar etj.

Hapi 2 Nxënësit punojnë në libër detyrat e dhëna.

Rëndësi të veçantë i kushton mënyrës se si nxënësit vizatojnë, u kujton që figurat duhet të vizatohen brenda katrorëve (duke marrë parasysh se janë fillestarë).

Gjatë kohës që nxënësit kryejnë detyrën, mësuesi/ja i vëzhgon dhe bashkëbisedon rreth punës së bërë.

Hapi 3

Udhëzohen nxënësit të nxjerrin kube dhe etiketat me numrat 1 dhe 2.

Nxënësit, të ndarë në dyshe, luajnë duke udhëzuar njëri-tjetrin për të krijuar bashkësi me kube në varësi të etiketës me numër, që ia tregon shoku/shoqja. Më pas, nxënësit ndërrojnë rolet. Ai/ajo që kishte etiketat me numra, tani merr kubet dhe anasjellas. Para se të fillojnë lojën, nxënësit udhëzohen të dëgjojnë rregullat që duhet të ndjekin gjatë lojës.

Hapi 4

Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me numrat 1 dhe 2, të shoqëruar me rrathë, si për shembull:

1 

2 

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kësaj ore, te nxënësit do të vlerësohet komunikimi gjatë identifikimit të anëtarëve të familjes, lidhja e bashkësive me numrat e dhënë, marrja dhe dhënia e informacionit nga njëri-tjetri gjatë aktivitetit me kube dhe shkrimi i numrave në fletoret vetjake.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Tregon të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1,3; II. 1,2,7; III. 1,2,3,4,6; IV. 2,5; V. 2,5; VI. 2,3,6;		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.3 Numrat 1 dhe 2	Fjalët kyçe: një, dy, numër, rezultat.
<p>Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lidh numrat me figurat e duhura në tekst; - vizaton në bashkësi sende sipas kërkesës së detyrës; - identifikon rezultatin e arritur gjatë lojës. <p>Kriteret e suksesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruaj drejt numrin një dhe dy në librin e nxënësit; - vizato brenda figurave aq sende sa tregon numri që kanë afër; - shkruaj numrin që qëllon në tabelë. 	
Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: petëza, materiale të ndryshme (fasule, misër etj.), etiketa me numrat 1 dhe 2, një top i butë.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi rreth sendeve që janë të paraqitura në libër dhe atyre që na rrethojnë); Edukatë figurative (ngjyrosja e figurave në libër).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Në secilin grup të nxënësve, mësuesi/ja vendos materiale të ndryshme, një apo dy nga secili lloj p.sh.:dy kokrra fasule, një kapak të shishes, dy kokrra misri apo diçka tjetër dhe etiketa me numrat 1 dhe 2. Udhëzohen nxënësit që të ndajnë materialet dhe të vendosin afër numrin përkatës (1 ose 2).

Pasi një nxënës nga grupi paraqet punën e bërë, zhvillonin një diskutim të përbashkët në klasë rreth aktivitetit.

Pas diskutimit nxënësit hapin librat dhe plotësojnë aktivitetin në libër.

Hapi 2


Në dërrasën e zezë, mësuesi/ja shkruan numrat 1 dhe 2 dhe udhëzon nxënësit të vëzhgojnë, të shkruajnë. Më pas, nxënësit shkruajnë numrat në shpinën e njëri-tjetrit dhe i formojnë me materiale të ndryshme në bankat e tyre.

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë gjësendet në figurat e zbrazëta. Nxënësit vizatojnë aq gjësende sa tregon numri që e kanë afër. Disa prej tyre prezantojnë punën e bërë para të tjerëve. Më pas, nxënësit do të ngjyrosin veshjet dhe do të plotësojnë katrorët bosh me numra, duke u bazuar në figurat e veshjeve.

Hapi 3

Në dërrasën e zezë vizatoni një rreth dhe brenda rrethit të madh do të vizatoni një rreth të vogël, kudo të shkruani numrin 1 e jashtë numrin 2.

Nxënësit do të gjuajnë me top në rrethë dhe, në varësi të numrit që do të kapin, të shënojnë pikën në një tabelë të krijuar nga mësuesi.



Hapi 4



Nxënësit shënojnë numrat që kanë mësuar sot në rubrikën “Sot mësova”, në librin e nxënësit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kësaj ore, te nxënësit do të vlerësohet shkrimi i numrave 1 dhe 2, lidhja e numrave me sendet që tregojnë të njëjtin numër, vizatimi i objekteve sipas kërkesës dhe vetëvlerësimi i nxënësve gjatë gjuajtjes me top në rreth.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Tregon të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1,3; II. 1,2,7; III. 1,2,3,4,6; IV. 2,5; V. 2,5; VI. 2,3,6;		
	Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 1.4 Kuptimi për numrin 3	Fjalët kyçe: tre, lodra, numërim.		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - grumbullon sende në bazë të udhëzimeve; - tregon numrin e vizatuar në kripë apo në rërë; - luan, duke respektuar rregullat e caktuara. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - vendos nga 3 sende në numrin 3 në fletën e bardhë; - shkruaj numrin 3 në kripë apo në rërë; - respekto rregullat gjatë lojës. 			
Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fleta e bardhë me numrin 3, enë me kripë ose me rërë, lodra, materiale të ndryshme.		
	Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Shkathësi për jetë (materialet e ndryshme); Edukatë figurative (vizatim dhe ngjyrosje); Edukatë fizike; Sporte dhe Shëndeti (loja në rreth).		
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja vendos në secilin grup nga një numër 3 në fletën e bardhë dhe udhëzon nxënësit të vendosin sende të ndryshme (nga tri) përgjatë tij. Afër sendeve, nxënësit shkruajnë numrin 3.			
Hapi 2 Secili grup pajiset me një enë me kripë ose rërë, ku fëmijët do të ushtrohen të shkruajnë numrin 3. Në krye është vendosur një tabelë me numrin përkatës, për të njohur konceptin e numrit të ri.			
			

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të hapin librat dhe fillon një diskutim, duke u bazuar në figurën e tekstit. Nxënësit numërojnë sendet në ilustrimin e parë, lidhin numrat me sendet dhe vizatojnë aq figura sa tregon numri i katrorit në ushtrimet e tekstit. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që fillimisht të punojnë individualisht, e më pas të diskutojnë punën e bërë në çifte dhe në grup.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të formojnë një rreth dhe të fillojnë numërimin nga një deri në tre. Nxënësi që thotë numrin tre, vendos dorën mbi kokë. Numërimi përsëritet disa herë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Përgjigjet e secilit prej nxënësve rreth mënyrës së zgjidhjes së detyrave të dhëna.

Përqendrimi gjatë lojës së numërimit nga një deri në tre.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/ vizatime.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1,3; II. 1,2,7; III. 1,2,3,4,6; IV. 2,5; V. 2,5; VI. 2,3,6;		
	Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.		

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.5 Numri 3	Fjalët kyçe: tre, tri, akuarium, kube formuese (<i>Lego</i>).
<p>Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ngjyros objekte, duke u bazuar në kërkesën e detyrës; - plotëson tekstin, duke bashkëpunuar në çift dhe në grup; - përzgjedh sende sipas kërkesës dhe prezanton para të tjerëve. <p>Kriteret e suksesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ngjyros pjesët e vizatimit që mbajnë numrin 3; - shkruaj drejt numrin 3; - plotëso detyrat e dhëna në libër; - përzgjidh tri sende të njëjta, duke prezantuar para të tjerëve në rreth. 	
Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”.	<p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fleta e bardhë me vizatimin e akuariumit, kube formuese (<i>Lego</i>) me tri ngjyra të ndryshme, materiale shkollore për aktivitetin në rreth.</p> <p>Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve); Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja e objekteve); Njeriu dhe natyra (qeniet e gjalla).</p>

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fletën e bardhë, ku është paraqitur një akuarium. Udhëzohen nxënësit që të ngjyrosin pjesët me numrin 3. Pas ngjyrosjes, zhvillohet një diskutim me nxënësit, ku bëhen pyetjet:

- Çfarë figurash përftuat pas ngjyrosjes?
- Sa peshq keni ngjyrosur në akuarium?
- Ku jetojnë peshqit?



Hapi 2

Mësuesi/ja shpërndan në çdo grup të nxënësve kube formuese (*Lego*), të cilat duhet të jenë në tri ngjyra të ndryshme (p.sh.: të kuqe, të verdha dhe të gjelbra). Kërkon nga nxënësit që të bashkojnë nga tri kube formuese, duke kombinuar ngjyrat. Një përfaqësues i grupit prezanton punën e bërë. Zgjidhjet na dërgojnë te kuptimi se numrin tre, e formuan me bashkimin e kubave formues (*Lego*) të dy ose tri ngjyrave të ndryshme.

$3 \rightarrow 2$ dhe 1 ; $3 \rightarrow 1$ dhe 1 dhe 1 .

Hapi 3

Nxënësit hapin librat dhe fillojnë të plotësojnë detyrat e dhëna. Vëzhgohen si e shkruajnë numrin 3, nëse ndonjëri ka nevojë për ndihmë. Nxënësit do të dallojnë bashkësitë me tri elemente nga ato me dy dhe një. Në përputhje me kërkesat e detyrave, ata do të ngjyrosin, do të vizatojnë dhe do të zhvillojnë aktivitete.

Hapi 4

Mësuesi/ja fton nxënësit të formojnë një rreth. Në fillim, nxënësit duhet të marrin nga tri sende vetjake në dorë. Mësuesi/ja fillon së pari duke e ngritur dorën dhe duke thënë: “Unë kam tre shkumësa në dorë. Më pas, vazhdojnë nxënësit me radhë duke treguar çfarë kanë në dorë. Nxënësit që nuk i thonë fjalitë e plota, korrigjohen nga mësuesja, duke i plotësuar, por pa e gjykuar nxënësin. Theks të veçantë vendosim te përdorimi i numrit tre, që te gjinia femërore përdoret tri (tri kukulla), kurse tek ajomashkullore tre (tre zogj). Gjithsesi, kjo duhet bërë pa i ngarkuar nxënësit me terminologji gramatikore, por duke u shpjeguar dallimin që ka numri 3 në të dyja gjinitë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Ngjyrosjen e pjesëve që mbajnë numrin 3;

Përgjigjet vetjake të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së kubave formues (*Lego*).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Tregon të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. I,3; II. 1,2,7; III. 1,2,3,4,6; IV. 2,5; V. 2,5; VI. 2,3,6;		
	Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 1.6 Kuptimi për numrin 4	Fjalët kyçe: katër, gjymtyrë, natyrë, gjëgjëza.		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore			
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - identifikon numrat e mësuar në mesin e numrave të tjerë; - plotëson detyrat e tekstit, duke u bazuar në kërkesat e dhëna; - interpreton një vjershë apo gjëgjëzë që ka të bëjë me numrat. 			
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> - ngjyros numrin 4 në mesin e numrave të tjerë; - identifikon numrin e sendeve në detyrat e dhëna; - trego një vjershë apo një gjëgjëzë që ka lidhje me numrin. 			
Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”, libër me gjëgjëza.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: makina, kukulla, ilustrimi me numra në fletën të bardhë, copë e vogël kartoni (tiketa) me ngjyrat e semaforit.		
	Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve); Shoqëria dhe mjedisi (përcaktimi i ngjyrës dhe kohës së ndërrimit të semaforit); Shkathtësi për jetë (mjetet e udhëtimit).		
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1			
<p>Nxënësit kanë sjellë nga shtëpia nga një makinë lodër apo kukull (ose mësuesi/ja siguron nga një për secilin grup). Pasi zhvillohet një diskutim i shkurtër rreth rëndësisë së lodrave dhe rëndësisë që ka mirëmbajtja e tyre, ftohen dy nxënës para klasës (me një kukull dhe me një makinë). Mësuesi/ja u parashtron nxënësve pyetjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kush e vë në lëvizje makinën? (Rrotat) • Sa rrota ka makina jote? (4) • Si i ka të vendosura? (Nga 2 në secilën anë) • Me çfarë lëviz kukulla jote? (Me këmbë) • Me çfarë i kryen punët? (Me duar) 			

- Si quhen duart dhe këmbët me një emër? (Gjymtyrë)
- Sa gjymtyrë ka kukulla që po mban në dorë? (Ka 4 gjymtyrë, 2 këmbë dhe 2 duar).

Hapi 2

Sigurohet nga një ilustrim me numra për secilin grup apo çift (duke marrë parasysh se janë të ulur nxënësit). Udhëzohen nxënësit të ngjyrosin numrin 4 në ilustrim. Gjatë ngjyrosjes, mësuesi/ja pyet nxënësit se cilët numra kanë mësuar deri tani dhe cilët nga numrat e tjerë i njohin.



Hapi 3

Udhëzohen nxënësit të hapin librat, të vëzhgojnë figurën e natyrës dhe të numërojnë sendet që gjenden në të. Përmes këtij aktiviteti, mësuesi/ja vlerëson sa fëmijë kanë kuptuar numrat 1, 2 dhe 3. Nxënësit kanë copa kartoni me tri ngjyra: të kuqe, të verdhë dhe të gjelbër. Ata mbajnë copat e kartonit afër librit dhe, kur u kërkohet nga mësuesi/ja, ngrenë copën e vogël të kartonit, me ngjyrën që mendojnë se u përshtatet.

* Ngjyra e gjelbër tregon se nxënësi i ka kuptuar detyrat, e verdha tregon se nuk është i sigurt, kurse e kuqja tregon që nxënësi nuk i kupton detyrat. Në varësi të ngjyrës së copës së kartonit që ngre lart nxënësi, mësuesi/ja përcakton kush ka nevojë për ndihmë.

Hapi 4

Nxënësve u kërkohet të thonë vjershat apo gjëgjëzat që kanë mësuar në lidhje me numrat. Mësuesi/ja mund të tregojë edhe vetë një të tillë. Për shembull:

**Katër motra shkojnë e vijnë,
njëra-tjetrën s'e arrijnë.
(4 stinët e vitit)**

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen me shprehje rreth qëndrimeve të tyre në situatat dhe në diskutimet gjatë orës. Copat e kartonit me ngjyrat e semaforit: nxënësit bëjnë vetëvlerësim gjatë punës dhe kërkojnë përkrahje. Përgjigjet e dhëna në zgjidhjet e gjëgjëzave;

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20; - tregon të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime. 		Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1,3; II. 1,2,7; III. 1,2,3,4,6; IV. 2,5; V. 2,5; VI. 2,3,6;	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.7 Numri 4	Fjalët kyçe: numrat, numërimi, katër, rregullat e lojës.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - formon numrin e mësuar me materiale të ndryshme; - shkruan numrat e mësuar në fletën për ushtrime; - plotëson detyrat e dhëna në tekst në bazë të kërkesave; - luan lojën duke respektuar rregullat dhe bashkëpunuar me shokun/shoqen. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - formo numrin 4 me makarona, duke e shoqëruar me 4 sende; - shkruaj drejt numrin 4 në libër dhe në fletore; - plotëso detyrat e dhëna në tekst, në bazë të udhëzimeve; - luaj duke respektuar rregullat e lojës. 	
Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”, fletë për ushtrime të shkrimit të numrave 1-4;	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: plastelinë, makarona.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Shoqëria dhe mjedisi (Të luajmë dhe mësojmë së bashku); Edukatë figurative (vizatimi e ngjyrosja); Shkathhtësi për jetë (punimi me materiale të ndryshme).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Në çdo grup shpërndahen makarona (afërsisht sa duhen numri 4 në katër katrorë). U kërkohet nxënësve të formojnë katër herë numrin 4 dhe të ngjitin me ngjitës në fletoret e tyre. Më poshtë do të vizatojnë 4 sende sipas dëshirës. Nxënësit do të prezantojnë punën e bërë para të tjerëve duke i vendosur fletoret në bankat e tyre dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit, duke shëtitur bankë më bankë për pak minuta (Turi i galerisë).

Hapi 2

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve nga një fletë për ushtrim (gjysmë flete format A4), ku do të shkruajnë numrat 1 deri në 4, e dhe ku do të shohin qartë se sa elemente ka secili nga numrat e mësuar deri tani. Më pas, udhëzohen nxënësit të ngjitin ushtrimin e punuar në fletoret e tyre.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të punojnë detyrat e dhëna. Në detyrën e parë do të numërojnë makinat në bazë të ngjyrës dhe do të shkruajnë sa janë. Rëndësi e veçantë i jepet shkrimit të numrit 4 në libër. Pasi të përfundojnë detyrat e dhëna, udhëzohen nxënësit të ndërrojnë librat dhe të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Nxënësit do të krijojnë një rreth dhe do të luhet loja “Numërimi”. Para se të fillojë loja, mësuesi/ja shpjegon rregullat e lojës:

- Gjatë numërimit, nxënësit që thonë numrat 1, 2 dhe 3 vendosin dorën në gjoks, kurse nxënësi që thotë numrin 4 vendos dorën në kokë.
- Nxënësit kanë të drejtë të ndërrojnë vazhdimisht kahun e numërimit, ata vetëm e ndërrojnë anëne drejtimit të dorës.
- Nxënësit që gabojnë, ndahen nga rrethi.
- Gjithmonë, pas numrit 4 vjen numri 1.

Gjatë kësaj loje, nxënësit do të mësohen të përqendrohen në lojë dhe do të zhvillojnë frymën e garës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësojmë shkrimin e numrit 4.

Përgjigjet e dhëna me gjatë lojës me numërim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënimit të temës: - numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20; - tregon të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.		Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1,3; II. 1,2,7; III. 1,2,3,4,6; IV. 2,5; V. 2,5; VI. 2,3,6;	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 1.8 Kuptimi për numrin 5		Fjalët kyçe: pesë, gogla, kuti, pema e formuar me pëllëmbë duarsh.	
Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore			
Nxënësi/ja: - vendos goglat në kuti, duke ndarë numrin 5; - plotëson detyrat në tekst, duke u bazuar në kërkesat e dhëna; - shkruan emrin e tij/saj brenda pëllëmbës së formuar me ngjyrë.			
Kriteret e suksesit: - gjej kombinime të ndryshme të ndarjes së numrit 5 në kuti; - plotëso detyrat, duke u bazuar në kërkesat e dhëna; - shkruaj emrin brenda pëllëmbës së formuar me ngjyrë.			
Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”.		Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: gogla, fletë të bardha, ngjyrë që pastrohet me ujë, copa të vogla kartoni me ngjyrat e semaforit.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve); Jeta dhe puna (mjetet e udhëtimit); Edukatë figurative (punimi i pemës).			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Numëroni deri në 5 dhe “harroni” qëllimisht një numër. Pyesni: Cili numër mungon? Si e gjetët? Përsëriteni veprimin disa herë.			
Hapi 2 Tregoni historinë e Gentit. Gentit i pëlqen të luajë me gogla, që i mban në 2 kuti të vogla në dhomën e tij. Numëroni dhe tregoni pesë gogla. Ndonjëherë ai i vendos njëherë kuti dhe herë të tjera i ndan në të dyja. Në sa mënyra mund të ndahen goglat në të dyja kutitë? Vizatoni në tabelë dy kuti dhe pesë gogla. Vendosini të gjitha goglat në njëherë kuti dhe pastaj në kutinë tjetër. Çfarë ndodh, nëse ai vendos një gogël në kutinë e parë? Sa i mbeten për të vendosur në kutinë tjetër? Numëroni pesë gogla. Këtë lojë përsëriteni edhe në klasë. Fillimisht, një gogël është në këtë kuti, prandaj 4 të tjerat duhet të shkojnë në kutinë tjetër. A janë përsëri pesë gogla? Përgjigja është: Po.			

Numërojini përsëri: 1, 2, 3, 4, 5.

Kërkojuni nxënësve të punojnë me një shok dhe të gjejnë sa mënyra të mundin për të vendosur goglat në lojën me kutinë dhe me goglat. Ndërsa nxënësit punojnë, vështroni dhe dëgjoni se çfarë thonë dhe se çfarë bëjnë. Sigurohuni që të gjithë ta kuptojnë detyrën.

Hapi 3

Udhëzohen nxënësit të hapin librat, të vëzhgojnë figurën, të diskutojnë për mjetet e udhëtimit dhe numrin e tyre në aktivitetin e dhënë. Nxënësit vizatojnë, ngjyrosin dhe lidhin figurat me numrat e dhënë, në varësi të kërkesave të detyrës. Do të integrohen edhe numrat e mësuar më parë, 1-4.

Nxënësit mbajnë afër copat e kartonit me ngjyrat e semaforit dhe, në varësi të ngjyrës që paraqesin, mësuesi/ja vlerëson kush ka nevojë për ndihmë.

Hapi 4

Nxënësit formojnë një pemë me pëllëmbët e duarve të tyre. Secili nxënës lyen dorën në ngjyrë (ngjyrë që pastrohet me ujë, e kuqja dhe portokallia duken më bukur) dhe më pas e vendos mbi trungun e pemës, duke ia dhënë formën e pemës. Çdo nxënës shkruan emrin e tij brenda shenjës së pëllëmbës së dorës, që ka lënë pak më parë. Këtë punim, mësuesi/ja mund ta vendosë në murin e klasës, ku mund të qëndrojë për njëfarë kohe.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i përgjigjeve të dhëna gjatë vendosjes së goglave në kuti.

Identifikimin e numrit që mungon gjatë numërimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Tregon të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. I. 1,3; II. 1,2,7; III. 1,2,3,4,6; IV. 2,5; V. 2,5; VI. 2,3,6;		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.9 Numri 5	Fjalët kyçe: pesë, kube, karton me ngjyrat e semaforit.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - tregon mënyrat e kombinimit të kubeve formues (<i>Legó</i>) për të formuar numrin 5; - shkruan numrin 5 në fletën për ushtrime; - plotëson detyrat në libër, duke kërkuar ndihmë në rast nevojë. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - trego si i ke renditur kubet formuese (<i>Legó</i>) për të formuar pesë; - shkruaj drejt numrin 5 në fletën e ushtrimeve; - plotëso detyrat në libër duke kërkuar ndihmë me semafor në rast nevojë. 	
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube formuese (<i>Legó</i>), etiketa me numrin 5.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë lojës); Shkathtësi për jetë (formim dhe orientim).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve kube formuese (*Legó*) me ngjyra të ndryshme dhe kërkon që të bashkojnë nga pesë kube formuese (*Legó*) dhe më pas, në fletoret e tyre të shkruajnë nga sa për secilën ngjyrë kanë vendosur. Secili nxënës i grupit prezanton para nxënësve të tjerë punën e bërë.

Hapi 2

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të shkruajnë numrin 5 në etiketat me pika të përgatitura më parë. Etiketat me numrin 5 do të ngjiten në fletoret e nxënësve dhe nën të nxënësit do të vizatojnë 5 sende të njëjta sipas dëshirës.



Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të punojnë detyrat e dhëna. Nxënësit do të përdorin copat e kartonit me ngjyrat e semaforit për të kërkuar ndihmë për ndonjë paqartësi, gjatë ndonjë paqartësie. Pas përfundimit të detyrave, nxënësit do të ndërrojnë librat me shokun/shoqen që kanë afër, dhe do të kontrollojnë detyrat e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Nxënësit gjejnë zgjidhjen e situatave problemore në formën e gjëgjëzave, si:

**Tre lepuj dhe dy breshka së bashku
kuvendonin dhe tryezën shtronin.
Sa pjata kërkonin?
(Pesë)**

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Përgjigjet vetjake të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së kubeve formuese (*Lego*). Vlerësimi i ndërsjellë i punimeve të njëri-tjetrit.

Përgjigjet e dhëna në zgjidhjet e gjëgjëzave

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
--------------------------------------	--------------------------	--------------------------------	-----------------

Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultati i të nxënit të temës: Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet “më shumë, më pak, aq sa”.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:
komunikues efektiv I (1, 3), Mendimtar kreativ II (2, 4, 7), Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6), Kontribuues produktiv IV (2, 5), Individ i shëndoshë V (2, 5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1,3; 3.3,4,5,6; 5.1; 6.1,2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.10 Më shumë, më pak

Fjalët kyçe: më shumë, më pak, më i gjatë, më shkurtër.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- krahason bashkësitë me anë të numërimit në “më shumë”, “më pak” elemente;
- vizaton grupe me objekte që paraqesin grupe më shumë ose më pak se një grup tjetër;
- krahason numrin e kubeve të veta me ato të shokut/shoqes gjatë lojës.

Kriteret e suksesit:

- identifikoi me anë të numërimit bashkësi me “më shumë” apo “më pak” elemente;
- përdor termat “më shumë” dhe “më pak” për të krahasuar numrin e elementeve të bashkësive;
- paraqit më anë të vizatimit grupe/bashkësi me “më shumë” ose “më pak” elemente se një grup/ bashkësi tjetër.

Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: mjete që kemi përreth për eksplorim, mund të përdoren fruta të stinës, kube, topa pingpongu etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatimi i objekteve)

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja nxjerr para klasës 2 grupe me numër të ndryshëm nxënësish, p.sh.: 4 djem dhe 6 vajza. Bën pyetjen:

- **Çfarë** ka më shumë?
- **Çfarë** ka më pak?

Përsëritet veprimi me numra të tjerë dhe me objekte të tjera, p.sh.: libra, fletore, lapsa etj. Nxjerr dy nxënës me gjatësi të ndryshme. Bëhet krahasimi i tyre:

Iliri është më i gjatë se Dea? Alba është më e shkurtër se Drilona?

Hapi 2

Nxënësit nxiten të vizatojnë grupe me objekte që paraqesin grupe më shumë ose më pak se një grup tjetër. Në dyshe kontrollojnë punët e njëri-tjetrit. (Vlerësimi i ndërsjellë)

Hapi 3

Ushtrimet në tekst mund të punohen në mënyrë të pavarur, mjafton që mësuesi/ja të orientojë dhe të lexojë kërkesat e tyre. Nxënësit që kanë nevojë për ndihmë, ngrenë letërën me ngjyrë portokalli apo të kuqe të semaforit.

Bën një shembull në tabelë ku të tregojë se shigjeta me mbishkrimin “më pak” ose “më shumë”, do të thotë që ata do të vizatojnë “më pak” ose “më shumë” elemente. Bëhet kontrolli individual dhe vlerësimi me shprehje.

Hapi 4

Zhvillohen disa ushtrime me gojë për krahasimin e numrave dhe përdorimin e termave si 2 më shumë dhe 3 më pak. Nxënësit japin përgjigje duke përdorur objekte rrethore për numërim, si: lapsa, pipa etj.

Hapi 5

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve kube në banka dhe i udhëzon të luajnë së bashku në çifte, në bazë të figurës në ushtrimin 5.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i ndërsjellë - nxënësit vlerësojnë punimet e njëri-tjetrit. Ngjyrat e semaforit - nxënësit bëjnë vetëvlerësim për punën e kryer.

Argumentet individuale të nxënësve - rreth mënyrës së krahasimit të kubeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/ vizatime.		Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2; 3.3, 4,5, 6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.11 Numri zero	Fjalët kyçe: zero, akuarium, zbrazët.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - vendos pikat në nusepashkë (mollëkuqe) në varësi të numrit të shkruar në etiketë; - shkruan numrin 0 në shiritin me pika; - plotëson detyrat e tekstit varësisht nga kërkesat e dhëna. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - vendos pikat në krahët e nusepashkës sa tregon numri në etiketë; - shkruaj drejt numrin 0 në shiritin me pika; - plotëso detyrat në tekst duke kërkuar ndihmë në rast nevojë. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketat me numrat 0-5, nusepashkët e punuara më parë, shiriti me pika për shkrimin e numrit 0.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Shkathtësi për jetë (punimi i nusepashkëve) dhe Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja në tekst).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në grupe nusepashkat e përgatitura më parë në “Shkathtësi për jetë”, pikat e zeza dhe në secilin grup vendos edhe një etiketë me një numër (0, 1, 2, 3, 4, 5). Udhëzohen nxënësit që vendosin në nusepashkë aq pika sa tregon numri në etiketë. Një pjesëtar nga secili grup prezanton punën e bërë. Kur vjen radha te grupi me etiketën 0, nxënësit do të vërejnë se grupi nuk ka vendosur asnjë pikë në nusepashkë.



Hapi 2

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve shiritin me pika, nga bashkimi i të cilave, nxënësit do të shkruajnë numrin 0. Më pas, nxënësit do të vendosin në fletoret e tyre shiritin me numra dhe një enë të zbrazët afër numrit 0.



Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të punojnë detyrat e dhëna.

Në detyrën fillestare do të vërejnë që në akuariumin e parë janë dy peshq, ndërsa në të dytin asnjë, sepse poshtë akuariumit është numri 0. Nxënësit do të plotësojnë numrat që mungojnë në boshtin numerik, duke filluar nga numri 0. Gjatë punës, nxënësit do të kërkojnë ndihmë me anë të letrave me ngjyrat e semaforit.

Hapi 4

Nxënësit në çifte do të luajnë me lapsa dhe një gotë plastike. Nxënësi i parë udhëzon sa lapsa të vendosen në gotë, kurse i dyti i vendos në bazë të udhëzimit. Në rastin kur nxënësi udhëzon të vendosen 0 lapsa, nxënësi tjetër i çiftit nuk do të vendos asnjë laps. Veprimi përsëritet dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së pikave në nusepashkë.
Përgjigjet e dhëna gjatë punës në tekst dhe lojës me lapsa.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/ vizatime.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.12 Kuptimi për numrin 6	Fjalët kyçe: gjashtë, pjata, pirunë, thika, lugë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - vendos në etiketat e numrave aq kapëse sa tregon numri në të; - qarkon numrin 6 në mesin e numrave të dhënë; - plotëson detyrat në tekst në bazë të kërkesave të dhëna. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - vendos aq kapëse sa tregon numri në etiketë; - qarko numrin 6 në mesin e numrave të dhënë; - plotëso detyrat në tekst, duke kërkuar përkrahje në rast nevojë. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kapëse letre (metali apo plastike), etiketa me numrat 1-6, fletë A/3 me ilustrimin e numrit 6, zare për secilin çift nxënësish.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Shkathësi për jetë (mjetet e kuzhinës), Njeriu dhe natyra (kultura e të ushqyerit).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve etiketa me numrat e mësuar (secilit nga një), por aty shton edhe numrin 6, pra numrat 0 deri në 6. Bashkë me etiketat, u shpërndan edhe kapëse (metalike apo plastike) letrash. Udhëzon nxënësit që të vendosin në etiketë aq kapëse sa tregon numri në të. Nxënësit punojnë individualisht dhe më pas prezantojnë punën e tyre para grupit.



Hapi 2

Mësuesi/ja ka përgatitur për nxënësit në secilin grup nga një numër 6 në fletën A/3 dhe kërkon që secili nxënës nga grupi të qarkojë të paktën një numër 6, që gjendet në mesin e numrave tjerë. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin se sa numra 6 kanë arritur të qarkojnë. (Vlerësimi i ndërsjellë)



Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të punojnë detyrat e dhëna. Në detyrën e parë do të numërojnë pjatat, pirunët, lugët dhe thikat. Do të zhvillohet një diskutim i shkurtër rreth kulturës së shtrimit të tryezës. Në detyrat e tjera, nxënësit me radhë do të lidhin numrat e dhënë me figurat përkatëse, do të vizatojnë aq gjethë sa tregon numri etj. Mësuesi/ja do të ndihmojë nxënësit në leximin e kërkesave të detyrave dhe, në varësi të ngjyrës së letres që nxënësi/ja ngre, mësuesi/ja do të ndihmojë ata që kanë nevojë.

Hapi 4

Në çifte, nxënësit do të luajnë me zare. Njëri nxënës nga çifti do të hedhë zarin, ndërsa nxënësi tjetër ngre etiketën me numrin që ka shënuar shoku/shoqja. Më pas nxënësit do të ndërrojnë rolet dhe do të përsërisin veprimin disa herë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së kapëseve në etiketa.

Vlerësimi i ndërsjellë i punimeve të njëri-tjetrit gjatë qarkimit.

Përgjigjet e dhëna me etiketë gjatë hedhjes së zareve të shokut/shoqes.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20; - demonstroi të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime. 	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.13 Numri 6	Fjalët kyçe: gjashtë, gurë dominoje, etiketa, vallëzim.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - gjen kombinimet që japin numrin 6 në mesin e gurëve të dominosë; - plotëson detyrat e tekstit në bazë të kërkesave të dhëna; - zgjedh për vallëzim shokun/qen me të cilin/cilën formon numrin 6. 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - vizato në fletore kombinimet që japin numrin 6 në domino; - shkruaj drejt numrin 6 në shiritin me pika; - plotëso librin, duke respektuar kërkesat e dhëna. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: domino, shiriti me numrin 6 me pika, magnetofon, CD.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë zgjidhjes së detyrave), Edukatë muzikore (vallëzimi gjatë lojës), Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja në tekst).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Nxënësit kanë sjellë gurë dominoje. Edhe mësuesi/ja mund të sigurojë nga një komplet për secilin grup. Udhëzohen nxënësit që në grupe të renditin të gjitha dominotë dhe të gjejnë kombinimet që japin numrin gjashtë. Kombinimet e gjetura do t'i vizatojnë në fletoret e tyre si më poshtë dhe do të shënojnë numrat që japin 6.



4

2

Hapi 2

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve shiritin me pika, bashkimi i të cilave jep numrin 6. Më pas, nxënësit do të vendosin në fletoret e tyre shiritin me numra dhe do të vizatojnë në shirit 6 sende.

**Hapi 3**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të punojnë detyrat e dhëna. Në detyrën e parë do të numërojnë pikat në gurët e dominosë dhe do të shkruajnë sa janë. Më shumë rëndësi u kushtohet numrave që formojnë numrin 6 me bashkimin e tyre, si p.sh.: 6 me 0; 5 me 1; 4 me 2; 3 me 3. Pasi të përfundojnë detyrat e dhëna, udhëzohen nxënësit të ndërrojnë librat dhe të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të ngrihen në këmbë dhe të marrin nga një etiketë me numër. Në etiketa janë të shkruar numrat nga 0 deri në 6. Pasi mësuesi/ja vendos muzikë në klasë, udhëzohen nxënësit të marrin për të kërcyer shokun/shoqen, me të cilin/cilën formohet numri 6. Për shembull: nxënësi me numrin 0 kërcen me shokun/shoqen me numrin 6 për vallëzim. Gjatë këtij aktiviteti, do të bëhet lidhje me lëndët e tjera, si për shembull me Edukatën muzikore. Fëmijët do të qetësohen për pak minuta dhe do të përsëritin kombinimet e numrave që krijojnë numrin 6.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Argumentet individuale të nxënësve rreth kombinimeve që japin numrin 6 në gurët e dominosë.

Vlerësimi i ndërsjellë i punimeve të njëri-tjetrit.

Përgjigjet e dhëna gjatë zgjidhjes së detyrave në tekst.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20; - demonstroi të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime. 	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.14 Kuptimi për numrin 7	Fjalët kyçe: shtatë, Borëbardha, xhuxhët.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - bashkon letrat formuese për të krijuar foton dhe numrin 7; - plotëson detyrat e tekstit në bazë të kërkesave të dhëna; - gjen kombinimet e numrave që formojnë numrin 7 gatë lojës me gishta. 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - bashko formueset dhe krijo ilustrimin e Borëbardhës dhe numrin 7; - plotëso detyrat e tekstit, duke kërkuar ndihmë, me letrat me ngjyrat e semaforit; - shkruaj kombinimet e numrave që formojnë numrin 7 gjatë lojës me duar. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, libri me figura “Borëbardha dhe 7 xhuxhët”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: letra formuese, libri i nxënësit, fletorja e punës.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (leximi dhe komentimi i përrallës); Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja përgatit paraprakisht për secilin grup nga një vizatim me ngjyra të formatit të madh, ku paraqitet një skenë nga përralla “Borëbardha dhe shtatë xhuxhët” në një rën anë, kurse në anën tjetër është shkruar numri 7. Fletën A/4 priten në forma të çrregullta (*puzzle*). Detyra e secilit grup është të bashkojë pjesët dhe të formojë foton në një rën anë dhe numrin 7 në anën tjetër.



Hapi 2

Mësuesi/ja u lexon fëmijëve librin me përralla (të ilustruar) “Borëbardha dhe shtatë xhuxhët”. Gjatë leximit, theksin e vendos te leximi i numrit 7, ku numërohen 7 xhuxhët, 7 karriget e tyre, 7 palltot, 7 mjetet e punës etj. Më pas, zhvillohet një diskutim i shkurtër me nxënësit rreth përrallës. Nxënësit numërojnë xhuxhët me radhë, deri te numri shtatë: 1-7.

Hapi 3

Udhëzohen nxënësit të hapin librat, të vëzhgojnë figurën, të diskutojnë përrallën “Borëbardha dhe shtatë xhuxhët” dhe numrin e sendeve që përmenden në aktivitetin e dhënë. Nxënësit vizatojnë, ngjyrosin dhe lidhin figurat me numrat e dhënë në varësi të kërkesës së detyrës. Do të integrohen edhe numrat e mësuar më parë, 5 dhe 6. Nxënësit mbajnë afër letrat me ngjyrat e semaforit dhe, në varësi të letrës që ngenë nxënësit, mësuesi/ja vlerëson kush ka nevojë për ndihmë.

Hapi 4

Nxënësit në çifte do të luajnë duke nxjerrë 7 gishta. Do të shkruajnë në një fletë të gjitha kombinimet që u vijnë ndër mend me gishtat nga duart e tyre.

07 16 25 34 43 52 61 70

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së letrave formuese.
 Ngjyrat e semaforit - nxënësit bëjnë vetëvlerësim gjatë punës dhe kërkojnë ndihmë.
 Përgjigjet e dhëna gjatë lojës me kombinimet e gishtave me duart e shokut/shoqes.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20; - demonstroi të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime. 		Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.15 Numri 7	Fjalët kyçe: Shtatë, kube formuese (<i>Lego</i>), zare, etiketë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - tregon numrin e kubeve formues (<i>Lego</i>-ve) që përdor për të krijuar shkronjat e mësuara; - plotëson detyrat e tekstit sipas kërkesave të dhëna; - plotëson numrin 7 me njëren etiketë me numër gjatë lojës me zare. 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - trego numrin e kubeve formuese (<i>Lego</i>-ve) që ke përdorur për të krijuar shkronjat e mësuara; - shkruaj drejt numrin 7 në shiritin me pika; - plotëso numrin 7 me njëren etiketë me numër gjatë lojës me zare. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube formuese (<i>Lego</i>), shiriti me pika, zare, etiketa me numrat 1-7, etiketat me ngjyrat e semaforit.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (argumentet gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja gjatë ushtrimeve), Shoqëria dhe mjedisi (respektimi i mendimit të njëri-tjetrit gjatë lojës).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve kube formuese (*Lego*) nëpër grupe dhe i udhëzon që me bashkimin e tyre të formojnë shkronjat që kanë mësuar deri më tani. Nxënësit punojnë në grupe dhe më pas një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë. Gjatë prezantimit, mësuesi/ja pyet:

- Cilën shkronjë keni formuar?

- Sa kube formuese (*Lego*) keni bashkuar për të formuar shkronjën?
- Cila shkronjë ka më shumë kube formuese (*Lego*) e cila më pak?

Hapi 2

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve shiritin me pika, nga bashkimi i të cilave do të shkruajnë si duhet numrin 7. Më pas, nxënësit do të vendosin në fletoret e tyre shiritin me numra dhe do të vizatojnë 7 sende sipas dëshirës.



Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të punojnë detyrat e caktuara. Nxënësit do të gjejnë mënyra të ndryshme për të krijuar numrin 7 nga dy numra tjerë të mësuar më parë, duke ngjyrosur rruazat në detyrën 3. Nxënësit do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit për të kërkuar ndihmë për ndonjë paqartësi. Pas përfundimit të detyrave, nxënësit do të ndërrojnë librat me shokun/shoqen që kanë afër dhe do të kontrollojnë detyrat e njëri-tjetrit (Vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Udhëzohen nxënësit që të luajnë në çifte lojën e paraqitur në detyrën 5. Njëri nxënës hedh zarin, kurse tjetri, i cili ka etiketat me numrat 1-6, vendos afër zarin numrin e duhur për të krijuar shifrën 7. Pas disa hedhjeve, nxënësit ndërrojnë rolet.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Argumentet e nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së kubeve formuese (*Lego*-ve).

Vlerësimi i ndërsjellë i punimeve të njëri-tjetrit.

Plotësimi i numrit 7 gjatë hedhjes së zareve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.16 Kuptimi për numrin 8	Fjalët kyçe: tetë, makina, rrugë, parku i lojërave.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - jep përgjigje të mundshme për zgjidhjen e gjëgjëzës së dëgjuar nga mësuesi/ja; - shkruan numrin 8 në rrugën me makina; - plotëson detyrat në tekst, duke u bazuar në kërkesat e dhëna. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - jep përgjigje të mundshme për zgjidhjen e gjëgjëzës; - vendos makinat në rrugën e vizatuar; - shkruaj numrin 8 afër makinave në rrugën e vizatuar; - identifikoj numrin gjatë lojës “Zbuloj numrin”. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, gjëgjëza.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A1 me numrin 8, ilustrime të prera makinash, letra me numrat 0-10.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (gjëgjëza), Shkathtësi për jetë (prerja e figurave të makinave), Shoqëria dhe mjedisi (rregullat gjatë lojës dhe mirëmbajtja e parkut).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Bëhet përsëritje e njohurive të marra një ditë më parë për numrat deri në 7, bëhet numërim i objekteve përreth, lexim i vargjeve të numrave ose zgjidhja e situatave problemore në formën e gjëgjëzave.	
<p>Një ari e një maçok, sa këmbë kanë tok? (Tetë)</p>	

Hapi 2

Diskutohet me nxënësit për gjëgjëzën:

Hapi 3

Mësuesi/ja vendos në secilin grup nga një numër 8, të madhësisë së fletës A1 dhe udhëzon nxënësit të vizatojnë rrugën e të vendosin figura të makinave (të prera në orën “Shkathhtësi për jetë”) përgjatë tij. Afër makinave nxënësit shkruajnë numrin 8.



Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të punojnë detyrat e dhëna. Në detyrën e parë, do të numërojnë fëmijët dhe sendet në parkun e lodrave. Do të zhvillohet një diskutim i shkurtër rreth sjelljes gjatë lojës dhe mirëmbajtjes së këndit të lojërave. Në detyrat e tjera, nxënësit me radhë do të vizatojnë dhe ngjyrosin në figurat përkatëse, sipas kërkesës së tyre. Mësuesi/ja do të ndihmojë nxënësit në leximin e kërkesave të detyrave. Në varësi nga letra me ngjyrat e semaforit që ngrenë, mësuesja ndihmon dhe sqaron ata që kanë nevojë për orientim.

Hapi 5

Të ndarë në çifte, nxënësit luajnë lojën “Zbulo numrin”. Gjatë kësaj loje, nxënësit do të njihen edhe me numrat 9 dhe 10, që do t’i mësojnë në vazhdim. Do të identifikojnë edhe numrat që prek shoku/shoqja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen me shprehje rreth qëndrimeve të tyre në situatat dhe diskutimet gjatë orës.

Vlerësohen për identifikimin e numrit gjatë lojës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6), Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3, 4, 5, 6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.17 Numri 8	Fjalët kyçe: tetë, para, pas, rritje, zbritje.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - rendit numrat sipas radhës në rritje nga 0 deri në 8 dhe në zbritje nga 8 në 0; - shkruan numrin 8 në fletën e ushtrimeve; - identifikon numrin që gjendet para dhe pas numrit shenjë gjatë lojës. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - rendit drejt numrat prej 0-8 dhe anasjellas; - shkruaj numrin 8 në fletën e ushtrimeve; - kontrollo në libër detyrat shokut/shoqes; - identifikoj numrin që gjendet para dhe pas numrit shenjë gjatë lojës. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me numrat për dyshet e nxënësve, fletë të formatit të madh për shkrimin e numrit 8.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komentimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatim dhe ngjyrosje).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

U jepen nxënësve etiketat me numra (0-8) dhe u kërkohet renditja e numrave nga më i vogli te më i madhi dhe anasjellas. Nxënësit vepron në dyshe.



Hapi 2

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fletë të vogla, ku do të ushtrohen për të shkruajtur drejt numrin 8, duke i bashkuar pikat, dhe do të ngjyrosin 8 bletët e paraqitura në fletë.

Hapi 3

Nxënësit hapin librat dhe fillimisht luajnë në çifte, duke u bazuar në ilustrimin e detyrës 1. Nxënësi i parë vendos duart mbi bankë dhe kërkon nga shoku/shoqja t'i tregojë numrin e gishtave që mungojnë. Më pas nxënësit shkruajnë numrin 8, ngjyrosin në bazë të kërkesës së detyrës dhe plotësojnë numrin 8. Pasi të përfundojnë detyrat në libër, nxënësit ndërrojnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Nxënësit në çifte luajnë lojën me etiketat e numrave 0-10. Njëri nxënës vendos në bankë një numër dhe kërkon nga nxënësi tjetër që e ka në çift të vendosë numrin para dhe pas numrit në fjalë. Ata përsëritin disa herë veprimin duke i ndërruar rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Përgjigjet e dhëna gjatë renditjes së numrave në rritje nga 0 deri në 8 dhe në zbritje nga 8 në 0.

Vlerësimi i ndërsjellë i shokut/shoqes.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës:	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
<ul style="list-style-type: none"> - numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20; - lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20. 	Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2; 3.3, 4, 5, 6; 5.1.		

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.18 Kuptimi për numrin 9	Fjalët kyçe: nëntë, gjëgjëzë, radhë, lojë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:	
<ul style="list-style-type: none"> - tregon aq gishta sa shkruan etiketa që ka paraqitur mësuesi/ja, pa e përmendur numrin me zë; - plotëson detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre; - radhitet në bazë të numrit që ka në etiketë gjatë lojës. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - trego aq gishta sa shkruan etiketa që ka paraqitur mësuesi/ja pa e përmendur numrin me zë; - duartrokit aq herë sa është numri që mësuesi/ja ka nxjerrë; - numëro sendet në ilustrimin e bibliotekës; - radhit në rend në bazë të etiketës që ke në dorë gjatë lojës. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, gjëgjëza për numrat.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me numra, copa letre me ngjyrat e semaforit.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (gjëgjëza), Edukatë muzikore (ritmi gjatë duartrokitjeve) dhe Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Zhvillohet një lojë. Mësuesi/ja ngre një etiketë me njërin nga numrat e mësuar deri tani dhe nxënësit duhet të nxjerrin aq gishta sa tregon etiketa, pa e përmendur numrin me zë. Përsëritet disa herë veprimi, nxënësit duartrokin aq herë sa është numri që mësuesi/ja ka nxjerrë.

Hapi 2

Nxënësit mund të krijojnë situata të thjeshta problemore të nxitur nga figurat apo sendet përreth ose zgjidhin gjëgjëzat.

Në një pellg me 6 bretkosa,
herët në mëngjes erdhën edhe 3 rosa.
Sa u bënë gjithsej rosa dhe bretkosa?

Hapi 3

Udhëzohen nxënësit të hapin librat, të vëzhgojnë figurën, të diskutojnë për bibliotekën, numrin e librave që kanë nxënësit personalisht dhe për rëndësinë e bibliotekës për një familje. Më pas, do të numërohen librat e vendosur në raftet e bibliotekës dhe gjësendet tjera për rreth. Vazhdohet edhe me detyrat e tjera në tekst dhe nxënësit mbajnë afër letrat me ngjyrat e semaforit. Në varësi të ngjyrave që ngrenë nxënësit, mësuesi/ja kupton se kush ka nevojë për ndihmë.

Hapi 4

Nxënësit do të marrin nga një etiketë me numër (numrat 0 deri në 9 të përzier) dhe më pas do të vendosen në radhë prej 0-9. Përsëritet veprimi, në mënyrë që të marrin pjesë të gjithë nxënësit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për punët individuale në veprimtaritë e realizuara.

Përgjigjet e dhëna në zgjidhjet e gjëgjëzave.

Respektimin e rregullave gjatë lojës me etiketa.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20; - lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20. 	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.19 Numri 9	Fjalët kyçe: nëntë, fije shkrepëseje, figurë, etiketa.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - krijon figura me materiale të ndryshme; - shkruan numrin 9 në tekst, duke bashkuar pikat; - gjej numrat që nevojiten për të formuar numrin 9 gjatë lojës me etiketa. 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - krijo figurë me fije shkrepëseje apo me shkopinj plastikë; - shkruaj drejt numrin 9 në tekst; - formo numrin 9, duke plotësuar numrin e shokut/shoqes gjatë lojës. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fije shkrepëseje, fletë A/4, ngjitës, etiketa me numrat 0 deri në 9.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve).	

Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Nxënësve u kërkohet të punojnë me një shok/shoqe për të formuar numrin 9 me gishta. Mësuesi/ja zgjedh disa dyshe nxënësish, të cilët do të tregojnë se si mund të formojnë numrin 9, duke i përdorur të dyja duart.

Hapi 2

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fije shkrepëseje (kujdesemi që numri i tyre të mos e kalojë numrin 9), fletë A4 dhe ngjitëse. Udhëzon nxënësit që në çifte të krijojnë nga një figurë me fije shkrepëseje, duke i ngjitur ato në letër. Më pas, njëri nxënës prej çiftit prezanton punën e bërë dhe mësuesi/ja e pyet se sa fije shkrepësesh ka përdorur për punim. Nxënësit shkruajnë nën vizatim numrin e tyre.

Hapi 3

Udhëzohen nxënësit të hapin librat dhe të punojnë detyrat e dhëna në tekst. Rëndësi të veçantë i kushtohet shkrimit të numrit 9 në tekst, ngjyrosja e 9 vagonëve të trenit me dy ngjyra dhe identifikimit të numrave që krijojnë numrin 9. Udhëzohen nxënësit që pas përfundimit të detyrave në tekst, të shkëmbejnë librat dhe të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Luhet loja “Formoni numrin 9”. Nxënësit ndahen në çifte dhe të dy nxënësit janë të pajisur me letra të numrave prej 0 deri në 9. Kur nxënësi i parë ngrë një etiketë, detyra e nxënësit tjetër në çift është të gjejë numrin i cili bashkë me numrin e shokut/shoqes formon numrin 9. Përsëritet veprimi disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet shkathhtësia e nxënësit/es gjatë formimit të numrit 9 me gishta në çifte. Krijimi i figurës me fije dhe identifikimi i numrit të tyre.

Plotësimi i numrin 9 gjatë lojës me etiketa.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/ vizatime.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuuese produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.20 Kuptimi për numrin 10	Fjalët kyçe: dhjetë, boshti numerik, etiketa, forma.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen vendin në rend sipas numrit që mban; - formon numrin 10 me bashkimin e dy numrave të tjerë; - zbulon numrin e formave në figurën e krijuar nga shoku/shoqja. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej vendin e duhur në rend sipas numrit të shënuar në letër; - formo numrin 10 me dy faqet e zareve; - plotëso detyrat në libër, duke u bazuar në kërkesat e tyre; - zbulo numrin e formave në figurën e krijuar nga shoku/shoqja. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: copa letrash me numrat 1-10, zare, forma të ndryshme për lojë, copa letrash me ngjyrat e semaforit.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë diskutimeve), Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja në tekst), Shoqëria dhe mjedisi (respektimi i rregullave të lojës).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1


Loja mund të zhvillohet në oborr ose në klasë. Mësuesi/ja ndan klasën në grupe me nga 10, u shpërndan nxënësve etiketat me numrat 1 deri në 10, më pas kërkon që të renditen sipas numrave që ka secili. Pas sinjalit të mësueses/it, nxënësit vrapojnë dhe rreshtohen sërish sipas radhës. Veprimi përsëritet edhe me nxënës të tjerë.

Hapi 2

Diskutohet me nxënësit se ku i ndeshin ata numrat në shtëpi, jashtë shtëpie apo në shkollë. Tregohet që ndonjëherë numrat bashkohen për të formuar numra më të mëdhenj (p.sh: numrat 1 dhe 0 në numrin 10). Numërohet në kor deri në 10.

Hapi 3

Mësuesi/ja shpërndan në secilin grup nga dy zare dhe kërkon nga nxënësit që të formojnë numrin 10 nga bashkimi i dy faqeve të zareve. Për shembull:



Hapi 4

Hapen librat, nxiten nxënësit të vërejnë figurat dhe për çdo përshkrim udhëzohen të përdorin edhe numrat. Nxënësit mbajnë afër lerat me ngjyrat e semaforit. Në varësi të letrës që ngrenë nxënësit, mësuesi/ja vlerëson kush ka nevojë për ndihmë.

Hapi 5

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të ndahen në çifte dhe të luajnë lojën me forma. Njëri prej nxënësve krijon një figurë me forma të ndryshme dhe kërkon nga nxënësi tjetër të numërojë sa forma ka përdorur. Më pas, nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Bëhet vlerësim me gojë rreth qëndrimeve të tyre në situatat dhe diskutimet gjatë orës.

Vlerësohen për punët individuale dhe grupore në veprimtaritë e realizuara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20; - lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20. 	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.21 Numri 10	Fjalët kyçe: dhjetë, kapëse, numra, kaushë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - dallon grafikisht numrat 1 deri në 10; - lidh numrin me bashkësinë e objekteve që i përgjigjet; - formon numrat e dhënë me bashkimin e dy numrave tjerë gjatë aktiviteteve. 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - vendos kapësen në vendin e duhur; - nxirr aq gishta sa tregon etiketa, pa e përmendur numrin me zë; - krijo numrin e dhënë në kaushë me numrat tjerë të dhënë në formë rrethore. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: mjeti në formë rrethore i ndarë në 10 pjesë, kapëse rrobash, fletë me ngjyra për aktivitetin e akullores.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komentimi i ilustrimit në libër), Edukatë muzikore (mbajtja e ritmit me shuplaka).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja shpërndan në secilin grup, mjetin e punuar në formë rrethore dhe 10 kapëse rrobash, ku janë vendosur numrat 1-10. Udhëzon nxënësit të vendosin kapëset me numër në pjesët që formojnë numrin e njëjtë të luleve (secili grup ka sende të ndryshme të vizatuara). Një nxënës nga grupi prezanton punën e bërë para klasës.



Hapi 2

Zhvillohet një lojë. Mësuesi/ja ngre një etiketë me njërin nga numrat dhe nxënësit duhet të nxjerrin aq gishta sa tregon etiketa ose copa e letrës, pa e përmendur numrin me zë. Përsëritet disa herë veprimi, nxënësit duartrokasin aq herë sa është numri që mësuesi/ja ka nxjerrë.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vëzhgojnë detyrën e parë, ku do të numërojnë figurat që gjenden në ilustrim. Kujdes i veçantë duhet bërë te shkrimi i numrave dyshifrorë, si numrit 10. Nxënësit do të plotësojnë detyrat individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte e në grup. Nxënësit do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit nëse kanë nevojë për përkrahje.

Hapi 4

Mësuesi/ja ka përgatitur paraprakisht fletë me ngjyra të prera në formën e kaushit të akullores, ku ka shkruar numrat 1-10 dhe fletë me ngjyra në formë rrethore me numrat 0-10, që do të shërbejnë si kupa të akullores. Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe dhe të vendosin kupat në kaushë, sipas numrit që shkruan në të. Nxënësi do të gjejnë kombinime të ndryshme për krijimin e numrave në kaushë.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Do të merren parasysh argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së kapëseve.

Nxënësit do të vlerësohen me gojë për përgjigjet e dhëna në aktivitetin me kaushë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Bashkësitë dhe relacionet			
Rezultati i të nxënit të temës: Krahason bashkësitë, duke përdorur shprehjet “më shumë, më pak, aq sa”.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (2, 4, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1,3; 3.3,4,5,6; 5.1; 6.1,2.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.22 Një më shumë, një më pak	Fjalët kyçe: më shumë, më pak, numër, renditje.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - shkruan numrin që mungon në vargun e numrave; - plotëson detyrat e dhëna sipas udhëzimeve; - identifikon numrin e petëzave në bazë të udhëzimit të shokut/shoqes; 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej numrin që mungon në vargun e numrave; - plotëso detyrat në tekst sipas kërkesës; - vendos numrin e duhur të petëzave në bazë të udhëzimit të shokut/shoqes. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë me vargje numrash, magnetofon, kube.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (recitimi i vjershës), Edukatë muzikore (kërcimi me muzikës), Edukatë figurative (vizatim në libër);	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive të marra më parë. Nxënësve u shpërndahen fletë me vargje numrash deri në 10, ku mungojnë disa kufiza. U kërkohet të plotësojnë vendet bosh.

1, _, 3, _, _, 6, 7, _, _, 10.

Hapi 2

Recitohet përpara klasës vjersha: “Kapa një herë një peshk të gjallë”. Recitimi shoqërohet me veprime:

1, 2, 3, 4, 5, *kapa një herë një peshk të gjallë* 6, 7, 8, 9, 10, *pastaj e lëshova!*

(Çdoherë ngrini lart nga një gisht më shumë).

Pse e lëshove? Sepse më kafshoi gishtin. Cilin gisht të kafshoi? Gishtin e vogël të djathtë.

(Tregoni gishtin e vogël të dorës së djathtë). Përsëritet vjersha, këtë herë së bashku me klasën.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon një grup nxënësish të dalin në mes të klasës. Bëni kujdes që grupi të mos ketë numër të njëjtë vajzash dhe djemsh. Vendoset muzikë në klasë dhe fëmijët nisin të kërcëjnë. Pas disa minutash, muzika ndërrohet. Në këtë rast, fëmijët do të shohin se një shok apo shoqe do të ngelet tek. Pyesni nxënësit: Pse shoku /shoqja mbeti vetëm? Sa djem/vajza janë më pak? Sa djem/vajza janë më shumë?

Hapi 4

Nxënësit hapin librat dhe plotësojnë detyrat e dhëna në tekst. Fillimisht *Winnie the Pooh* u përgjigjet pyetjeve nëse ka më shumë flutura apo lule. Më pas udhëzohen nxënësit të plotësojnë detyrat e dhëna në libër. Mësuesi/ja u qëndron afër në rast se kanë ndonjë vështirësi apo kërkojnë ndonjë sqarim shtesë.

Hapi 5

Nxënësit luajnë në çifte me kube. Nxënësi i parë vendos mbi bankë disa kube dhe udhëzon të dytin të vendosë një më pak ose një më shumë. Më pas, nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen me gojë rreth qëndrimeve të tyre në situatat dhe diskutimet gjatë orës.

Vlerësohen për punët individuale në veprimtaritë e realizuara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Tregon paraardhësin, pasardhësin, qëndron ndërmjet, të numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6). Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.		

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.23 Numri para, numri pas	Fjalët kyçe: para, pas, numër, rend.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - rendit numrat nga më i vogli te më i madhi dhe anasjellas; - identifikon numrat para dhe pas numrit të dhënë në detyrat e dhëna; - formulon shembuj të rinj në fletoren e tij/saj. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - rendit numrat e dhënë nga më i vogli te më i madhi dhe anasjellas; - gjej numrat para dhe pas numrit të dhënë në “Shiritin e numrave”; - shkruaj shembuj të ngjashëm me ata të rubrikës “Mësova”. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me numrat 1 deri në 10, “Shiriti me numra”;
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Edukatë fizike, Sportet dhe shëndeti (kërcimi në “Shiritin e numrave”); Edukatë figurative (vizatimi në libër dhe fletore), Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve);	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve etiketa me numra (p.sh.: 3, 5, 1, 6, 2, 7) dhe kërkon të bëjnë renditjen e numrave nga më i vogli te më i madhi dhe anasjellas. Veprimi përsëritet disa herë.

Hapi 2

Mësuesi/ja fton tre nxënës të dalin në tabelë. Nxënësit në mes i jepet jep një numër, numri 3, për shembull. Kërkon nga nxënësit të tregojnë se cili numër është para numrit 3 dhe nxënësi i parë e merr etiketën me numrin 2. Më pas, pyet se cili numër vjen pas numrit 3 dhe nxënësi i tretë merr etiketën me numrin 4. Aktiviteti përsëritet me një numër tjetër, për shembull me numrin 5.

Hapi 3

Nxënësit hapin librat dhe fillimisht *Winnie The Pooh* u përgjigjet pyetjeve bazuar në foton e tekstit. Më pas, nxënësit plotësojnë detyrat e dhëna në tekst dhe gjatë punës diskutojnë zgjidhjet e bëra në çifte dhe në grup.

Hapi 4

Vendoset “Shiriti me numra” në mes të klasës dhe kërkohet që një nxënës nga secili grup (nëse nxënësit nuk janë të ulur në grupe, mësuesi/ja gjen formë tjetër përzgjedhjeje) të qëndrojë mbi njërin numër (të përzgjedhur nga vetë nxënësi) dhe të pyesin shokët/shoqet se cilin numër kanë para e cilin numër kanë pas. Një nxënës shënon në tabelë numrat e përzgjedhur dhe numrat para dhe pas tyre.

Hapi 5

Udhëzohen nxënësit të shkruajnë në fletoret e tyre disa shembuj të numrave para dhe pas, njësoj si te rubrika “Mësova”.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet renditja e numrave nga më i vogli te më i madhi dhe anasjellas.

Vlerësohet aftësia për të identifikuar numrat që janë para dhe pas numrit të dhënë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Tregon paraardhësin, pasardhësin, qëndron ndërmjet, të numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesoretë shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2;3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.24 Numri ndërmjet	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - rendit numrat në rendin rritës ose zbritës deri në 10; - përdor boshtin numerik për të gjetur një numër ndërmjet dy numrave të dhënë deri në 10; - dallon me ngjyrën e kërkuar numrat që gjenden ndërmjet numrave të dhënë. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - rendit numrat 1 deri në 10 në rendin rritës ose zbritës; - përdor boshtin numerik për të gjetur një numër ndërmjet dy numrave të dhënë deri në 10; - numëro në rendin rritës dhe zbritës 10 numrat e parë. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: letra të mëdha me numra nga 1 në 10 për nxënësit, boshte të mëdha numerike me numra të lëvizshëm (numrat mund të kapen me kapëse në një spango)
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë zgjidhjes së detyrave), Edukatë figurative (vizatim dhe ngjyrosje gjatë plotësimit të detyrave).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Zhvillohet një lojë për shpjegimin e fjalës “Ndërmjet”.

Mësuesi/ja vizaton në dysheme një shirit numerik ose një bosht të madh numerik me numra nga 1 në 10. Zgjedh dy nxënës që të vendosen mbi bosht. Ata mund të qëndrojnë ku të dëshirojnë, por ndërmjet tyre duhet të ketë hapësirë. Mësuesi/ja vendoset në ndonjë numër ndërmjet të dyve. Bën pyetjen: “Çfarë do të thotë “ndërmjet”? Vështroni ku po qëndrojnë. Unë jam ndërmjet të dyve.

Përsëritet me nxënës të tjerë, në pozicione të tjera të boshtit numerik.

U jep tre nxënësve nga një letër me numra (4, 7, 9). Përsëri bën pyetjet:

- Cilët janë numrat mes 2 dhe 5?
- Mund të thoni se mbi cilin numër jeni në bosht?

U kërkon dy nxënësve të tjerë të tregojnë numrat e tyre dhe më pas të qëndrojnë në vendin e tyre mbi bosht.

- Kush po qëndron ndërmjet dy nxënësve?
- Sa është numri i nxënësit ndërmjet të tjerëve?

- Cili numër vjen ndërmjet dy nxënësve të tjerë?

Përsëriteni me të gjithë nxënësit, derisa të jenë përfshirë në lojë të gjithë nxënësit.

Hapi 2

Tregohet një bosht numerik me numra të renditur gabim. Numrat të jenë të kapur me kapëse, në mënyrë që të mund të lëvizen. Mësuesi/ja pyet: “Çfarë gabimi ka në këtë bosht numerik? Ejani ta rregullojmë!”

Hiqini të gjithë numrat. Zgjidhet një nxënës që të gjejë një numër. U kërkohet nxënësve që ta vendosin këtë numër mbi vijë (me kapëse) dhe, ndërsa e bëjnë, duhet të thonë: “Unë kam numrin...”

Ai do të vendoset ndërmjet numrave 3 dhe 9.

Vazhdoni me lojën derisa të vendosen të gjithë numrat. Nxitini nxënësit të përshkruajnë veprimet e tyre, duke përdorur fjali të plota, si: “Unë kam numrin 5. Shkon ndërmjet numrave 4 dhe 6”.

Hapi 3

Nxënësit udhëzohen të hapin librat dhe të fillojnë plotësimin e detyrave të dhëna në tekst. Fillimisht, *Winnie the Pooh* u përgjigjet pyetjeve të dhëna bazuar në foton e tekstit. Më pas, nxënësit plotësojnë detyrat e tjera në tekst dhe mësuesi/ja ndihmon vetëm atyre nxënësve që kanë vështirësi.

Hapi 4

Nxirrni para klasës 8 nxënës. Secilit i jepet nga një numër nga 1 në 8, por pa e ditur ata numrin që u është caktuar. Nxënësit e tjerë i udhëzojnë këta 8 nxënës, në mënyrë që të vendosen sipas radhës së saktë të numrave që kanë. Ata duhet të përdorin termat “përpara”, “pas” dhe “ndërmjet” për çdoherë.

Hapi 5

Nxënësit në fletoret e tyre shënojnë nga tre numra me radhë dhe nënvizojnë me ngjyrë të kuqe numrin që gjendet ndërmjet dy numrave të tjerë. Përsëritin shkrimin tri herë me numra të ndryshëm.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Bëhet vlerësimi me gojë për renditjen e numrave në boshtin numerik.

Vlerësohet përdorimi i termave “përpara”, “pas” dhe “ndërmjet”.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.25 Numri ndërmjet	Fjalët kyçe: Numër, numëroj, më shumë, më pak.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - tregon numrat nga 1 në 10 në rendin rritës dhe zbritës; - zgjidh situata problemore të nivelit praktik nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme; - identifikon bashkësi me 1-10 objekte nga mjedisi. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - numëro nga 1 në 10 në rendin rritës dhe zbritës; - plotëso librin duke respektuar kërkesat e detyrave; - vizato objektet, duke u bazuar në udhëzimet e marra nga mësuesi/ja. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me numrat 1-10, objekte rrethore, lodra të vogla për fëmijë, numëruet etj.
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatimi i objekteve).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	

Hapi 1

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive të marra më parë.

Mësuesi/ja ngre nxënës që thonë numrat nga 1-10 dhe anasjellas, disa i shkruajnë në tabelë numrat, duke nxjerrë aq gishta/ mjete sa tregojnë numërori etj.

Hapi 2

Mësuesi/ja ka përgatitur kube kartoni, të një madhësie të dukshme për të gjithë klasën ose merr topa ping-pongu, a mjete të tjera numërimi sipas mundësisë. Në një qese të tejdukshme fut disa nga ato dhe nxit nxënësit të thonë sa sende mund të ketë aty. Nxirren objektet nga qesja dhe nxënësit i numërojnë njëzëri. Numri shkruhet në tabelë. Përsëritet veprimtaria me numër të ndryshëm objektësh.

Hapi 3

Klasa e ndarë në grupe, në varësi të numrit të nxënësve ose në çifte sipas tavolinave, zhvillojnë veprimtari të ngjashme ato të mësipërmet, duke përdorur mjetet që kanë sjellë me vete. Udhëzohen të numërojnë librat, fletoret, lapsat etj.

Hapi 4

Hapen librat, udhëzohen nxënësit të punojnë detyrat e dhëna në libër. Ata do të plotësojnë numrat që mungojnë në boshtin numerik dhe do të renditin numrat nga më i vogli te më i madhi në detyrat e dhëna, në varësi të kërkesës së detyrës. Nxënësit punojnë individualisht, më pas diskutojnë në çifte dhe në grup.

Hapi 5

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve **fletë** formati A4 dhe udhëzon nxënësit **për të** vizatuar 3 mollë, 4 lule, 5 topa etj.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet numërimi nga 1 në 10 në rendin rritës dhe zbritës.

Plotësimi i detyrave të dhëna në tekst.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Bashkësitë dhe relacionet			
Rezultati i të nxënit të temës: Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet “më shumë, më pak, aq sa”.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (2, 4,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1,3; 3.3,4,5,6; 5.1; 6.1,2.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.26 Krahasimi i numrave	Fjalët kyçe: më i madh, më i vogël, më shumë, më pak.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - dallon bashkësitë që kanë më shumë apo më pak elemente; - krahason bashkësitë në bazë të numrit të elementeve; - vendos shenjën “më e madhe” apo “më e vogël” në bazë të kërkesës së detyrës. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - gjej se kush ka më shumë apo më pak lapsa me ngjyra në kuti; - vendos shenjën “më e madhe” apo “më të vogël”, të ilustruar në mes kutive; - shkruaj çifte numrash 1 deri 10 për shokun/shoqen dhe vendos shenjën përkatëse. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me numrat 1-10, ilustrime me shenjat “më e madhe” dhe “më e vogël”, kuti lapsash, ngjyra druri.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (ngjyrosja dhe vizatimi në tekst), Njeriu dhe natyra (figura kafshësh me shenjat më e madhe apo më e vogël në gojë).	

Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Udhëzohen nxënësit të nxjerrin kutitë e lapsave me ngjyrë mbi bankë. Secili nxënës duhet të lërë në kuti 1 deri në 10 ngjyra. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin kutitë dhe të krahasojnë numrin e ngjyrave me njëri-tjetrin në çifte. Nxënësit pyesin shokun/shoqen: “Sa ngjyra ke në kuti?” Kush ka më shumë ngjyra në kuti? Kush ka më pak ngjyra?

Hapi 2

Mësuesi/ja i shpërndan secilit çift shenjat “më e madhe”, “më e vogël” të ilustruara dhe udhëzon nxënësit të vendosin shenjën e duhur në mes të kutive të lapsave. Më pas, nxënësit ndërrojnë kutitë e lapsave dhe ndërrojnë shenjën në mes.



Hapi 3

Nxënësit hapin librat dhe fillojnë të zgjidhin detyrat e tekstit. Fillimisht ndihmojnë personazhin të gjejë çfarë ka më shumë e çfarë më pak në ilustrimin e librit. Më pas vazhdojnë me ushtrimet tjera, duke punuar individualisht e, më tej, në çifte e në grup. Mësuesi/ja u qëndron afër nëse hasin ndonjë vështirësi gjatë plotësimit të tekstit. Rëndësi të veçantë i jepet kuptimit të shenjave “më e madhe” apo “më e vogël”.

Hapi 4

Nxënësit pajisen me etiketa me numrat 1 deri në 10 dhe udhëzohen të vendosin secili nga një numër mbi bankë dhe më pas të vendosin shenjën e duhur, “më e madhe” apo “më e vogël”. Përsëritet aktiviteti disa herë, në mënyrë që të familjarizohen me këto shenja.

Hapi 5

Nxënësit shkruajnë në fletoret e njëri-tjetrit çifte numrash 1 deri në 10 dhe më pas kërkojnë nga shoku/shoqja të vendosin shenjën < ose >. Përsëritet aktiviteti dy ose tri herë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vendosja e shenjës së duhur “më e madhe” apo “më e vogël”.
Plotësimi i detyrave të dhëna në tekst vlerësohet me shenja.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.27 Krahasimi i numrave	Fjalët kyçe: numër, më i vogël, më i madh, renditje.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - rendit numrat nga më i vogli te më i madhi dhe anasjellas; - vendos shenjat < dhe > varësisht prej kërkesës së detyrës; - vlerëson punimin e shoqes/shokut në “Telin tharës”. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - rendit rezultatet e marra gjatë hedhjes së zarit; - numëro nga 1 deri në 10 dhe anasjellas; - krijo shenjat < dhe > me materiale të ndryshme. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me numrat 1 deri në 10, zare, fletë A4, oriz, ngjitëse, teli tharës, kapëse.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Shkathtësi për jetë (krijimi i shenjave <, > me kokrra orizi), Edukatë figurative (vizatimet dhe ngjyrosja), Shoqëria dhe mjedisi (krijimi i rregullave të lojës).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja shpërndan për secilin grup nxënësish nga një zar. Të gjithë nxënësit, aq sa ka grupi, hedhin zarin nga dy herë. Një nxënës shënon në një fletë rezultatet e gjuajtjeve. Më pas, udhëzohen nxënësit të renditin numrat e dalë nga më i vogli te më i madhi dhe anasjellas. Numrat që kanë qëlluar të njëjtë, mund të shënohen vetëm një herë.

Hapi 2

Mësuesi/ja formon një rreth me nxënësit dhe fillon numërimin nga 1 deri në 10 dhe më pas, menjëherë pas numrit 10 vazhdon me 9 e deri në 1. Përsëritet numërimi nga 1 deri në 10 dhe anasjellas, disa herë.

Hapi 3

Nxënësit hapin librat dhe plotësojnë detyrat e dhëna në test. Ata duhet të vendosin shenjat < dhe > dhe të renditin numrat sipas kërkesës së detyrave. Gjithmonë, theks i veçantë vihet mbi kuptimin në formë figurative të shenjave, duke ua theksuar nxënësve që “goja” hapet nga numri i madh.

Hapi 4

Nxënësve u shpërndahen fletë A4, kokrra orizi dhe ngjitëse. Udhëzohen që të shkruajnë numrat 1 deri në 10 dhe 10 deri në 1, dhe në mes tyre të vihen shenjat < dhe > me kokrra orizi të ngjitura. Kokrrat e orizit mund të ngjyrosen me ngjyrë sipas dëshirës së nxënësit.

Hapi 5

Nxënësit vendosin fletët e tyre në “Telin tharës” dhe vlerësojnë me plus punimet që u pëlqejnë më shumë. (Turi i galerisë)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Renditja e numrave nga më i vogli te më i madhi dhe anasjellas;
Shkrimi i numrave 1 deri në 10 dhe 10 deri në 1.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

TEMA 2: MBLEDHJA E NUMRAVE ME SHUMË DERI NË 10

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënësve të temës: Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshesën e numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 2.1 Mbledhje me shumë deri në 4	Fjalë kyçe: mbledhja, mbledhorët, shuma, barazimi.		
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore			
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - përshkruan mbledhjen si vazhdim i numërimit në rendin rritës dhe si bashkim i dy grupeve; - mbledh dy numra, duke përdorur numërorët që formojnë numrin 4; - verifikon rezultatin e mbledhjes të detyrat e shokut/shoqes para kontrollit nga mësues/ja. 			
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> - përshkruaj mbledhjen si vazhdim i numërimit në rendin rritës dhe si bashkim i dy grupeve; - mbledh dy numra, duke përdorur numërorët që formojnë numrin 4; - verifiko rezultatin e mbledhjes të detyrat e shokut/shoqes para kontrollit nga mësues/ja. 			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: letra të vogla me numra, top plazhi, shkumësa me ngjyra, kube, fleta A/4, lapsa shënjuar (markera).		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë fizike, sporte dhe shëndeti (aktivitetet), Shoqëria dhe mjedisi (respektimi i rregullave të lojës).			
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1			
Përdoret një top plazhi, mbi të cilin janë shkruar numra.			
Nxënësit vendosen në një rreth ose përballë njëri-tjetrit në çifte. Hidhet ose rrotullohet topi i plazhit para dhe mbrapa. U shpjegohet se kurdo që të kapin topin, duhet të thonë me zë të lartë numrat që kanë kapur me gishtat e mëdhenj. Duhet t’i mbledhin të dy numrat që kanë nën gishta, përpara se të kalojnë topin te një nxënës tjetër. Loja vazhdon derisa të gjithë nxënësve t’u ketë rënë topi më shumë se një herë.			
Hapi 2			
Mësuesi/ja vizaton një bosht të madh numerik në dyshe.			

Mund të sajojë një histori: për të kapur karotën, një lepuri që për të kapur karotën i duhet të kërcejë në fillim 2 hapa dhe pastaj përsëri dy hapa të tjerë.

- Pas sa hapash e kap lepuri karotën?

Ngrihet një nxënës dhe fillon të kërcejë nga zeroja deri te numri 2, pastaj kërcen edhe 2 hapa të tjerë.

- *Te cili numër shkoi?*

Pra, $2 + 2 = 4$

Vazhdohet sërish dhe përsëriten barazime.

Hapi 3

Nxënësit vëzhgojnë figurën në tekst dhe numërojnë. Nxiten të tregojnë me fjalë se 3 dhe 1 bëjnë 4 dhe me barazim $3 + 1 = 4$. Më pas, vazhdojnë me plotësimin e detyrave 1, 2 dhe 3, ku do të plotësojnë barazimet duke u bazuar në boshtin numerik. Në detyrën 3, nxënësit do të gjejnë shumën në barazimet e dhëna dhe më pas shkëmbejnë detyrën me njëri-tjetrit. Kontrollonjë për disa minuta detyrën e shokut/ shoqes. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi-autori korrigjon gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij. (Kontrolli para fluturimit)

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vëzhgojnë lojën në tekst dhe të luajnë në çifte. Njëri nxënës nxjerr një etiketë të numrave 1-4, kurse shoku/shoqja duhet të nxjerrë copat e vogla të letrës me numrat që japin atë shumë. Për shembull: nxënësi i parë nxjerr copën e letrës me numrin 0; më pas vazhdohet me 3 dhe 1 ose 2 dhe 2. Veprimi përsëritet disa herë, derisa të kenë marrë pjesë të gjithë nxënësit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Kontrolli para fluturimit”- nxënësit do të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit para dorëzimit te mësuesi/ja.

Plotësimi i barazimeve të dhëna në tekst.

Nxjerrja e etiketave të numrave që japin shumën e dhënë nga shoku/shoqja.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshesën e numrave nga 1 deri në 20;	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.2 Mbledhje me shumë deri në 4	Fjalë kyçe: shuma, mbledhorët, bosht numerik, pesë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - paraqet mbledhjen e dy numrave në boshtin numerik; - thekson qartë numrat gjatë interpretimit të vjershave ritmike; - përdor materiale të ndryshme për të zgjidhur barazimin. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - paraqit mbledhjen e dy numrave në boshtin numerik; - thekso qartë numrat gjatë interpretimit të vjershave ritmike; - përdor materiale të ndryshme për të zgjidhur barazimin. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, vjersha ritmike, gjëgjëza.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkumësa me ngjyrë, kube të madhësive të ndryshme.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1


Mësuesi/ja vizaton një bosht të madh numerik në tokë.

Mund të sajojë një histori për një lepur të cilit, për të kapur karotën, i duhet të kërcejë në fillim tre hapa dhe pastaj një hap tjetër.

- Pas sa hapash e kap lepur i karotën?

Një nxënës/e ngrihet dhe fillon të kërcejë nga 0 deri në 3, pastaj kërcen edhe një hap tjetër.

- Te cili numër arriti? Pra: $3 + 1 = 4$



Vazhdohet sërish dhe përsëriten barazimet.

Hapi 2

Përdoren këngë, vjersha dhe përralla për t'i bërë nxënësit të kenë vetëbesim me numrat, kur numërojnë në rend rritës apo zbritës. Mund të përdoren vjersha ritmike, si: “5 rikat e vogla”, “5 bretkosat pikaloshë”, “10 në një shtrat”. Mësuesi/ja shfrytëzon rastin për të dëgjuar nëse nxënësit i shqiptojnë numrat në mënyrë të saktë.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku është paraqitur boshti numerik dhe ecuria e mbledhjes së numrave 3 dhe 2.

Nxënësit do të vrojojnë mbledhjen në boshtin numerik dhe më pas do të vizatojnë shigjetat për mbledhjet e dhëna. Hapi i fundit është të shkruhen barazimet. Udhëzohen nxënësit të punojnë me boshtin numerik që është i vizatuar në dysheme.

Vazhdohet me plotësimin e detyrës së tretë dhe të katërt. Në detyrën e katërt udhëzohen nxënësit të gjejnë shumën në libër, duke punuar me kube formuese (*Lego*) apo me materiale të ndryshme, ku duhet t'i kushtohet më shumë kujdes plotësimit të numrit 5. Nxënësit do të punojnë individualisht e, më pas, do të diskutojnë në çifte e në grup. Gjatë punës, nxënësit do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit, nëse kanë nevojë për ndihmë apo nuk e kuptojnë detyrën.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Loja luhet në çifte, ku nxënësi i parë shkruan një barazim dhe kërkon nga nxënësi i dytë ta paraqesë me kube. Veprimtaria përsëritet derisa numri 5 të jetë formuar në disa variante. Më pas, nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Semafori” - përdorimi i letrave me ngjyrat e semaforit nga nxënësit.
Shkrimi i barazimit, duke u bazuar në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

**Një, dy, tre!
Të pimë çaj ne.
Katër, pesë, gjashtë!
Çaj do të pimë jashtë.
Shtatë, tetë, nëntë!
Vonë do të rrimë.
Në orën dhjetë,
kur qielli është i qetë.**

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshesën e numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.3 Mbledhje me shumë 5	Fjalë kyçe: shuma, mbledhorët, plotësim, pesë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - zbulon shumën nga udhëzimet e marra nga mësuesi/ja gjatë lojës “Peshqit dhe peshkaqeni”; - shkruan barazimin, duke u bazuar në të dhënat gjatë aktivitetit; - luan, duke respektuar rregullat e lojës të vendosura paraprakisht. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - zbulon shumën nga udhëzimet e marra nga mësuesi/ja gjatë lojës “Peshqit dhe peshkaqeni”; - shkruaj barazimin, duke u bazuar në të dhënat gjatë aktivitetit; - luaj, duke respektuar rregullat e lojës të vendosura paraprakisht. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, përralla “Iriqi dhe mollët”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube formuese (<i>Lego</i>), letrat me ngjyrat e semaforit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (koment i shkurtër i përrallës “Iriqi dhe mollët”).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të ngrihen në këmbë dhe të vendosen në mes të klasës (nëse nuk ka vend të mjaftueshëm, dilen në oborr). U tregon nxënësve rregullat e lojës “Peshqit dhe peshkaqeni”, të cilën e kanë të njohur nga njësinë e kaluar.

- Dy nxënës do të përzgjidhen të luajnë rolin e peshkaqenit, kurse të tjerët janë peshqit.
- Vëmendja duhet të jetë e përqendruar tek udhëzimet që jep mësuesi/ja.
- Krijohen grupet sipas udhëzimeve.
- Nxënësit që nuk do të arrijnë të krijojnë grupe, do të ulen në bankë.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të grupohen 2 nga 2. Më pas i udhëzojmë të grupohen 5 dhe 0, 4 dhe 1, 3 dhe 2, 2 dhe 2, 1 dhe 3, 4 dhe 0, 1 dhe 2, 2 dhe 0, 2 dhe 1 (kujdesemi të mos e kalojmë shumën 5).

Hapi 2

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të zhvillojnë një aktivitet në çift. Njëri nga nxënësit vendos mbi bankë kubet formuese (*Lego*) (1-5). Detyra e nxënësit tjetër është të nxjerrë edhe aq kube formuese sa nevojiten që të krijohet numri 5. Shkruhet barazimi në fletore. Loja përsëritet dhe nxënësit ndërrojnë rolet. Nxënësit lexojnë me zë të lartë barazimet e shkruara në fletore.



Nx. 1 Nx. 2 Nx. 1 Nx. 2 Nx. 1 Nx.2

4 1; 3 2; 2 3;

$4 + 1 = 5$

$3 + 2 = 5$

$2 + 3 = 5$

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku janë paraqitur dy lloje lulësh. Nxënësit do të numërojnë lulet në ilustrim dhe do të mbledhin lulet e njëllojta. Në detyrën e dytë janë paraqitur iriqë me mollë në shpinë. Së pari, shkurtimisht do të rikujtohet përralla “Iriqi dhe mollët”, ku bëhet ndërlidhja më gjuhën shqipe. Më pas, nxënësit do të vizatojnë në shpinën e iriqit aq mollë sa duhen shtuar për t’u formuar numri 5. Vazhdohet me plotësimin e detyrës së tretë, ku duhet të bëhet kujdes i veçantë në plotësimin e numrit 5. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte dhe në grup. Gjatë punës, nxënësit do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit nëse kanë nevojë për ndihmë apo nëse nuk e kuptojnë detyrën.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Loja luhet në çift, ku nxënësi i parë vendos dorën në bankë, ku ka nxjerrë 1-5 gishta dhe kërkon nga nxënësi i dytë të nxjerrë aq gishta sa nevojiten për të plotësuar numrin 5. Veprimi përsëritet pasi janë përdorur të gjitha mundësitë për krijimin e numrit 5. Më pas, nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Semafori” - përdorimi i kartave nga nxënësit.

Shkrimi i barazimit, duke u bazuar në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshesën e numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.4 Mbledhje me shumë 5	Fjalë kyçe: shuma, mbledhorët, bosht numerik, pesë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - paraqet mbledhjen e dy numrave në boshtin numerik; - thekson qartë numrat gjatë interpretimit të vjershave ritmike; - përdor materiale të ndryshme për të zgjidhur barazimin. 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - paraqit mbledhjen e dy numrave në boshtin numerik; - thekso qartë numrat gjatë interpretimit të vjershave ritmike; - përdor materiale të ndryshme për të zgjidhur barazimin. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, vjersha ritmike, gjëgjëza.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkumësa me ngjyrë, kube të madhësive të ndryshme.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1


Mësuesi/ja vizaton një bosht të madh numerik në tokë.

Mund të sajojë një histori për një lepur të cilit, për të kapur karotën, i duhet të kërcejë në fillim tre hapa dhe pastaj një hap tjetër.

Pas sa hapash e kap lepur i karotën?

Një nxënës/e ngrihet dhe fillon të kërcejë nga 0 deri në 3, pastaj kërcen edhe një hap tjetër.

- Te cili numër arriti? Pra: $3 + 1 = 4$



Vazhdohet sërish dhe përsëriten barazimet.

Hapi 2

Përdoren këngë, vjersha dhe përralla për t'i bërë nxënësit të kenë vetëbesim me numrat, kur numërojnë në rend rritës apo zbritës; mund të përdoren vjersha ritmike, si: “5 rikat e vogla”, “5 bretkosat pikaloshë”, “10 në një shtrat”. Mësuesi/ja shfrytëzon rastin për të dëgjuar nëse nxënësit i shqiptojnë numrat në mënyrë të saktë.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku është paraqitur boshti numerik dhe ecuria e mbledhjes së numrave 3 dhe 2.

Nxënësit do të vrojtojnë mbledhjen në boshtin numerik dhe më pas do të vizatojnë shigjetat për mbledhjet e dhëna. Hapi i fundit është të shkruhen barazimet. Udhëzohen nxënësit të punojnë me boshtin numerik që është i vizatuar në dysheme.

Vazhdohet me plotësimin e detyrës së tretë dhe të katërt. Në detyrën e katërt udhëzohen nxënësit të gjejnë shumën në libër, duke punuar me kube formuese (*Lego*) apo me materiale të ndryshme, ku duhet t'i kushtohet më shumë kujdes plotësimit të numrit 5. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte e në grup. Gjatë punës, nxënësit do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit, nëse kanë nevojë për ndihmë apo nuk e kuptojnë detyrën.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Loja luhet në çifte, ku nxënësi i parë shkruan një barazim dhe kërkon nga nxënësi i dytë ta paraqesë me kube. Veprimtaria përsëritet, derisa numri 5 të jetë formuar në disa variante. Më pas, nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Semafori” - përdorimi i letrave me ngjyrat e semaforit nga nxënësit.
Shkrimi i barazimit, duke u bazuar në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

**Një, dy, tre!
Të pimë çaj ne.
Katër, pesë, gjashtë!
Çaj do të pimë jashtë.
Shtatë, tetë, nëntë!
Vonë do të rrimë.
Në orën dhjetë,
kur qielli është i qetë.**

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Zbaton vetinë e ndërrimit dhe të shoqërimit për mbledhjen e numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5), Individ i shëndoshë V (2, 5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.5 Ndërrojmë vendet e mbledhorëve	Fjalët kyçe: mbledhorë, ndërrim i vendeve, shumë, rend, situatë problemore.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - identifikon numrin e elementeve në grupime që shtohen me një numër të caktuar elementesh të tjera; - argumenton faktin që ndryshimi i rendit të mbledhjes, nuk ndryshon shumën përfundimtare; - gjen shumën e dy mbledhorëve, duke u ndërruar vendet. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - identifikoj numrin e elementeve në grupime që shtohen me një numër të caktuar elementesh të tjera; - argumentoj faktin që ndryshimi i rendit të mbledhjes, nuk ndryshon shumën përfundimtare; - gjej shumën e dy mbledhorëve, duke u ndërruar vendet. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: letra të vogla me numra, lodra, fruta, mjete shkollore.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë diskutimeve).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	

Hapi 1

Nxënësit do të punojnë në dyshe me mjetet shkollore, lodrat, frutat e sende të tjera që kanë sjellë nga shtëpitë e tyre. Me mjetet që kanë në dispozicion, ata do të krijojnë një tregim në dyshe, ku nuk do të përdorin më shumë se 5 objekte. Udhëzohen të përcaktojnë vetë numrin e objekteve që do të nxjerrin për të plotësuar numrin. Nxënësit do të vlerësojnë përgjigjet e shokëve/shoqeve (vlerësim i ndërsjellë).

Hapi 2

Mësuesi/ja merr 2 lapsa në dorën e djathtë dhe 3 lapsa në dorën e majtë. Bën pyetjet:

- Sa lapsa kam në dorë? $2 + 3 = 5$
- Po nëse u ndërroj vendet, sa lapsa do të kem? $3 + 2 = 5$ (kalon 2 lapsa në dorën e majtë dhe 3 lapsa në dorën e djathtë).

- A ndryshoi shuma? Pse?
Dalim në përfundimin se: Nëse u ndërrojmë vendet numërorëve, shuma nuk ndryshon.
Nxiten nxënësit të japin shembuj.

Hapi 3

Nxënësit hapin librat dhe zhvillohet një diskutim bazuar në ilustrimin e dhënë. Së bashku me nxënësit arrihet në përfundimin se:

Kur ndërrojmë vendet e numrave që mbledhim, shuma nuk ndryshon.

Nxënësit vazhdojnë të zgjidhin detyrat e dhëna në tekst. Udhëzohen që detyrat t'i zgjidhin individualisht, më pas të diskutojnë në çifte dhe t'ia thonë zgjidhjet e bëra grupit. Nxënësit do të vizatojnë shigjeta për mbledhjet e dhëna në boshtin numerik dhe do të krahasojnë përfundimet, si dhe pse kanë dalë ato rezultate. Nëse kanë nevojë për ndonjë qartësim, nxënësit/et udhëzohen të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit dhe të kërkojnë ndihmë.

Hapi 4

Secila dyshe zgjedh nga një çift numrash dhe gjen shumën e tyre, duke u ndërruar vendet. Për shembull: nxënësi i parë thotë $4 + 1 = 5$, tjetri thotë $1 + 4 = 5$. Nëse mjafton koha, nxënësit i shkruajnë barazimet në tabelë ose në fletoret e shënimeve. Veprimi përsëritet edhe me numra të tjerë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i ndërsjellë - vlerësim i situatës së thjeshtë problemore me materialet e sjella nga shtëpia.
Gjetjen e shumës së dy mbledhorëve, duke u ndërruar vendet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënësve të temës: Përcakton mbledhjet e parë, mbledhjet e dytë, shumë, të zbritshme, zbritjet dhe ndryshimet e numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V(2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
	Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.		

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.6 Mbledhje me shumë 6	Fjalë kyçe: shuma, mbledhjet, bosht numerik, gjashtë.
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - eksploron problema dhe gjëgjëza numerike; - gjen shumë, duke pasqyruar kërcimet në një bosht numerik; - zgjidh detyrat në tekst duke u bazuar në kërkesat e dhëna. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - eksploro problema dhe gjëgjëza numerike; - gjej shumë, duke pasqyruar kërcimet në një bosht numerik; - zgjidh detyrat në tekst, duke u bazuar në kërkesat e dhëna. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkumës me ngjyra, petëza, kube formuese (<i>Legó</i>), fasule, letra me numra nga 1-6.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje), Edukatë fizike, sporte eshëndeti (kërcimi në boshtin numerik).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Përdoret boshti numerik i klasës për të bërë shënime në të. Zgjidhen dy nxënës që të dalin përpara klasës. Kërkohet që nxënësi i parë t'i bjerë daulles/apo të përplasë duart tri herë dhe të shënojë goditjet në boshtin numerik. Rrethon numrin 3. Kërkohet që nxënësi i dytë të përplasë lehtësisht dy herë duart, duke shënuar kërcimet në boshtin numerik. Rrethon numrin ku arrihet nga shtimi i vargut me dy njësi. (5). Shkruhet në tabelë $3 + 2 = 5$.

Më pas, nxënësi do të krijojë numrin 6 me tri lëvizje, për shembull: nxënësi i parë i bie daulles/ose përplas duart një herë dhe shënon në boshtin numerik 1. Vazhdon nxënësi i dytë i bie daulles/ose përplas duart tri herë dhe shënon në boshtin numerik numrin ku arrin. Nxënësi i tretë i bie daulles/ose përplas duart dy herë dhe shënon në boshtin numerik numrin e saktë, pra 6. Shkruhet në tabelë $3 + 2 + 1 = 6$.

Përsëritet ushtrimi duke u nisur nga numra të ndryshëm dhe duke shtuar për çdo rast. Shënohet çdo llogaritje në tabelën e klasës.

Hapi 2

Mësuesi/ja u lexon nxënësve gjëgjëzën problemore dhe i lë të lirë të përpiqen të gjejnë zgjidhjen e saktë.

**Pulat në oborr numërova, ishin 2 të bardha, 2 të larme.
Pastaj 2 të vogla në kotec zbulova.
Kush nga ju më thotë: sa pula gjithsej numërova?**

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku është e paraqitur tryeza me pjata, lugë dhe pirunë. Mësuesi/ja numëron së bashku me nxënësit sa takëme janë gjithsej. Vazhdohet me plotësimin e detyrave të dhëna, ku nxënësit/et do të gjejnë mbledhorin që mungon për të formuar shumën 6. Gjatë punës, nxënësit/et do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit, nëse kanë nevojë për ndihmë apo nëse nuk i kuptojnë detyrat. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të ndërrojnë librat në çift dhe do të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit/njëra-tjetrës (sipas vlerësimit të ndërsjellë).

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Loja luhet në çifte, ku nxënësit do të nxjerrin duart dhe së bashku do të përpiqen të krijojnë kombinime të ndryshme, në mënyrë që të formojnë numrin 6 me duart e të dyve. Për shembull: nëse njëri/njëra nxënës/e nxjerr dy gishta, tjetri/a menjëherë nxjerr 4 dhe formojnë numrin 6. Veprimi përsëritet derisa të mos ketë më mundësi për të formuar numrin 6.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Semafori” - përdorimi i letrave me ngjyrat e semaforit.

Vlerësimi i ndërsjellë i punimeve të njëri-tjetrit/njëra-tjetrës.

Aktivizimi gjatë lojës dhe respektimi i rregullave të vendosura më parë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshesën e numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6), Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2; 3.3, 4, 5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.7 Mbledhje me shumë 6	Fjalët kyçe: shuma, mbledhorët, bosht numerik, gjashtë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - paraqet mbledhjen e dy ose tre numrave në boshtin numerik; - tregon me petëza apo materiale të ndryshme barazimet e dhëna; - zgjidh detyrat në tekst, duke u bazuar në kërkesat e dhëna. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - paraqit mbledhjen e dy ose tre numrave në boshtin numerik; - trego me petëza apo materiale të ndryshme barazimet e dhëna; - zgjidh detyrat në tekst, duke u bazuar në kërkesat e dhëna. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkumësa me ngjyra, petëza, kube formuese (<i>Lego</i>) fasule, etiketa me numra 1-6.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje), Edukatë fizike, sporte e shëndeti (kërcimi në boshtin numerik).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1:


Mësuesi/ja vizaton një bosht të madh numerik në dysheme.

Mund të krijojë një histori për një atlet që duhet të kalojë pengesat gjatë vrapimit. Në fillim i duhet të kërcejë tre hapa, pastaj edhe tre të tjerë.

- Pas sa hapash e kalon atleti pengesën?

Njëri nga nxënësit ngrihet përpara klasës dhe fillon të kërcejë nga 0 deri në 3. Më pas, bën edhe tre hapa të tjerë.

- Te cili numër shkojmë? Pra: $3 + 3 = 6$




Vepronet njësoj me barazime me tre mbledhorë, si për shembull: $2 + 2 + 2 = 6$

Hapi 2

Përdoret fleta e ushtrimit e përgatitur nga mësuesi/ja për çdo grup, ku udhëzohen nxënësit të paraqesin me petëza (kube formuese, fasule apo materiale të tjera) barazimet dhe të gjejnë së bashku shumën. Nxiten nxënësit të gjejnë barazime të tjera (edhe me tre mbledhorë) të cilat na japin shumën 6, për shembull: $6 + 0 = 6$; $4 + 2 = 6$; $2 + 2 + 2 = 6$;

$3 + 2 + 1 = 6$. Një përfaqësues nga grupi prezanton punën e bërë.

**Hapi 3**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku janë të paraqitura barazime që japin shumën 6, të paraqitura me kube me ngjyra të ndryshme. Në detyrën 2 do të vizatojnë dhe do të ngjyrosin sipas

kërkesës, në mënyrë që të formohet numri 6. Vazhdohet me plotësimin e detyrës së tretë, ku nxënësit do të gjejnë mbledhorin që mungon për të formuar shumën 6 në pullazin e shtëpisë. Në detyrën e katërt, udhëzohen nxënësit që të gjejnë shumën në libër, duke punuar me kube formuese apo me materiale të ndryshme. Nxënësit/et do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çift e në grup. Gjatë punës, nxënësit do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit, nëse kanë nevojë për ndihmë apo nëse nuk i kuptojnë detyrat.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Loja luhet në çift, ku nxënësit do të nxjerrin 2 ose 3 karta me numra të cilët, kur mblidhen, japin shumën 6. Veprimi përsëritet derisa të mos ketë më mundësi për të formuar numrin 6.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Semafori” - përdorimi i letrave me ngjyrat e semaforit nga nxënësit.

Shkrimi i barazimit, duke u bazuar në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshesën e numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2; 3.3, 4, 5, 6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.8 Mbledhje me shumë 7	Fjalë kyçe: shumë, mbledhorët, shtatë, Borëbardha, xhuxhët, veshmbathje.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - paraqet mbledhjen e dy ose tre numrave në boshtin numerik; - bashkon lojërat formueset për të krijuar figurën e dhënë; - zgjidh detyrat në tekst, duke u bazuar në kërkesat e dhëna. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - paraqit mbledhjen e dy ose tre numrave në boshtin numerik; - bashko formueset për të përfutur figurën e dhënë; - zgjidh detyrat në tekst duke u bazuar në kërkesat e dhëna. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, libri me figura “Borëbardha dhe shtatë xhuxhët”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: lojëra formuese.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (leximi dhe komentimi i përrallës), Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja përgatit paraprakisht për secilin grup nga një fletë, ku paraqitet ilustrimi i përrallës “Borëbardha dhe shtatë xhuxhët” në një rën anë, kurse në anën tjetër barazime me shumën 7. Fletën me ilustrimin e pret në disa forma të çrregullta (*puzzle*) dhe e vendos në tavolinë. Detyra e secilit grup është të bashkojë pjesët, të formojë foton në një rën anë dhe të plotësojë barazimet e dhëna në anën tjetër.


$$\begin{aligned}
 6 + 1 &= 2 + 5 = \\
 5 + 2 &= 1 + 6 = \\
 4 + 3 &= 0 + 7 = \\
 3 + 4 &= 7 + 0 =
 \end{aligned}$$



Hapi 2

Vendoset “Shiriti me numra” në mes të klasës dhe ftohen një vajzë dhe dy djem për të zhvilluar lojën. Vajza do të qëndrojë në numrin 7 në boshtin numerik dhe do të luajë rolin e Borëbardhës. Dy djemtë do të luajnë rolin e xhuxhëve, të cilët do t’i sjellin një dhuratë vajzës. Xhuxhi i parë do të kërcejë te numri 4 dhe do t’ia japë kutinë xhuxhit të dytë, i cili do të kërcejë deri te numri 7, për t’ia dhënë Borëbardhës. Një nxënës do të shkojë në tabelë barazimin, sipas veprimeve që janë bërë më herët:

$$4 + 3 = 7$$



Vazhdohet kështu dhe veprimet përsëriten me tre mbledhorë (tre xhuxhë), si: $3 + 2 + 2 = 7$

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku është e paraqitur Borëbardha dhe shtatë xhuxhët. Pas kësaj, zhvillohet një diskutim i përbashkët. Vazhdohet me plotësimin e detyrave në tekst në mënyrë individuale. Nxënësit shkëmbejnë punën/detyrën me njëri-tjetrin dhe krahasojnë detyrat e shokut/shoqes me listën e kriterëve të paraqitura për të gjithë nxënësit. Nxënësi-kontrollues duhet të sigurohet se janë përfshirë elementet themelore në punën e shokut/shoqes. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i thotë atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi-autor korrigjon gabimet para se të dorëzojë detyrën e tij. (Kontrolli para fluturimit)

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Loja luhet në çift, ku nxënësit do të nxjerrin 2 letra me numra që, kur mblidhen, japin shumën 7. Veprimi përsëritet derisa të mos ketë më mundësi për të formuar numrin 7.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së lidhjes së formueseve.

Shkrimi i barazimit, duke u bazuar në aktivitetet e zhvilluara.

“Kontrolli para fluturimit”.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshesën e numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.9 Mbledhje me shumë 7	Fjalë kyçe: shuma, mbledhorët, ditët e javës, shtatë, figura, forma.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - gjen dy ose tre mbledhorë që japin shumën 7; - tregon me petëza apo materiale barazimet e dhëna; - zgjidh detyrat në tekst duke u bazuar në kërkesat e dhëna; - luan lojën duke respektuar rregullat e saj. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - gjej dy ose tre mbledhorë që japin shumën 7; - trego me petëza apo materiale të ndryshme barazimet e dhëna; - zgjidh detyrat në tekst, duke u bazuar në kërkesat e dhëna. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkurtesa me ngjyra, petëza (lojëra formuese), fasule, etiketa me numra 1-6.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja zhvillon një diskutim me nxënës me anë të pyetjeve:

- Sa ditë ka java? (7)
- Sa prej këtyre ditëve vijnë në shkollë e sa i kemi pushim? (5 ditë në shkollë dhe 2 ditë pushim)
- Ç'ditë e javës është sot?

Gjatë diskutimit, theksi vihet te formimi i numrit 7 nga dy ose tre numra të tjerë.

Hapi 2

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që në çift të listojnë sa më shumë numra që së bashku japin numrin 7.

Më pas, numrat shkruhen në tabelë në formën e mëposhtme:

7,0

6,1

3,2,2

4,2,1 etj.

Ftohen nxënës në tabelë që të shkruajnë barazimet poshtë numrave. Për shembull: 3, 2, 2

$$3 + 2 + 2 = 7.$$

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku është e paraqitur një vazo me 5 lule, së cilës i shtohen dy lule të tjera. Bëhet kujdes që gjatë diskutimit rreth detyrave në tekst të përdorim shprehjen “më shumë se”. Vazhdohet me plotësimin e detyrave në tekst, ku nxënësit do të plotësojnë barazimet, duke u bazuar në boshtin numerik dhe do të gjejnë mbledhorin që mungon.

Në detyrën e radhës, nxënësit udhëzohen të gjejnë shumën në libër, duke punuar me kube formuese apo me materiale të ndryshme. Nxënësit/et do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çift dhe në grup. Gjatë punës, nxënësit/et do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit, nëse kanë nevojë për ndihmë apo nëse nuk i kuptojnë detyrat.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Loja luhet në çifte, ku nxënësit do të formojnë figura me 7 forma të ndryshme (katrore, trekëndore dhe rrethore). Njëri nxënës i çiftit formon figurën, kurse nxënësi tjetër do të paraqet me barazim. Për shembull:

$$3 + 2 + 2 = 7$$

Përsëritet veprimtaria me krijimin e figurave të ndryshme dhe ndërrohen rolet e nxënësve në çift.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Semafori” - përdorimi i letrave me ngjyrat e semaforit nga nxënësit.

Shkrimi i barazimit, duke u bazuar në aktivitetet e zhvilluara.

Respektimi i rregullave të lojës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënësve të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.10 Mbledhje me shumë 8	Fjalët kyçe: mbledhorë, shumë, festë, tetë.
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - përshkruan ilustrimin duke nxjerrë barazimet e kërkuara; - plotëson barazimin duke u bazuar në të dhënat gjatë aktivitetit; - luan, duke respektuar rregullat e lojës, të vendosura paraprakisht. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - përshkruaj ilustrimin duke nxjerrë barazimet e kërkuara; - shkruaj barazimin, duke u bazuar në të dhënat gjatë aktivitetit; - luaj, duke respektuar rregullat e lojës. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube, letrat me ngjyrat e semaforit.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komentimi gjatë aktiviteteve), Shoqëria dhe mjedisi (ditëlindja).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të ngrihen në këmbë dhe të krijojnë një rreth së bashku për lojën “Numërimi me 8”. Përcaktohen paraprakisht rregullat e lojës:

- Numërimi fillon prej 1-8.
- Për numrat 1-7, nxënësit vendosin dorën në gjoks.
- Për numrin 8 dora vendoset mbi kokë.
- Nxënësit gjatë gjithë kohës mund të ndërrojnë kahun e numërimi.

Hapi 2

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të zhvillojnë një aktivitet në çifte. Një nxënës vendos mbi bankë disa kube formuese (Lego) (1-5). Detyra e nxënësit tjetër është të nxjerrë edhe aq kube sa nevojiten që të krijohet numri 5. Shkruhet barazimi në fletore. Përsëritet veprimi duke ndërruar rolet nxënësit. Barazimet e shkruara në fletore lexohen nga një nxënës i tretë me zë të lartë.

**Hapi 3**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën ku janë të paraqitura dhurata, balona, flamurë, fëmijë; pra, një ambient festiv. Së bashku me nxënësit, numërojmë sendet dhe plotësojnë barazimet në tekst. Në detyrën e dytë janë të paraqitur disa bashkësi, të cilave do t'u plotësohet numri i elementeve, duke u vizatuar numrin e kërkuar të karamelve. Vazhdohet me plotësimin e detyrës së tretë, ku duhet t'i kushtohet më shumë kujdes barazimeve që formojnë numrin 8, duke u bazuar në ilustrime. Fillimisht, nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte dhe në grup. Gjatë punës, nxënësit do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit, nëse kanë nevojë për sqarime apo nuk e kanë të qartë detyrën.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Loja luhet në çifte, ku nxënësi i parë hedh zarin, kurse nxënësi i dytë duhet të gjejë numrin që duhet shtuar për të krijuar numrin 8. Loja përsëritet disa herë, duke bërë disa kombinime të shumës 8. Nxënësit nderojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit përdorin letrat me ngjyrat e semaforit për çështjet që nuk kuptojnë.

Vlerësohet aftësia për të shkruar barazime duke u bazuar në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3, 4, ,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.11 Mbledhje me shumë 8	Fjalët kyçe: mbledhje, shumë, bosht numerik, tetë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan ilustrimin duke nxjerrë barazimet e kërkuara; - paraqet mbledhjen e dy numrave në boshtin numerik; - përdor materiale të ndryshme të ndryshme për të zgjidhur barazimin. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - paraqit mbledhjen e dy numrave në boshtin numerik; - përdor materiale të ndryshme për të zgjidhur barazimin; - luaj, duke respektuar rregullat e përcaktuara. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube, letrat me ngjyrat e semaforit, boshti numerik, lodra në formën e kafshëve.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komentimi gjatë aktiviteteve).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Tregohet një situatë problemore me gjëgjëzë. Mund të shoqërohen edhe me foto e revista.

**5 rosa po lahashin në liqen.
Filloi një erë e fortë dhe erdhën edhe 3 rosa të tjera.
Sa rosa u bënë në liqen?**

Hapi 2


Mësuesi/ja vizaton një bosht të madh numerik në dysHEME.

Mund të sajojë një histori për një qen (apo ndonjë personazh të preferuar të nxënësve) që, për të kapur kockën, i duhet të kërcejë në fillim katër hapa dhe më pas edhe katër të tjerë.

- Pas sa hapash e kap qeni kockën?

Ngre një nxënës fillon të kërcejë nga 0 deri në 4, pastaj kërcen edhe katër hapa të tjerë.

- Te cili numër shkoj? Pra $4 + 4 = 8$



Loja përsëritet edhe me barazime të tjera që kanë si shumë numrin 8.

Hapi 3

Mësuesi/ja nxit nxënësit të përshkruajnë figurën në tekst dhe të shkruajnë barazime, ku në të gjitha rastet shuma është 8. Nxënësit do të vrottojnë mbledhjen në boshtin numerik dhe më pas në detyrat në vijim do të vizatojnë shigjetat për mbledhjet e dhëna dhe do të shkruajnë barazimet. Udhëzohen nxënësit që ë punojnë me boshtin numerik që është i vizatuar në dysheme nëse kanë nevojë për konkretizim.

Vazhdohet me plotësimin e detyrës së tretë dhe të katërt. Në detyrën e katërt udhëzohen nxënësit të gjejnë shumën në libër, duke punuar me kube formuese (*Lego*) apo me materiale të ndryshme. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte e në grup. Gjatë punës, nxënësit do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit nëse kanë nevojë për sqarime apo nuk i kuptojnë detyrat.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Loja luhet në çifte, ku nxënësi i parë nxjerr një etiketë me shumën 8 dhe kërkon nga nxënësi i dytë të nxjerrë etiketat me mbledhorët që japin shumën 8, për shembull: 5 dhe 3. Veprimi përsëritet derisa të jenë formuar disa barazime me numërorë që japin shumën 8. Më pas, nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit përdorin letrat me ngjyrat e semaforit për të treguar nëse e kanë kuptuar apo jo mësimin.

Do të vlerësohen për aftësinë për të shkruar barazime me numrin e njësisë.

Merret parasysh respektimi i rregullave të lojës dhe mendimi i shokëve/shoqeve gjatë lojës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.12 Mbledhje me shumë 9	Fjalët kyçe: mbledhorë, shumë, nëntë, vjeshta.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - krijojnë numrin 9 me pikat në krahët e nusepashkës (mollëkuqes); - plotëson barazimin, duke u bazuar në të dhënat gjatë aktivitetit; - luan, duke respektuar rregullat e lojës të vendosura paraprakisht. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - krijojnë numrin 9 me pikat në krahët e nusepashkës (mollëkuqes); - shkruajnë barazimin duke u bazuar në të dhënat gjatë aktivitetit; - luajnë duke respektuar rregullat e lojës. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: nusepashkë të krijuara nga nxënësit, kube, materiale të ndryshme.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komentimi gjatë aktivitetëve), Shkathtësi për jetë (nusepashkët e punuara nga nxënësit).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vendosin pika në të dy krahët e nusepashkës. Nxënësit vendosin në të dy krahët aq pika sa kur të mbledhen japin shumën 9. Më pas, shkruan barazimet në fletore. Për shembull: $5 + 4 = 9$

**Hapi 2**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të zhvillojnë një aktivitet në çifte. Njëri nxënës nxjerr mbi bankë kube formuese (Lego) (1-9) detyra e nxënësit tjetër është të nxjerrë edhe aq kube sa nevojiten që të krijohet numri 9.



Shkruhet barazimi në fletore. Përsëritet veprimi, duke ndërruar rolet te nxënësit. Një nxënës i tretë do të lexojë me zë të lartë barazimet e përfutuara.

Nx. 1 Nx. 2 Nx. 1 Nx. 2

4 5 3 6

$$4 + 5 = 9 \quad 3 + 6 = 9$$

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën ku është e paraqitur një peizazh nga stina e vjeshtës. Bën një përmbledhje të shkurtër të pamjes së natyrës gjatë kësaj stine. Janë të paraqitura pemët me gjethe të zverdhura, duke rënë në tokë. Së bashku me nxënësit, numërohen gjallesat (dallëndyshet, gjethet dhe milingonat) dhe plotësojmë barazimet në tekst. Në detyrën e dytë do të vizatojmë nga 9 pika në krahët e nusepashkës dhe do të plotësojmë barazimet. Vazhdohet me plotësimin e detyrës së tretë, ku duhet t'i kushtohet më shumë kujdes gjetjes së mbledhorëve, duke u bazuar në ilustrime. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte, duke i ndërruar librat për të kontrolluar punën e njëritjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Loja luhet në çifte, ku nxënësit do të nxjerrin së bashku me shokun/shoqen 9 forma të të njëjtit lloj. Njëri nxënës i shkruan në fletore barazimet e përfutuara. Më pas nxënësit ndërrojnë rolet.

Nx. 1

Nx. 2

6

3

$$6 + 3 = 9$$

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të parimit “Vlerësimi i ndërsjellë”, duke kontrolluar detyrat e njëritjetrit.

Shkrimi i barazimit duke u bazuar në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).		Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.12 Mbledhje me shumë 9	Fjalët kyçe: mbledhorë, shumë, nëntë, kube formuese (<i>Legó</i>), gurë dominoje.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - tregon krijimin e numrin 9 si shumë të dy mbledhorëve me kube formuese (<i>Legó</i>) dhe gurë dominoje; - plotëson barazimin, duke u bazuar në të dhënat gjatë aktivitetit; - realizon aktivitetin duke respektuar rregullat e vendosura paraprakisht. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - trego krijimin e numrin 9 si shumë të dy mbledhorëve me kube formuese (<i>Legó</i>) dhe gurë dominoje; - shkruaj barazimin, duke u bazuar në të dhënat gjatë aktivitetit; - realizo aktivitetin, duke respektuar rregullat. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube formuese (<i>Legó</i>), gurë dominoje, etiketa me numra.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komentimi gjatë aktivitetëve), Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje në tekst).	

Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për paqe

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të nxjerrin kube formuese (*Legó*) me dy ngjyra të ndryshme dhe në secilin grup shpërndan nga një komplet me domino. Nxënësit do të bashkojnë 9 kube formuese (*Legó*), duke i kombinuar ngjyrat e më pas do të gjejnë gurin e dominosë me të njëjtën shumë dhe mbledhorë. Një nxënës i grupit do të shkruajë në fletë A4 barazimet, dhe punën e bërë do ta prezantojë në grup.



Hapi 2

Lojë me numrat.

Unë kam 5. (Tregon një dorë me pesë gishta.)

- Sa duhet për të bërë 9?

Filloni numërimin nga numri 5.

Mësuesi/ja zgjedh një nxënës/e që të japë një numër fillimi dhe një numër mbarimi.P.sh.: “Unë kam 7. Sa duhet për të formuar 9?”

Përsëritet ushtrimi disa herë.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë barazimin $6 + 3 = 9$ me petëza dyngjyrëshe.

Gjatë diskutimit përsëriten disa herë fjalitë:

- 9 ka tre më shumë se 6.
- 9 është 3 më e madhe se 6.

Nxënësit do të punojnë individualisht ushtrimet e dhëna në tekst e më pas do të diskutojnë në çifte, duke i ndërruar librat për të kontrolluar punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të realizojnë në çifte aktivitetin e shpjeguar në tekst. Nxënësit do të shkruajnë me shokun/shoqen sa më shumë barazime me shumën 9.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të teknikës “Vlerësimi i ndërsjellë”, duke marrë parasysh vlerësimet që i kanë bërë njëri-tjetrit. Vlerësohet shkrimi i barazimit pas kryerjes së barazimeve me numra.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.14 Mbledhje me shumë 10.	Fjalët kyçe: mbledhorë, shumë, Viti i Ri, dhjetë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - plotëson pemën e Vitit të Ri me 10 dekorimet prej letrave me ngjyrë; - plotëson barazimin, duke u bazuar në të dhënat e nxjerra gjatë aktiviteteve; - prezanton punën e bërë para grupit, duke argumentuar zgjidhjet e bëra. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - plotëso pemën e Vitit të Ri me 10 dekorimet prej letrave me ngjyrë; - shkruaj barazimin, duke u bazuar në të dhënat e nxjerra gjatë aktiviteteve; - prezanto punën para grupit, duke argumentuar zgjidhjen e bërë. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: pema e Vitit të Ri prej letre, dekorime, kapëse druri, karton në formë rrethore, lapsa shënjuës (markera), materiale të ndryshme.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (diskutim rreth festave), Shkathtësi për jetë (pema dhe dekorimet prej letre).

Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për paqe

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fletë të gjelbra në formën e pemës së Vitit të Ri, dhe 10 letra ngjitëse në formë globesh, me dy ngjyra të ndryshme (dekorimet mund të punohen edhe nga vetë nxënësit me letra zbukuruere). Pasngjitjes së dekorimeve, nxënësit vendosin pemët në mes të bankave dhe secilinxënës nga grupi shkruan barazimet, duke u bazuar në numrin dhe në ngjyrëne dekorimeve. Për shembull: nëse në një pemë ka 6 dekore me ngjyrë të kuqedhe 4 dekore me ngjyrë të kaltër, atëherë do të shkruajnë barazimin $6 + 4 = 10$.



Hapi 2

Lojë me numrat

Unë kam 6 dekorime. (Tregon gjashtë dekorime në dorë.)

- Sa duhet për të plotësuar numrin 10?

Filloni numërimin nga 6. Mësuesi/ja zgjedh një nxënës që të japë një numër fillimi dhe një numër mbarimi.

P.sh.: “Unë kam 7 dekorime. Sa duhet për të formuar 10?”

Përsëritet ushtrimi disa herë.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë **figurën** ku **është** e paraqitur pema e Vitit të Ri, dhurata, **flamuj** dhe dy fëmijë. Bën një përmbledhje të shkurtër rreth festës së Vitit të Ri dhe specifikave të saj. Nxënësit do të punojnë individualisht detyrat e dhëna në tekst e më pas do të diskutojnë në **çifte**, duke i ndërruar librat për të kontrolluar punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në grupe kapëse për varjen e rrobave, si dhe nga një rreth të bërë me karton, nëmes të të cilit është shkruar numri 10. Udhëzohen nxënësit që secili anëtar i grupit të shkruajë në kapëse me laps shënjes (marker) dy numra që formojnë numrin 10.

Secili grup vendos punën e bërë në telin tharës dhe një pjesëtar i grupit lexon barazimet.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Do të merret parasysh teknika “Vlerësimi i ndërsjellë”, pra vlerësimi i detyrave të njëri-tjetrit.

Do të vlerësohet shkrimi i barazimit, duke u bazuar në aktivitetin me kapëse.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20;	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.15 Mbledhje me shumë 10	Fjalët kyçe: mbledhorë, shuma, dhjetë, barazimi.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - plotëson dhjetëshen gjatë aktivitetit me etiketa e zare; - gjen shumën apo mbledhorët në detyrat e dhëna; - shkruan mbledhorët në kapëse, në varësi të të dhënave në kartonin rrethor. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - plotëso dhjetëshen gjatë aktivitetit me etiketa e zare; - gjej shumën apo mbledhorët në detyrat e dhëna; - shkruaj mbledhorët në kapëse në varësi të shumës së dhënë në kartonin rrethor. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: letra me numra nga 0 në 10, zari, boshti numerik, kapëse druri dhe kartonë në formë rrethore.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1:

Mësuesi/ja zgjedh gjashtë nxënës që do të dalin përpara klasës. Çdo nxënës i jepet një nga letrat me numra nga 0 në 10. Një nxënës/se i kërkohet të hedhë zarin. Nëse ndonjëri prej nxënësve ka mbledhorin e duhur për të formuar shumën 10, ai ia dorëzon letrën e tij me numër një nxënësi që është i ulur dhe del nga loja. Pra, nëse zari bie te numri 6, nxënësi me numrin 4 do të ulet, ose nëse zari bie te 2, nxënësi me numrin 8 do të ulet. Barazimet shkruhen në tabelë dhe veprimi përsëritet disa herë.

Nën barazimet e paraqitura në tabelë shkruajmë mbledhorët dhe shumën.

$$\begin{array}{ccccccc}
 & 6 & + & 4 & = & 10 & \\
 & \swarrow & & \downarrow & & \searrow & \\
 & \text{Mbledhori} & & \text{Mbledhori} & & \text{Shuma} &
 \end{array}$$

Hapi 2: Lojë me numrat

Unë kam 6 lapsa. (Tregon gjashtë lapsa në dorë.)

- Sa lapsa duhen për të formuar numrin 10? Filloni numërimin nga numri 6.

Mësuesi/ja zgjedh një nxënës që të japë një numër fillimi dhe një numër mbarimi. P.sh.: “Unë kam 7 lapsa. Sa duhen për të formuar 10?”

Përsëritet ushtrimi disa herë.

Hapi 3:

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku është paraqitur shuma dhe mbledhorët. Në detyrën e katërt, nxënësit do të gjejnë shumën me anë të boshtit numerik, i cili duhet vendosur në klasë ose mund të vizatohet. Nxënësit do të punojnë individualisht detyrat e dhëna në tekst e më pas do të diskutojnë në çift, duke i ndërruar librat për të kontrolluar punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4:

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në grupe kapëse druri për varjen e rrobave dhe nga një rreth prej kartoni, në mes të të cilit ka shkruar numrat 6, 7, 8, 9 dhe 10. Udhëzohen nxënësit që secili pjesëtar i grupit të shkruaj në kapëse me laps shënjujes (marker) mbledhorët që formojnë numrin e dhënë.



Secili grup vendos punën e bërë në “telin tharës” dhe një pjesëtar i grupit lexon barazimet për numrin e dhënë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Do të merret parasysh teknika “Vlerësimi i ndërsjellë”, pra vlerësimi i detyrave të njëri-tjetrit.

Do të vlerësohet shkrimi i barazimit, duke u bazuar në aktivitetin me kapëse.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.16 Mbledhje deri në 10	Fjalët kyçe: mbledhorë, shuma, dhjetë, më i madh, më shumë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - ndan dhjetëshen në dy mbledhorë gjatë aktivitetit me pjata e kube; - gjen mbledhorët nga shuma në detyrat e dhëna; - krijon një tregim në dyshe, duke u bazuar në lodra apo materiale shkollore. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - ndaj dhjetëshen në dy mbledhorë gjatë aktivitetit me pjata e kube; - gjej mbledhorët nga shuma në detyrat e dhëna; - krijo një tregim në dyshe, duke u bazuar në lodra apo materiale shkollore. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: lodra, mjete shkollore, pjata plastike, kube, fisha me numra.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve).	

Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për paqe

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Nxënësit do të punojnë në dyshe me mjetet që kanë sjellë nga shtëpitë, lodra, mjete shkollore dhe do të krijojnë situata të thjeshta problemore. Me mjetet që kanë sjellë nga shtëpitë, ata do të krijojnë një tregim në dyshe, ku nuk do të përdorin më shumë se 10 objekte. Udhëzohen që të përcaktojnë vetë numrin e objekteve që do të mbledhin. Nxënësit do të vlerësojnë veprimet e shokëve.

Hapi 2

Mësuesi/ja vendos dy pjata në mënyrë që të gjithë nxënësit të mund t’i shohin dhjetë kubet. U kërkon nxënësve të tregojnë se sa kube të vendosen në pjatën e parë, për shembull 4. Bëhet numërimi njëzëri për të gjetur sa kanë mbetur. Më tej vendosen edhe 6 kube në pjatën tjetër. $6 + 4 = 10$. Përsëritet ushtrimi disa herë.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë tabelën, ku është i paraqitur një numër në kolonën e parë kurse në kolonën e dytë numri për dy më i madh. Në detyrën e parë, nxënësit do

të gjejnë mbledhorët e shumave të dhëna. Në detyrën e tretë, nxënësit do të plotësojnë tabelat, duke theksuar vazhdimisht shprehjet “më i madh” dhe “më shumë”. Nxënësit do të punojnë individualisht detyrat e dhëna në tekst e më pas do të diskutojnë në çift, duke i ndërruar librat për të kontrolluar punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të gjejnë sa më shumë barazime për shumën që do t’u kërkohet. Pas përfundimit të kohës, nxënësit do të numërojnë se cili/cila ka shkruar më shumë barazime. Përsëritet veprimtaria me shufra të tjera.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Do të merret parasysh teknika “Vlerësimi i ndërsjellë”, pra vlerësimi i detyrave të njëri-tjetrit. Do të vlerësohet shkrimi i barazimit, duke u bazuar në aktivitetin me kapëse.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			


ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.17 Mbledhje deri në 10	Fjalët kyçe: mbledhorë, shuma, rregull, semafor.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen shumën e duhur gjatë aktivitetit me kube; - plotëson detyrat e dhëna, duke bashkëpunuar në çift dhe në grup në bazë të kërkesës; - luan, duke respektuar rregullat e lojës. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej shumën e duhur gjatë aktivitetit me kube; - plotëso detyrat e dhëna, duke bashkëpunuar në çift dhe grup në bazë të kërkesës; - luaj, duke respektuar rregullat e lojës. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kube formuese (<i>Lego</i>), shirit me numra, kartat me ngjyrat e semaforit.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Nxënësit do të vendosin kube formuese (*Lego*) mbi një fletë A4 dhe do të shkruajnë barazimet, duke i përdorur kubet si mbledhorë. Nxënësi do të paraqesë aktivitetin para shokut/ shoqes të bankës e më pas disa nxënës e prezantojnë punën para klasës.

**Hapi 2**

Mësuesi/ja u kërkon dysheve të nxënësve të rendisin sa më shumë numra që mundin, për të formuar numrin 10. Lista e numrave shkruhet në tabelë. **8, 2 3, 7 5, 5 4, 6 9, 1**

Fton një nxënës në tabelë për të shkruar fjalitë numerike me mbledhje poshtë numrave, për shembull:

8, 2

$$8 + 2 = 10$$

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë tabelat ku janë të paraqitura disa barazime, kur mbledhori i dytë është 5. Udhëzohen nxënësit të punojnë me kube, kokrrat e fasules apo ndonjë material tjetër gjatë zgjidhjes së barazimeve, në mënyrë që të konkretizojnë punën e bërë. Nxënësit plotësojnë detyrat në libër, duke bashkëpunuar në çifte. Punën e bërë e prezantojnë përpara grupit. Gjatë punës, nxënësit do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit nëse kanë nevojë për ndihmë apo nuk e kuptojnë detyrën e dhënë.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vëzhgojnë dhe më pas të luajnë lojën që është paraqitur në tekst, ku njëri nxënës ngre etiketën me një numër, kurse shoku/shoqja që luan në çift do të ngrejë dy numra që japin numrin e dhënë. Përsëritet veprimi disa herë me shirita të tjerë, ndërsa nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Do të merret parasysh teknika “Vlerësimi i ndërsjellë”, pra vlerësimi i detyrave të njëri-tjetrit.
Do të vlerësohet respektimi i rregullave të lojës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.18 Mbledhje deri në 10	Fjalët kyçe: mbledhorë, shuma, dhjetë, më shumë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - ndan dhjetëshen në dy dhe tre mbledhorë gjatë aktivitetit me pjata e kube; - plotëson detyrat e dhëna sipas kërkesës; - lidh mbledhorët dhe shumën me llastik në mjetin e përgatitur. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - ndaj dhjetëshen në dy dhe tre mbledhorë gjatë aktivitetit me pjata e kube; - plotëso detyrat e dhëna sipas kërkesës; - lidh mbledhorët dhe shumën me llastik në mjetin e përgatitur. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: pjata plastike, kube, shirita me numra, karton i madhësisë së fletës A4, gjilpëra, llastik.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Shkathësi për jetë (kartoni i prerë për aktivitet).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja vendos tri pjata në mënyrë që të gjithë nxënësit të mund t’i shohin kubet. U kërkon nxënësve t’i tregojnë se sa kube të vendosim në pjatën e parë, për shembull 4. Më pas, ajo u kërkon t’i tregojnë se sa kube të vendosin në pjatën e dytë, për shembull 3. Bëhet numërimi njëzëri për të gjetur sa mbledhorë duhen shtuar. Në vazhdim, shtohen edhe 3 kube në pjatën tjetër: $4 + 3 + 3 = 10$. Përsëritet ushtrimi disa herë, duke i ndarë kubet në mënyra të ndryshme nëpër pjata, e më pas duke shkruar shprehjen numerike të përfutur.

Hapi 2 Lojë me numrat

Unë kam 5. (Tregon një dorë me pesë gishta.)

- Sa më shumë duhen për të bërë 10?

Filloni numërimin nga 5.

Zgjedh një nxënës që të japë një numër fillimi dhe një numër mbarimi. P.sh.: “Unë kam 7, sa duhen për të formuar 9?”


Përsëritet ushtrimi disa herë.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë me kujdes detyrat e dhëna në tekst. Mësuesi/ja i ndan secilit grup nga një detyrë. Nxënësit do të punojnë detyrën në grupe, do të shkruajnë në fletë A3 (secili grup detyrën e vet) dhe më pas një pjesëtar i grupit do të prezantojë punën e bërë.

Hapi 4

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve një fletë për ushtrim si më poshtë, të cilën nxënësit do ta vendosin në një karton të fortë të madhësisë së fletës. Nxënësit do të vendosin gjilpërat me plastikë dhe do të lidhin mbledhorët e shumën e duhur. Pas përfundimit të detyrës, nxënësit në çifte shkëmbejnë mjetin dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Do të merret parasysh teknika “Vlerësimi i ndërsjellë”, pra vlerësimi i detyrave të njëri-tjetrit. Vlerësohet prezantimi dhe argumentimi i punës së bërë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.19 Problema	Fjalët kyçe: problema, merimanga, mbledhorët, shumë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - gjen zgjidhjen e gjëgjzës duke mbledhur të dhënat gjatë leximit nga mësuesi/ja; - grumbullon të dhëna nga ilustrimet për të shtruar problemën; - zgjidh problemën në bazë të të dhënave nga ilustrimet apo nga sendet e paraqitura. 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - trego shumë e dy ose tre mbledhorëve gjatë lojës “Merimanga”; - gjej zgjidhjen e gjëgjzës duke mbledhur të dhënat gjatë leximit nga mësuesi/ja; - mblidh të dhënat e duhura për zgjidhjen e problemës në ilustrim; - zgjidh problemën e dhënë duke u bazuar në të dhëna. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, gjëgjzëza.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: lëmshe me fill, gjëgjzëza me ilustrime.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (Komunikimi gjatë zgjidhjes së problemave), Edukatë figurative (vizatimi i të dhënave).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive për mbledhjen e numrave deri në 10. Tregohet një situatë problemore/gjëgjzë. Mund të shoqërohen edhe me ilustrime e libra për fëmijë.

**Në një pellg me 6 bretkosa,
herët në mëngjes erdhën edhe 4 rosa.
Sa u bënë gjithsej rosa dhe bretkosa?**

Hapi 2

Aktiviteti “Merimanga”. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të formojnë një rreth në mes të klasës, dhe më pas me një lëmshe me fill do të fillojnë aktivitetin. Së pari, mësuesi/ja i kërkon nxënësit që do të hedhë topin, të tregojë se sa është shuma e numrave 5 dhe 5. Nxënësi jep përgjigje, por në rast se nuk e di, mund

të përgjigjet me fjalën “paso” dhe t’ia kalojë lëmshin nxënësit tjetër. Nëse e thotë shumë e saktë, duhet të kërkojë nga shoku/shoqja që të gjejë shumë e një barazimi tjetër, si për shembull 3 dhe 7.

Udhëzohen nxënësit të pyesin edhe për barazime me tre mbledhorë. Kriter duhet të jetë që mbledhorët të mos japin shumë më të madhe se 10.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurat në tekst. I cakton secilit grup që si detyrë në fletore të nxjerrin të dhënat dhe të zgjidhin njërin problemë (1-4). Nxënësit punojnë në grupe. Duke marrë parasysh që është klasë e parë, vazhdimisht këshillohen se si duhet respektuar mendimi i shokut/shoqes dhe se si ndahen përgjegjësitë. Pasi përfundojnë detyrën, një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vendosin punimet (e punuara në grup) në “telin tharës” dhe secili nxënës vrojton punimet e grupeve të tjera e vlerëson me “+” detyrën e grupit që mendon se ka punuar më mirë (Turi i galerisë). Nga vlerësimet e nxënësve përcaktohet grupi më i mirë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Do të merren parasysh në vlerësim:

- përgjigjet e dhëna në zgjidhjes e gjëgjëzës;
- përgjigjet për shumë e dy mbledhorëve gjatë lojës “Merimanga”;
- prezantimet dhe vlerësimet për grupin tjetër gjatë vendosjes së shenjës “+” te “Turi i galerisë”.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënësve të temës: Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata të përditshmërisë).	Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.20 Problema	Fjalët kyçe: problema, fruta, të dhënat, zgjidhja.
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen zgjidhjen e gjëgjzës duke mbledhur të dhënat gjatë leximit nga mësuesi/ja; - grumbullon të dhëna nga ilustrimet për të shtruar problemën; - zgjidh problemën në bazë të të dhënave nga ilustrimet apo nga sendet e paraqitura. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej zgjidhjen e gjëgjzës duke mbledhur të dhënat gjatë leximit nga mësuesi/ja; - mblidh të dhënat e duhura për zgjidhjen e problemës në ilustrim; - zgjidh problemën e dhënë duke u bazuar në të dhëna. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, gjëgjzëza.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto të frutave dhe të fëmijëve, fletë të formatit A1 dhe A3, lapsa shenjues (markera), ngjitëse, ngjyra, teli me kapëse.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (Komunikimi gjatë zgjidhjes së problemave), Edukatë figurative (vizatimi i të dhënave), Edukatë fizike, Sporte dhe shëndeti (Ushqimi i shëndetshëm).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1:

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive për mbledhjen e numrave deri në 10. Tregohet një situatë problemore/gjëgjzë. Mund të shoqërohen edhe me ilustrime dhe përralla për fëmijë.

**Në një shportë ishin tri shegë, dy ftonj dhe pesë hurma.
Sa fruta ka në shportë?**

Hapi 2

Mësuesi/ja vendos në tabelë një fletë të bardhë të formatit A1, ku ka ngjitur disa sende dhe ndonjë figurë, me të cilat mendon se nxënësit mund të krijojnë një problem. Mund të jetë një fotografi e dy fëmijëve, dy grumbuj frutash, (jo më shumë se 10) dhe një pikëpyetje e madhe.

Fëmijët, të ndihmuar nga mësuesi/ja, do të provojnë të krijojnë problema të thjeshta me sendet në fletë. Për shembull: Dea dhe Eri po luanin së bashku. Nëna u solli fruta për të ngrënë. Ata vendosen t'i bashkonin frutat, që t'i hanin së bashku. Sa fruta kanë Dea dhe Eri tani?

Hapi 3

Pasi mësuesi/ja së bashku me nxënësit të kenë krijuar problemën, do të tregojë se si shkruhet (në mënyrën më të thjeshtë, duke marrë parasysh moshën e nxënësve) dhe si zgjidhet problema e krijuar. Të ndiqet shembulli më poshtë:

DEA



?

ERI



$$6 + 4 = 10 \text{ fruta gjithsej}$$

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurat në tekst. Secilit grup i cakton si detyrë të shkruajnë në fletë A3 të dhënat dhe të zgjidhin një problemë (nëse janë më pak grupe, dy të fundit lihen për detyrë shtëpie). Nxënësit punojnë në grupe. Duke marrë parasysh se është klasa e parë, nxënësit vazhdimisht këshillohen se duhet të respektojnë mendimet e njëri-tjetrit në grup dhe se si ndahen përgjegjësitë. (Në varësi të detyrës, nga ndarja nxënësit vizatojnë, ngjyrosin, shtrojnë problemën apo prezantojnë.) Një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë para shokëve dhe shoqeve të klasës.

Hapi 5

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vendosin punimet (e bëra në grup) në “Telin tharës” dhe secili nxënës do të shohë me kujdes punimet e grupeve të tjera dhe të vlerësojë me shenjën “+” punimin e grupit që mendon se ka punuar më mirë (Turi i galerisë). Nga vlerësimet e nxënësve nxirret grupi më i mirë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në vlerësim merren parasysh:

- përgjigjet e dhëna në zgjidhjen e gjëgjzës;
- argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së mbledhjes gjatë zgjidhjes së problemave;
- vlerësimet për grupin tjetër gjatë vendosjes së shenjës “+” te “Turi i galerisë”.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20, duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 2.21 Mbledhje deri në 10	Fjalët kyçe: mbledhorë, shuma, dhjetë, ngjyrë, vizatim.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen shumën e mbledhorëve në barazimet e dhëna; - mbledh më shumë se dy numra të vegjël, duke përdorur numrat që formojnë 10; - identifikon ngjyrën me të cilën do të ngjyrosë në bazë të shumës së barazimit. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej shumën e mbledhorëve në barazimet e dhëna; - mbledh më shumë se dy numra të vegjël, duke përdorur numrat që formojnë shifrën 10; - ngjyros figurën në bazë të ngjyrave të caktuara për secilën shumë. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, shirita me barazimet e mbledhjes.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numrat 0-10, ngjyra druri ose pastel.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (ngjyrosje e punimit).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja shpërndan shirita me barazime të veprimit të mbledhjes për çdo dyshe nxënësish dhe i udhëzon të gjejnë shumën e barazimeve.

Për shembull:

Pas përfundimit të detyrave, secili çift vendos shiritin në tabelë dhe bëhet një kontroll dhe përsëritje së bashku.

$$4 + 5 =$$

$$9 + 4 =$$

$$5 + 2 + 2 =$$

$$8 + 1 + 0 =$$

$$5 + 1 + 1 =$$

$$6 + 2 =$$

$$8 + 0 =$$

$$5 + 1 + 2 =$$

$$4 + 2 + 3 =$$

$$0 + 2 + 7 =$$

Hapi 2

Mësuesi/ja vendos tri enë të tejdukshme, në mënyrë që të gjithë nxënësit të mund t'i shohin kubet. U kërkon nxënësve t'i tregojnë se sa kube të vendosen në enën e parë. Për shembull, mund të vendosen 4. Më tej bën pyetjen: “Sa kube do të vendosen në enën e dytë?”. Për shembull mund të vendosen 3. Bëhet numërimi njëzëri për të gjetur se sa njësi kanë mbetur. Më tej vendosen edhe 3 kube të tjera. $4 + 3 + 3 = 10$. Ushtrimi përsëritet disa herë.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën e dhënë, të cilën do të ngjyrosin shumat e dala pas zgjidhjes së barazimeve. Nxënësit do të punojnë individualisht barazimet e dhëna në tekst e më pas do të diskutojnë në çift, duke i ndërruar librat për të kontrolluar punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të luajnë lojën ku njëri nxënës ngre etiketën me një numër, kurse shoku/shoqja që luan në çift, do të shtojë dy-tri numra për të përtuar numrin e dhënë. Veprimi përsëritet disa herë me shirita të tjerë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në vlerësim merret parasysh: “Vlerësimi i ndërsjellë” – kontrolli i detyrave të njëri-tjetrit. Identifikimi i ngjyrës me të cilën do të ngjyrosë, në bazë të shumës së barazimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

TEMA 3: ZBRITJA E NUMRAVE BRENDA 10

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematike	Lënda: Matematike	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20, duke përfshirë edhe numrin 0).		Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 3.1 Zbritje nga numri 3	Fjalët kyçe: heq, mbetet, ndryshesa, minus.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - kupton zbritjen si numërim mbrapsht dhe “heqje”; - përdor tremat “ikin”, “largohen”, “heqje”, për të treguar numrin e elementeve që zbriten nga një numër; - krijon situata problemore me zbritje me fjalë, vizatim ose mjete rrethanore. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - trego saktë numrin e kafshëve gjatë lojës “Lepujt në krevat”; - përdor termat “ikin”, “largohen”, “heqje”, për të treguar numrin e elementeve që zbriten nga një numër; - krijo situata problemore me zbritje me fjalë, vizatim ose mjete rrethanore. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libër me ilustrime, shirit me numra, letra me ngjyrat e semaforit.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (vjersha me numra).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja fton nxënësit të mësojnë një vjershë me numra, që lidhet me numërimin zbritës. Reciton vjershën “Lepujt në krevat”.

3 lepuj të vegjël kërcejnë mbi krevat,

Njëri bum ra poshtë, dhe kokën diku përplasi. Nëna thirri mjekun dhe ai i tha:

“Më kërcime të tilla, në krevat nuk ka”. 2 lepuj të vegjël po kërcejnë mbi krevat...

Kishim 3 lepuj, sa u larguan? Një u largua. Ka një më pak. Sa kanë mbetur?

Recitohet përsëri vjersha, këtë herë me dy lepujt që kërcejnë. Në fund bëhen pyetjet:

Ka një lepur më pak se më parë, me sa lepuj e filluam? (3)

Sa janë larguar? (1, 2...).

Sa mbeten?

Hapi 2

Mësuesi/ja shpjegon se në këtë pjesë do të mësojmë zbritjen. Shpjegon se zbritja është e lidhur me largimin ose heqjen e objekteve. Zbritjen e paraqesim me barazim në këtë mënyrë. Kujton nxënësit.

Sa lepuj ishin në fillim? (3)

Sa lepuj mbetën pasi u largua një? $3 - 1 = 2$ dhe *lexohet tre zbresim një baras katër.*

Numri që del nga zbritja quhet **ndryshesë**.

Hapi 3

Hapen librat. Mësuesi/ja ose një nxënës shpjegon se çfarë paraqitet në figurën e tekstit. Bashkëbisedohet rreth veprimet të zbritjes. U jepet më shumë rëndësi koncepteve: heqim, largohen, mbeten, zbritja. Nxënësit kryejnë veprimet në libër, ndërsa mësuesi/ja ndjek nga afër veprimet e tyre. Nëse ndonjë nxënës ka nevojë për ndihmë, ngre një nga letrat me ngjyrat e semaforit.

Mësuesi/ja mund të lexojë situatat dhe nxënësit plotësojnë.

Hapi 4

Mësuesi/ja krijon situata të ndryshme problemore për të përforcuar konceptin e zbritjes. Duhet të jetë e kujdesshme që të përdorë fjalor të larmishëm:

Sa mbetën? Si dhe shprehjet: “zbresim”, “një më pak”, “sa u rrëzuan?”, “sa mbetën?”

Nxit nxënësit që të krijojnë situata problemore me mjete rrethore.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet kuptimi i kërkesave të detyrave, duke u mbështetur në teknikën e semaforit.

Zgjidhja e problemave të thjeshta me fjalë dhe ilustrimi me sende.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 3.2 Zbritje nga numri 4	Fjalët kyçe: heq, mbetet, ndryshesa, minus.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - identifikon zbritjen si numërim mbrapsht (në rendin zbritës) dhe “heqje”; - verifikon rezultatin e një zbritjeje nëpërmjet paraqitjes në boshin numerik; - zgjidh problema të thjeshta me fjalë dhe i ilustron me sende. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej rezultatin e një zbritjeje nëpërmjet paraqitjes në boshin numerik; - zgjidh problema të thjeshta me fjalë dhe ilustron me sende. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, vjersha “Katër kekë të vegjël”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: boshti numerik, shkumësa me ngjyra, 4 balona.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (vjersha), Edukatë figurative (vizatimi i formave të ndryshme).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1 Recitoni vjershën “Katër kekë të vegjël”:

**4 kekë të shijshëm shiten në ëmbëltore,
kanë sheqer e arra dhe janë në formë rrethore.
Një ditë me një monedhë, një djalë i vogël vjen,
blen një kek të ëmbël dhe shpejt nga dera del.**

Zgjidhen katër objekte që të jenë në rolin e kekëve të vegjël dhe një nxënës që vjen në ëmbëltole. Recitoni vargjet ritmike me klasën. Pas largimit të kekut të parë, bëhen pyetjet.
Sa mbetën? Numërojnë bashkë 1, 2, 3.
 Vazhdohet me vjershën dhe numërimin, derisa të gjithë kekët të jenë larguar.

Hapi 2

Mësuesi/ja vizaton në tabelë një bosht numerik deri në 10. Shpjegon se ashtu si mbledhjen, edhe zbritjen, mund ta paraqesim në bosht. Paraqet skematikisht zbritjen në boshtin numerik.

Hapi 3

Vizaton një bosht të madh në dysheme dhe tregon veprimin e zbritjes me hapa. Për shembull, për veprimin 4-2. Eci 4 hapa, pastaj do të kthehem mbrapsht 2 hapa.

Te cili numër do të qëndroj?

Sa hapa më mbeten për të shkuar aty ku isha?

Veprimi përsëritet me nxënësit disa herë.

Hapi 4

Nxënësit vëzhgojnë figurën në tekst dhe numërojnë balonat. Nxiten të tregojnë me fjalë se 4 minus 1 bëjnë 3 dhe me barazim $4 - 1 = 3$. Më pas vazhdojnë me plotësimin e detyrave 1, 2, 3 dhe 4 ku do të gjejnë ndryshimin dhe të zbritshmin, duke u bazuar në figurat e dhëna.

Nxënësit e shkëmbejnë punën/detyrën me njëri-tjetrin dhe ata e krahasojnë detyrën e shokut/shoqes me listën e kriterëve të paraqitura për të gjithë nxënësit. Nxënësi-kontrollues duhet të sigurohet se janë përfshirë elementet themelore në punën e shokut/shoqes. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raportton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi/ja korrigjon gabimet para se të dorëzojë detyrën e tij (kontrolli para fluturimit).

Hapi 5

Nxënësit do të realizojnë në çifte aktivitetin e paraqitur në detyrën 5. Njëri nxënës do të vizatojë 4 forma të ndryshme dhe disa prej tyre do t'i ngjyrosë, kurse shoku/shoqja do të paraqesë me barazim se sa kanë mbetur pa u ngjyrosur. Shoku/shoqja do të shkruajë barazimin me zbritje. Përsëritet aktiviteti disa herë duke i ndërruar nxënësit rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet sa nxënësi kupton zbritjen si numërim mbrapsht (në rendin zbritës) dhe “heqje”. Zgjidhja e problemave të thjeshta me fjalë dhe ilustrimi me sende.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet në fletoren e punës në faqen e njësisë përkatëse.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 3.3 Zbritje nga numri 5	Fjalët kyçe: Zbritje, minus, birila, buling.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen numrin e elementeve që mbeten pas heqjes së një numri; - shkruaj barazime me zbritje, duke u mbështetur në situata të jetës së përditshme; - zgjidh problema të thjeshta me fjalë dhe i ilustron me sende. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - shkruaj barazime me zbritje, duke u mbështetur në të jetës së përditshme; - gjej numrin e gishtave që mbeten gjatë aktivitetit në çift, me duar; - krijo barazime duke u bazuar në numrin e birilave. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkurtesa me ngjyra, fleta me ngjyra, birila, shishe, top.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë fizike, Sporte dhe shëndeti (kërcimi në boshtin numerik).	

Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja vizaton një bosht numerik 0-10 në dyshtim të klasës. U kërkon nxënësve të qëndrojnë në formë rrethi në afërsi të boshtit numerik. Zgjidhet një nxënës që të bëhet “bretkosë” dhe kërkon që ai të vendoset mbi numrin 5. Nxënësi kërcen pas dy hapësira.

Është “bretkosa” mbi numrin 3?

Ushtrimi përsëritet disa herë, duke kërkuar nga nxënësit që të zgjedhin numra të ndryshëm nistorë deri në 5 dhe ndonjë numër tjetër për të kërcyer së prapthi. Nxënësit e tjerë parashikojnë se ku do të ndalen nxënësit që kryejnë ushtrimin.

Hapi 2.

Nxënësit punojnë në dyshe.

Thoni 1, 2, 3 dhe të dy ngrini lart disa gishta (mund të jetë çdo numër nga 1-5). Gjeni ndryshesën ndërmjet numrit të gishtave tuaj me atë të gishtave të shokut.

Përdoret kjo etapë për të parë dhe dëgjuar se si nxënësit gjejnë ndryshesat. Disa prej tyre mund të kenë nevojë për ndihmë.

Si e gjetët ndryshesën ndërmjet dy numrave?

Kërkojuni nxënësve të ndryshëm të tregojnë mënyrën e tyre të të arsyetuarit.

Hapi 3

Nxënësit vëzhgojnë figurën në tekst, numërojnë kubet, lexojnë barazimin dhe e paraqesin në boshtin numerik. Nxiten të tregojnë me fjalë se 5 minus 1 bëjnë 4. Më pas vazhdojnë me plotësimin e detyrave 1,2,3 dhe 4, ku mësuesi/ja lexon kërkesat e detyrave dhe nxënësit punojnë individualisht e më pas me anë të teknikës “Kontrolli para fluturimit” kontrollojnë librat e njëri-tjetrit. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi-autor korrigjon gabimet para se të dorëzojë detyrën e tij.

Hapi 4

Zbritja nëpërmjet lojës së bulingut.

Krijohet një rresht me pesë birila bulingu (në mungesë të birilave mund të përdoren edhe shishet plastike). Nxënësit gjuajnë me top dhe numërojnë se sa nga birilat janë rrëzuar dhe sa kanë mbetur. Për shembull: $5 - 3 = 2$

$$5 - 1 = 4$$

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet dhe merret parasysh: shkrimi i barazimeve me zbritje, duke u mbështetur në situata të jetës së përditshme; gjetja e numrit të elementeve që mbeten pas heqjes së një numri gjatë aktiviteteve; zgjidhja e problemeve të thjeshta me fjalë dhe ilustrimi me sende.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 3.4 Zbritje brenda 5	Fjalët kyçe: ndryshesa, hiq, zbres, minus.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - shkruan barazime me zbritje duke u mbështetur në situata të jetës së përditshme; - gjen numrin e elementeve që mbeten pas heqjes së një numri; - paraqet në boshtin numerik zbritjet e dhëna. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej ndryshesën e numrave gjatë aktivitetit me duar; - paraqit në boshtin numerik zbritjet e dhëna; - nxirr letrën e duhur sipas kërkesës së shokut/shoqes. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shiriti me ndarje nga 1 deri në 10, letrat me numra (0, 1, 2, 3, 4, 5).
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komentimi gjatë aktiviteteve); Shoqëria dhe mjedisi (rregullat gjatë lojës).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja vizaton në tabelë një shirit me ndarje nga 1 deri në 10:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----

Nxiten nxënësit të shohin ndarjet në këtë shirit dhe të lexojnë numrat në çdo ndarje. Mësuesi/ja tregon njërin nga numrat, për shembull numrin 5, dhe u drejtohet nxënësve.

Nga pjesa me numrin 5 duhet të kthehem pas, me 3 ndarje. Si mund ta gjejmë se te cila ndarje do të arrij?

Nxënësit lihen të diskutojnë për mënyrën e zgjidhjes së situatës dhe më pas mësuesi/ja pohon përgjigjen e saktë:

Numërojmë duke hequr 3 nga 5 ose themi që numërojmë në rendin zbritës: 4, 3, 2 (tregohet me dorë drejtimi i lëvizjes në shirit). Kështu nga 5 zbresim 3 dhe shkruajmë barazimin $5 - 3 = 2$.

Veprimi përsëritet me numra të tjerë.

Hapi 2

Nxënësit punojnë në dyshe.

Thoni 1, 2, 3 dhe të dy ngrini lart disa gishta (mund të jetë çdo numër nga 1-5). Gjeni ndryshesën ndërmjet numrit të gishtave tuaj me atë të gishtave të shokut.

Përdoret kjo etapë për të parë dhe dëgjuar se si nxënësit gjejnë ndryshesat. Disa prej tyre mund të kenë nevojë për ndihmë.

Si e gjetët ndryshesën ndërmjet dy numrave?

Kërkojuni nxënësve të ndryshëm të tregojnë mënyrën e tyre të të arsyetuarit.

Hapi 3

Nxënësit vëzhgojnë figurën në tekst, numërojnë shkallët dhe lexojnë barazimin e paraqitur nën figurë. Nxiten të tregojnë me fjalë se 4 minus 1 bëjnë 3. Më pas vazhdojnë me plotësimin e detyrave 1, 2, 3 dhe 4, ku mësuesi/ja lexon kërkesat e detyrave dhe nxënësit punojnë individualisht e më pas me anë të teknikës “Kontrolli para fluturimit” kontrollojnë librat e njëri-tjetrit. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi korrigjon gabimet përpara se të dorëzojë detyrën.

Hapi 4

Nxënësit do të realizojnë aktivitetin e paraqitur në tekst, në çift. Njëri nxënës ngre një kartë me numrin 5 dhe e udhëzon shokun/shoqen të heqë një numër (0, 1, 2, 3, 4, 5). Nxënësi i dytë ngre kartën me numrin e duhur. Veprimtaria përsëritet disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet shkrimi i barazimeve me zbritje, duke u mbështetur në boshtin numerik. Gjetja e numrit të elementeve që mbeten pas heqjes së një numri gjatë aktiviteteve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 3.5 Zbritje nga numri 6	Fjalët kyçe: më pak se, më i vogël se, zare, ndryshesë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - ilustron barazimet e dhëna me rrahë apo me figura të tjera; - shkruan barazime me zbritje, duke u mbështetur në situata të jetës së përditshme; - përdor shprehjet “më pak se”, “më i vogël se” sipas kërkesës së detyrës. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - vizato rrahë aq sa thotë barazimi i dhënë; - shkruaj barazime me zbritje, duke u mbështetur në rezultatin e zareve; - përdor shprehjet “më pak se”, “më i vogël se” sipas kërkesës së detyrës. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: top i vogël, zare.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (përdorimi i shprehjeve të nevojshme), Edukatë figurative (paraqitja e barazimeve me vizatim).	

Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja shkruan në tabelë barazime me zbritje dhe kërkon nga nxënësit që të vizatojnë rrahë aq sa thotë numërori i parë dhe të heqë aq sa thotë numërori i dytë.

P.sh. $6 - 4 = \dots$; $6 - 2 = \dots$; $6 - 5 = \dots$ etj.

Punohen veprimtaritë edhe në tabelë edhe në fletë nga nxënësit.

Hapi 2

Nxënësit pyeten për barazime që mund të dinë. Mësuesi/ja gjuan topin, ndërkohë që thotë një barazim. Nxënësi që pret topin duhet të thotë rezultatin e zbritjes.

Hapi 3

Nxënësit vëzhgojnë figurën në tekst dhe krahasojnë 6 yje me 4 yje. Mësohen të përdorin shprehjet “më pak se”, “më i vogël se”. Nxiten të tregojnë me fjalë se 4 ka dy më pak se 6, 4 është 2 më e vogël se 6.

Më pas vazhdohet me plotësimin e detyrave 1, 2 dhe 3, ku do të gjejnë ndryshimin duke u bazuar në tabelat dhe figurat e dhëna. Nxënësit shkëmbejnë punën/detyrën me njëri-tjetrin, si dhe kontrollojnë duke diskutuar rreth zgjidhjeve të bëra.

Hapi 4

Nxënësit zhvillojnë aktivitetin me zare të paraqitur në tekst, duke u bashkuar në çifte. Nxënësi i parë hedh dy herë zarin, kurse nxënësi i dytë krijon një barazim me numrat që fitohen me gjuajtje.

Për shembull:

$$6 - 2 =$$

$$5 - 1 =$$

Veprimi përsëritet disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet paraqitja me vizatim i barazimeve me zbritje, duke u mbështetur në kërkesën e mësuesit/es.

Merret parasysh gjetja e numrit të elementeve që mbeten pas heqjes së një numri gjatë aktiviteteve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 3.6 Zbritje nga numri 7	Fjalët kyçe: zbritje, kërcim së prapthi, shirit, heqje.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - identifikon zbritjen si numërim mbrapsht dhe “heqje”; shkruan fjalët që lidhen me veprimin e zbritjes; - verifikon rezultatin e zbritjes nëpërmjet mbledhjes së rezultatit me numrin më të vogël të shprehjes numerike; - zgjidh problema të thjeshta me fjalë dhe i ilustron me sende. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - parashiko se ku do të ndalet në boshtin numerik shoku/shoqja që kryen ushtrimi; - gjej ndryshesën ndërmjet numrit të gishtave që ke ngritur ti, me atë të gishtave të shokut/shoqes; - puno në shiritat me barazime, në çift. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: boshti numerik në dyshemenë e klasës, peri i kuq, shirita me barazime.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë fizike (kërcimet në boshtin numerik).	

Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja vizaton një bosht numerik 0-10 në dyshemenë e klasës. U kërkon nxënësve të qëndrojnë në formë rrethi në afërsi të boshtit numerik. Zgjidhet një nxënës që të luajë rolin e “bretkosës” dhe kërkon që ai të vendoset mbi numrin 7. Nxënësi kërcen mbrapa dy hapësira.

Është “bretkosa” mbi numrin 5?

Përsëritet ushtrimi disa herë, duke kërkuar nga nxënësit të zgjedhin numra të ndryshëm nistorë deri në 7, si dhe ndonjë numër tjetër të vogël për të kërcyer disa hapësira pas. Nxënësit e tjerë parashikojnë se ku do të ndalet shoku/shoqja që kryen ushtrimin.

Hapi 2

Nxënësit punojnë në dyshe.

Thoni 1, 2, 3 dhe të dy ngrini lart disa gishta (mund të jetë çdo numër nga 1-7).

Gjeni ndryshesën ndërmjet numrit të gishtave tuaj me atë të gishtave të shokut/shoqes.

Përdoret kjo etapë për të parë dhe dëgjuar se si nxënësit gjejnë ndryshesat. Disa prej tyre mund të kenë nevojë për ndihmë.

Si e gjetët ndryshesën ndërmjet dy numrave?

Hapi 3

Hapen librat. Mësuesi/ja së bashku me nxënësit diskutojnë figurën e paraqitur. Nxënësit lexojnë me zë barazimin dhe një nxënës paraqet veprimin e zbritjes në boshtin numerik me anë të perit të kuq (boshtin që ka vizatuar mësuesi/ja në mes të klasës).

Mësuesi/ja lexon ushtrimin e parë. Detyra plotësohet bashkërisht. Veprimi në bosht zhvillohet njësoj me atë të mëparshmin, veçse tani tregohet me kërcim. Një nxënës paraqet këto dy zbritje në mes të klasës në mënyrë që nxënësit ta kenë më të qartë punën e bërë. Nëse nxënësit e kanë kuptuar paraqitjen e veprimit të zbritjes, mund të punojnë individualisht. Mësuesi/ja mund të veprojë konkretisht me kërcimet në bosht për atë grup nxënësish që hasin vështirësi për kryerjen e veprimeve. Udhëzohen të rrethojnë numrin nga i cili nis numërimi dhe të shënojnë mbi harqet e kërcimit, numrin e hapave mbrapsht që do të kryejnë.

Hapi 4

Mësuesi/ja shpërndan shirita me barazimet e mbledhjes për çdo dyshe nxënësish dhe udhëzon nxënësit se për çdo barazim të mbledhjes, ata duhet të shkruajnë dy barazime të zbritjes.

Për shembull:

$$4 + 3 = 7$$

$$7 - 4 = 3$$

$$7 - 3 = 4$$

$$6 + 1 = 7$$

$$7 - 6 = 1$$

$$7 - 1 = 6$$

Jepet një shembull në tabelë dhe nxënësit lihen të punojnë për 2-3 minuta. Më pas, secila dyshe ngrihet në tabelë dhe shkruajnë barazimet që krijuan.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet me gojë për punën e bërë gjatë plotësimit të tekstit.

Vlerësimi i shiritave të plotësuar në dyshe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet në fletoren e punës në faqen e njësisë përkatëse.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 3.7 Zbritje deri në 7	Fjalët kyçe: mbledhje, zbritje, rezultat, situatë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - plotëson ushtrimet në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre; - verifikon rezultatin e një zbritjeje duke mbledhur rezultatin; - krijon mbledhje dhe zbritje për situatat e dhëna me figurë. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - plotëso ushtrimet 1, 2 dhe 3 në tekst, duke u bazuar në kërkesat e dhëna; - verifikoj rezultatin e një zbritjeje, duke mbledhur rezultatin; - krijo mbledhje dhe zbritje për situata të dhëna, duke iu përshtatur ilustrimit. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kalendari i vitit, figura reale ose vizatime me situata me mbledhje dhe zbritje, të ngjitura në fletë të bardha , letrat me ngjyrat e semaforit.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (leximi i ditëve të javës); Shoqëria dhe mjedisi (Ne të gjithë punojmë).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja afrohet te kalendari i vitit (gjendet dita, data, muaji, viti) dhe së bashku me nxënësit lexon ditët e javës. Pyeten nxënësit:

Në cilat ditë të javës punojmë e në cilat ditë e kemi pushim? Sa ditë kemi mësim e sa pushim gjatë javës?

Kërkon nga nxënësit ta paraqesin situatën më sipër me barazim me zbritje, barazime që do të punohen më pas së bashku me ta në tabelë.

$$5 + 2 = 7 \text{ ditë të javës}$$

$$7 - 5 = 2 \text{ ditë pushim}$$

$$7 - 2 = 5 \text{ ditë mësim}$$

Hapi 2

Nxënësit nxjerrin kubet dhe punojnë në dyshe. Nxënësi i parë vendos 5 dhe 2 kube mbi bankë dhe shkruan barazimin $5 + 2 = 7$.

Nga nxënësi i dytë kërkohet të shkruajë dy barazime me zbritje me të njëjtët numra.

$7 - 5 = 2$ dhe $7 - 2 = 5$. Nxënësit ndërrojnë rolet dhe përsërisin aktivitetin me numra të tjerë.

Hapi 3

Hapen librat. Nxënësit vëzhgojnë ilustrimin në tekst, ku janë të paraqitur 7 zogj. Fillimisht është i paraqitur barazimi me mbledhje e më pas nga shuma janë zbritur mbledhorët. Së bashku me nxënësit arrijmë në përfundimin se:

Për çdo mbledhje, mund të shkruajmë dy zbritje.

Nxënësit vazhdojnë plotësimin e detyrave 1, 2 dhe 3 individualisht, më pas diskutojnë në çifte dhe në grup. Për ndonjë paqartësi apo vështirësi, nxënësit kërkojnë ndihmë apo sqarim nga mësuesi/ja, duke ngritur kartën me ngjyrat e semaforit.

Hapi 4

Nxënësit vihen të punojnë në grupe me nga 4-5 vetë. Mësuesi/ja shpërndan në çdo grup figura ose vizatime me situata me mbledhje dhe zbritje, të ngjitura në fletë të bardha. Jep udhëzime për krijimet që do të bëjnë. Nxënësit do të shkruajnë poshtë figurës në fletën e bardhë barazime në përshtatje me figurat. Pasi përfundojnë, do të komentojnë punët e tyre para klasës.

Këto fletë mund të shërbejnë për plotësim të portofolit të nxënësve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet pavarësia e nxënësit për punën individuale në bazë të letrave me ngjyrat e semaforit; Vlerësohen punimet e nxënësve dhe ruhen në portofolin personal të nxënësit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënimit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20, duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 3.8 Zbritje nga numri 8	Fjalët kyçe: më pak, ndryshesa, ndërmjet, zbres.
Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - verifikon rezultatin e një zbritjeje nëpërmjet mbledhjes së rezultatit me numrin më të vogël të shprehjes numerike; - zgjidh problema të thjeshta me fjalë dhe i ilustron me sende; - krijon situata me fjalë dhe figura për barazime me zbritje si një veprim i kundërt i mbledhjes. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - plotëso detyrat në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre; - zgjidh problema të thjeshta me fjalë dhe ilustron me sende; - krijo situata me fjalë dhe figura për barazime me zbritje si një veprim i kundërt i mbledhjes. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: letrat numerike me numrat 1-8.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktivitetëve).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Çdo nxënës pajiset me një letër numerike ose një letër zbritjeje. Zhvillohet kjo lojë:

Kur të them 3, duhet të gjeni numra të tjerë, në mënyrë që të plotësohet një fjali numerike. Për shembull, letrat 8, 5 dhe 3 shkojnë mirë së bashku, sepse nga 8 heqim 3, baras me 5; ose nga 8 heqim 5, baras me 3. Kur të keni gjetur dy nxënësit e tjerë, formoni grupin tuaj, uluni së bashku dhe zgjidhni problemën e zbritjes që formohet nga letrat tuaja. Do të ketë dy zbritje të ndryshme për secilën palë letrash.

Vazhdohet loja edhe disa herë të tjera.

Hapi 2

Hapen librat. Mësuesi/ja orienton nxënësit të punojnë për plotësimin e ushtrimeve të librit. Punohet bashkërisht vetëm pjesa e parë. Nxënësit duhet të numërojnë makinat e verdha në rreshtin e parë dhe makinat e kuqe në rreshtin e dytë. Mësuesi/ja mund të ndihmojë nxënësit me pyetjet:

- Sa makina të verdha ka në rreshtin e parë?
- Sa makina të kuqe ka në rreshtin e dytë?

- Në cilin rreshtin ka më shumë?
- Sa më shumë?
- Në cilin rresht ka më pak?
- Sa më pak?

Plotësohet fjalia:

Ndryshesa e 8 me 5 është 3

$$8 - 5 = 3$$

Nxiten nxënësit të lexojnë atë që sapo shkruan. Pjesa tjetër e librit plotësohet në mënyrë të pavarur. Bëhet korrigjimi individual dhe vlerësimi me shkrim.

Hapi 3

Në tabelë, mësuesi/ja paraqet situatat e krijuara me fjalë e me figura.

Topa të kuq janë... Topa blu janë... Gjithsej janë: $5 + 3 = \dots$

Topa gjithsej janë... Topa të kuq janë... Topa blu janë $\dots - \dots = \dots$

Kërkon prej nxënësve të krijojnë situata të këtij lloji.

A mund të themi se zbritja është veprim i kundërt i mbledhjes? Po. Kërkohen me gojë barazime me zbritje si një veprim i kundërt i mbledhjes. $6 - 2 = 4$, sepse $4 + 2 = 6$ etj.

Hapi 4

Nxënësit zhvillojnë aktivitetin e paraqitur në detyrën 5 në tekst, ku në dyshe do të gjejnë shumën dhe ndryshimin e dy numrave.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me shprehje i fletës së tekstit që ka punuar nxënësi individualisht.

Krijimi i situatave duke u bazuar në kërkesat e dhëna.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 3.9 Zbritje nga numri 9	Fjalët kyçe: i zbritshmi, zbritësi, ndryshimi, heq.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - vizaton rrathë aq sa thotë numërori i parë dhe më pas heq aq sa thotë numërori i dytë; - emërton gjatë leximit të barazimeve të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin; - luan në dyshe, duke respektuar rregullat e lojës të vendosura më parë. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - vizato rrathë aq sa thotë numërori i parë dhe më pas heq aq sa thotë numërori i dytë; - emërto drejt gjatë leximit të barazimeve të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin; - luaj në dyshe, duke respektuar rregullat e lojës të vendosura më parë. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkumësa me ngjyra, kartat e semaforit, zar.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve)	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja shkruan në tabelë barazime me zbritje dhe kërkon nga nxënësit të vizatojnë rrathë aq sa thotë numërori i parë dhe të heqë aq sa thotë numërori i dytë.

Për shembull: $9 - 4 = \dots$

Punohen detyrat edhe në tabelë, edhe në fletë nga nxënësit. Pyeten nxënëset për barazime. Mësuesi/ ja hedh topin, ndërkohë që thotë një barazim. Nxënësi që pret topin duhet të thotë rezultatin e zbritjes.

Hapi 2

Mësuesi/ja fton pesë nxënës të dalin përpara klasës dhe të qëndrojnë në anën e djathtë. Fton dhe nëntë nxënës të tjerë të vijnë në cepin tjetër. Nxënësit e tjerë numërojnë me zë të lartë numrin e nxënësve për çdo grup. Mësuesi/ja vizaton në tabelë një bosht numerik nga 1 në 20 dhe rrethoni “5” dhe “9”. Pyet klasën se sa nxënës duhet të ulen, në mënyrë që të mbeten nga pesë nxënës në të dyja anët e klasës. Numëron nxënësit ndërsa ulen dhe paraqet veprimin në boshtin numerik.

Përsëritet në kor: *Nëntë heqim katër është baras me pesë.*

Përsëritet ushtrimin për grupet e tjera. Për shembull: “3” dhe “8”.

Hapi 3

Hapen librat. Mësuesi/ja orienton nxënësit të punojnë për plotësimin e ushtrimeve të librit. Punohet bashkërisht vetëm pjesa e parë. Nxënësit duhet të numërojnë arinjtë që gjenden në figurë. Mësuesi/ja mund të ndihmojë nxënësit me pyetjet:

Sa arinj janë duke qëndruar jashtë? Sa arinj janë duke hyrë në shpellë? $9 - 3 = 6$

Si quhet numri i parë te zbritja? (I zbritshmi) Si quhet numri i dytë? (Zbritësi)

Si quhet numri që fitohet kur zbresim dy numra? (Ndryshimi)

Pjesa tjetër e librit plotësohet në mënyrë të pavarur. Bëhet korrigjimi individual dhe vlerësimi me shprehje. Nxënësit që kanë nevojë për ndihmë, ngrenë një letër me ngjyrat e semaforit.

Hapi 4

Nxënësit zhvillojnë aktivitetin e paraqitur në detyrën 4. Nxënësi i parë hedh zarin, kurse shoku/shoqja zbrit numrin që tregon zari nga numri 6. Veprimi përsëritet disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me shprehje i fletës së tekstit që ka punuar nxënësi individualisht. Vlerësimi i letrave të ngritura gjatë plotësimit të tekstit.

Angazhimi gjatë aktivitetit, duke respektuar rregullat e caktuara më parë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 3.10 Zbritje nga numri 10	Fjalët kyçe: Heq, mbetet, 10 më pak, zbres, minus.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - shkruan barazime me zbritje, duke u mbështetur në situata të jetës së përditshme; - gjen numrin e elementeve që mbeten pas heqjes së një numri; - zgjidh problema të thjeshta me fjalë dhe i ilustron me sende; - përdor barazime për të gjetur numrin e elementeve që mbesin nga veprimi i zbritjes. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej ndryshimet gjatë heqjes së tullave nga muri; - plotëso ushtrimet, duke u bazuar në kërkesat e tyre; - numëro sa nga birilat janë rrëzuar dhe sa kanë mbetur gjatë lojës së bulingut. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube, shishe plastike ose birila, top.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (lojë numërimi), Edukatë fizike, Sportet dhe shëndeti (loja buling).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Në oborrin e shtëpisë sime ndodhet një mur shumë i lartë.

Ndërtoni një kullë me 10 kube/libra/fletore etj. Numëroni kubet.

Ky është muri që ndodhet në oborrin e shtëpisë. Unë kam qejf të shikoj përtej murit, por ai më pengon. Është shumë i lartë. Në mur janë 10 tulla. Më duhet që të heq 1 tullë nga muri.

Hiqet një kub nga kulla dhe vendoset në tavolinë.

Sa tulla janë tani në mur? Numëroni me mua: 1,2, 3 ... 9.

Mësuesi/ja tregon se si mund të shkruhet kjo: $10 - 1 = 9$.

Muri është ende shumë i lartë. Duhet që të hiqen edhe dy tulla të tjera. Heq dy kube nga kulla. Muri kishte 9 tulla, unë hoqa edhe 2 tulla të tjera.

Sa mbetën? Numëroni me mua 1, 2, 3 ... 7.

Tregon si mund të shkruhet kjo: $9 - 2 = 7$.

Muri vazhdon të jetë shumë i lartë. Me duhet të heq edhe 5 tulla të tjera.

Heq pesë kube nga muri dhe vendosini në tavolinë.

Unë kisha 7 tulla, 5 i hoqa. Sa tulla mbetën tani në mur? Numëroni me mua 1, 2.

Tregoni si mund të shkruhet veprimi: $7 - 5 = 2$.

Tani muri është aq i lartë sa më duhet.

Hapi 2

Mësuesi/ja vizaton në tabelë një bosht numerik dhe shënon në të 0 dhe 10, por asnjë numër ndërmjet këtyre dy numrave. U kërkon disa nxënësve të vijnë në tabelë, të shkruajnë në boshtin numerik një numër nistor (në pozicionin e tij të përafërt) dhe të vizatojnë një kërcim mbrapa. Ai shkruan sipër shigjetës sa ka kërcyer dhe pjesa tjetër e klasës duhet të thotë numrin ku duhet të ndalen. Përsëritet ushtrimin disa herë.

Hapi 3

Hapen librat. Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth figurës në tekst dhe zbritjes nga numri 10. Orientohen nxënësit se duhet të plotësojnë ushtrimet e librit. Tek ushtrimi i parë duhet të shkruajnë nga dy zbritje për çdo figurë. Për shembull:

$$10 - 8 = 2$$

$$10 - 2 = 8$$

Mësuesi/ja u lexon nxënësve kërkesat e ushtrimeve 2, 3 dhe 4 dhe më pas udhëzohen të vazhdojnë të punojnë në mënyrë individuale. Gjatë punës, nxënësit do të përdorin letrat me ngjyrat e semaforit për të kërkuar ndihmë apo për të treguar se e kanë të qartë njësinë mësimore.

Hapi 4

Zbritja nëpërmjet lojës së bulingut. Përdoren shishe plastike për të ndërtuar një rresht me dhjetë birila bulingu. Nxënësit gjuajnë me top dhe numërojnë se sa nga birilat janë rrëzuar dhe sa kanë mbetur.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet gjetjen e ndryshimeve gjatë heqjes së tullave nga muri. Plotësimin e ushtrimeve duke u bazuar në kërkesat e tyre.

Numërimin se sa nga birilat janë rrëzuar dhe sa kanë mbetur gjatë lojës së bullingut.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

Shënime: Në vazhdim të njësisë III, gjashtë njësitë në vijim janë ushtrime dhe problema.

Për realizimin e tyre mund të përdorni aktivitetet nga njësitë paraprake dhe ushtrime sa më praktike, në mënyrë që nxënësit të lidhin gjuhën e folur me ushtrimin.

TEMA 4: NUMRAT DHE NUMËRIMI DERI NË 20


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 15, duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. 1,2; 3. 3,4,5,6; 5. 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 4.1 Numrat deri në 15	Fjalët kyçe: numra, dhjetëshe, njëshe, bosht numerik.		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
<ul style="list-style-type: none"> - ndan numrat dyshifrorë në dhjetëshe dhe njëshe, si dhe anasjellas; - paraqet mbledhjen e numrit 10 me një numër njëshifror në boshtin numerik; - zgjidh detyrat e tekstit, duke u bazuar në kërkesat e dhëna. 			
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> - ndaj numrat dyshifrorë në dhjetëshe dhe njëshe; - shkruaj numrat e kërkuar në boshtin numerik; - plotëso detyrat në tekst në bazë të kërkesave të dhëna. 			
Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: materiale të ndryshme (fasule, kokrra misri), fletë të bardha me boshtin numerik.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (diskutimet gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje).			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1			
<p>Çdo dyshe nxënësish ka nga një qese me fasule (më pak se 15 kokrra). Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të gjejnë sa kokrra janë në qese. Njëri/njëra nga nxënësit/et duhet t’i nxjerrë nga qesja, duke i numëruar, ndërsa tjetri/tjetra duhet të kontrollojë numërimin e të parit. Vëzhgon në ç’mënyrë po numërojnë për shembull, mbase ata i ndajnë kokrrat në grupe pesëshe, në mënyrë që t’i numërojnë më shpejt. Kur të gjithë të kenë mbaruar numërimin, u kërkon çifteve të nxënësve që t’i grumbullojnë kokrrat në dhjetëshe dhe njëshe, si dhe u tregon se kjo mënyrë numërimi bën që kokrrat të numërohen shumë më shpejt.</p> <p>Mësuesi/ja vizaton tabelën e vlerave të numrave dhe ngre nxënësit në dyshe, në mënyrë që të shkruajnë numrin në tabelë, duke dalluar dhjetëshet dhe njëshet.</p>			

Dhjetëshe (Dh)	Njëshe (Nj)	Numri
1	4	14
1	1	11

Nxënësit/et do të shqiptojnë saktë numrin dhe do të dallojnë se sa dhjetëshe dhe njëshe ka.

Hapi 2.

Mësuesi/ja i jep një fletë secilit/ës nxënës, ku ka vizatuar një bosht numerik, në të cilin ata do të shkruajnë numrat deri në 10, kurse mësuesi/ja do të vazhdojë t'i shkruajë në tabelë dhe do të udhëzojë të vëzhgojnë se si shkruhen numrat nga 11-15.



Hapi 3

Udhëzohen nxënësit/et të hapin librat, të vëzhgojnë figurën, të diskutojnë rreth numrit të luleve që janë në vazo dhe jashtë saj. Theks të veçantë vihet te numri 10 i luleve në vazo dhe ngjyrave në kuti. Pyeten nxënësit: “Po të shtohet edhe lulja që gjendet jashtë saj, cili numër del?”. Lihen nxënësit/et të lirë të japin mendimet e tyre. Si përfundim i mendimeve të tyre del se vazo janë 10 lule brenda dhe një jashtë saj. Nëse mblidhet numri 10 me 1, del numri 11. E njëjta logjikë përsëritet edhe për ngjyrat në kuti dhe jashtë saj. Nxënësit familjarizohen edhe me shenjën “+” të veprimit të mbledhjes. Në detyrën e parë, nxënësit do të paraqesin mbledhjet me anë të boshtit numerik. Ata/ato vazhdojnë detyrën e tretë dhe kërkojnë ndihmë nëse kanë diçka të paqartë.

Hapi 4

Udhëzohen nxënësit/et që në çifte të luajnë lojën e paraqitur në detyrën 4. Së bashku me shokun/ shoqen do të vendosin duart mbi bankë dhe do të nxjerrin aq gishta sa të udhëzojë njëri/a nxënës/e nga çifti. Më pas ndërrohen rolet në çift.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vëzhgohet numërimi i materialeve të ndryshme dhe ndarja e tyre në dhjetëshe dhe njëshe. Renditja e numrave gjatë shkrimit në boshtin numerik.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 15 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. 1,2; 3. 3,4,5,6; 5. 1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 4.2 Numrat deri në 15	Fjalët kyçe: njëshe, dhjetëshe, kube, shufra.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - veçon materialet e ndryshme në grupe sipas kërkesës; - plotëson detyrat duke diskutuar në çifte dhe në grup zgjidhjen e bërë; - vendos etiketat e duhura gjatë aktivitetit të ndarjes në dhjetëshe dhe në njëshe. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - veço materialet e ndryshme në grupe sipas kërkesës; - ndaj numrat në dhjetëshe dhe njëshe gjatë plotësimit të tabelës; - vendos etiketat e duhura gjatë aktivitetit të ndarjes së numrit. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: materiale të ndryshme (fije, pipa, lapsa, një tufë më letra, një grusht me fasule), etiketat me numrat prej 1-15.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë aktiviteteve), Shkathtësi për jetë (punimi i etiketave me numra).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Në varësi të mundësive të klasës, numërimi në grupe me nga dhjetë mund të bëhet me kompletin e matematikës me shufra dhe kube, ose duke përdorur mjete rrethano.

Mësuesi/ja tregon përpara klasës një tufë me 15 fije, pipa, lapsa, një tufë më letra, një grusht me fasule etj.

- Si mund të numërohen ato?

Nxënësit numërojnë me zë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, teksa tregojnë objektet duke i ngritur lart.

- A është i lehtë numërimi i tyre? Duke qenë shumë, mos bëjmë ndonjë gabim?

Sugjeron që pjesa të ndahet në grupe më të vogla me 10 objekte së pari, që të mund të numërohen më me lehtësi.

Zgjidhen dy nxënës që të numërojnë secili nga 10 objekte. Grupimi duke krijuar një tufë ose një grumbull, në varësi të objekteve që mësuesi/ja ka zgjedhur.

Mësuesi/ja paraqet grupin me 10 objekte, por përsëri në tavolinë gjenden disa objekte të tjera të pa grupuara. Numërojmë së bashku sa objekte kanë mbetur 1, 2, 3, 4, 5. Kemi një tufë me 10 objekte dhe 5 objekte tjera.

Hapi 2

Vizaton një tabelë.

Dhjetëshe (Dh)	Njëshe (Nj)	Numri
1	5	15
1	1	11

Mësuesi/ja, në bashkëpunim me nxënësit/et, plotëson tabelën, duke theksuar që kemi 1 grup me dhjetë, pra 1 dhjetëshe dhe 5 njëshe dhe na formohet numri 15. Veprimtaria përsëritet edhe për numrat e tjerë.


Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku janë të paraqitura shufra dhe kubet. Mundësisht është mirë që nxënësit në grupe të kenë përpara shufra dhe kube, në mënyrë që t'i kenë më konkrete konceptet e shifrave dhjetëshe dhe njëshe. Pas numërimit, nxënësit/et do të paraqesin mbledhjen në boshtin numerik. Më pas do të vazhdojnë me plotësimin e detyrave të tjera, ku duhet të bëhet më shumë kujdes në shkrimin e numrave dyshifrorë, shifrës së njësheve dhe shifrës së dhjetësheve. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte e në grup.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të nxjerrin etiketat me numra prej 1-15 (të përgatitura në Shkathësi për jetë) dhe të punojnë në çifte. Njëri nxënës vendos një etiketë të një numri dyshifror, kurse nxënësi tjetër nën këtë numër do të vendosë numrin 10 dhe një numër njëshifror, që së bashku japin numrin e dhënë.

Për shembull:



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet se si veçon materialet e ndryshme në grupe sipas kërkesës.

Ndarja e numrave në dhjetëshe dhe njëshe gjatë plotësimit të tabelës.

Vendosja e etiketave të duhura gjatë aktivitetit të ndarjes së numrit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 15 duke përfshirë edhe numrin 0).	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1,2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 2; 3. 3,4,5,6; 5. 1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 4.3 Numrat deri në 15	Fjalët kyçe: shufra, kube, më i madh, më i vogël, më pak, më shumë.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - evidenton për secilin pjesëtar/e të grupit sa shufra dhe sa kube ka nxjerrë dhe numrin që u përgjigjet; - krahason numrin e vet të shufrave dhe kubeve me të shokëve/shoqeve të grupit; - luan, duke respektuar rregullat e lojës, të vendosura paraprakisht. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - shkruaj emrin e tij/të saj në tabelën e dhënë; - vendos mbi bankë një shufër dhe disa kube, duke treguar numrin e tyre; - krahaso numrin e tij/të saj të shufrave dhe kubeve me të shokëve/shoqeve të grupit; - nxirr kube sipas udhëzimit të shokut/qes. 	
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shufrat dhe kubet nga kompletet, etiketat me numrat 1-15.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (shkrimi i emrit në tabelë), Shoqëria dhe mjedisi (respektimi i rregullave të lojës dhe mendimit të njëri-tjetrit.)	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE





Hapi 1

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që të nxjerrin shufrat dhe kubet nga kompletet e tyre mbi banka. Nëse nxënësit nuk i kanë, mund të punohet nga kartoni në orën “Shkathësi për jetë”. Njëri nxënës nga grupi do të krijojë një tabelë të thjeshtë në fletën e bardhë, për të mbajtur evidencën për punën e shokëve/ shoqeve. Në çdo rast, edhe mësuesi/ja mund të krijojë një të gatshme. Udhëzohen nxënësit të nxjerrin afër vetes në banka nga një shufër dhe disa kube, më pak se 10. Nxënësi i caktuar do të evidentojë për secilin sa shufra dhe sa kube ka nxjerrë, si dhe numrin që u përgjigjet.

Fillimisht nxënësit do të diskutojnë në grupe, se kush ka numrin më të madh të shufrave të kubeve, për shembull:

Blini 11 < Eni 12 < Artani 13 < Aida 14 < ...

Një formë e thjeshtuar e tabelës mund të jetë si më poshtë:

Emri i shokut/shoqes	Shufra	Kube	Numri
Aida			14
Blini			11

Secili nxënës/e shkruan emrin e vet në tabelë, duke marrë parasysh që janë klasë e parë e nuk është e mundur që një nxënës/e të shkruajë emrat e të gjithëve.

Hapi 2

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku janë të paraqitur numrat prej 1-15 në formë të formueseve (*puzzle*). Do të fillojë diskutimi për renditjen e tyre dhe shenjën “më e vogël”, të vendosur prej numrit më të vogël në rendin rritës, për shembull: $11 < 12$. Këshillohet që nxënësit/et në grupe të kenë përpara shufra dhe kube, në mënyrë që t’i kenë më konkrete shifrat e dhjetësheve e të njësheve. Pas diskutimit, nxënësit do të vazhdojnë me plotësimin e detyrave të tjera ku duhet të bëhet kujdes i veçantë në ndarjen e numrave dyshifrorë në shifrën e dhjetësheve dhe të njësheve. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte dhe në grup. Pas përfundimit të detyrave nxënësit do të ndërrojnë librat dhe do të diskutojnë rreth detyrave të njëritjetrit.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që të luajnë në çifte lojën: “Nxirr 1 më shumë, ose 1 më pak”. Gjatë kësaj loje, nxënësi i parë, për shembull: nxjerr 1 shufër dhe 4 kube dhe udhëzon shokun/shoqen të nxjerrë për një më shumë apo për një më pak. Më pas nxënësit i ndërrojnë rolet dhe përsëritet veprimtaria disa herë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësojmë evidentimin në tabelë për secilin/ën, duke përcaktuar se sa shufra dhe sa kube ka nxjerrë dhe numrin që u përgjigjet.

Diskutimin me shokun/shoqen rreth përfundimit të detyrave në libër.

Nxjerr për një më shumë apo për një më pak kube sipas udhëzimit të shokut/shoqes.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 4.4 Problema	Fjalët kyçe: problema, kube formuese (<i>Legó</i>), të dhënat, zgjidhja.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen zgjidhjen e gjëgjëzës, duke mbledhur të dhënat gjatë leximit nga mësuesi/ja; - grumbullon të dhëna nga ilustrimi i paraqitur për të shtruar problemën; - zgjidh problemën në bazë të të dhënave nga ilustrimet apo nga sendet e paraqitura. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej zgjidhjen e gjëgjëzës, duke mbledhur të dhënat gjatë leximit nga mësuesi/ja; - mblidh të dhënat e duhura për zgjidhjen e problemës të paraqitur në ilustrim; - zgjidh problemën e dhënë duke u bazuar në të dhëna. 	
Burimet: Libër dhe fletore pune “Matematika 1”, gjëgjëza.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kube formuese (<i>Legó</i>) të madhësive të ndryshme, Fletë A/1 dhe A/3, foto të kubeve formuese (<i>Legó</i>) dhe të fëmijëve, lapsa shënjues (markera), ngjitës, kapëse.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (Komunikimi gjatë zgjidhjes së problemave), Edukatë figurative (vizatimi i të dhënave)	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive për numërimin 1-20. Tregohet një situatë problemore a gjëgjëzë. Mund të shoqërohen edhe me foto e revista.

**10 rosa po laheshin në liqen. Rrjedha e ujit pruri edhe 5 të tjera.
Sa rosa u bënë në liqen?**

Hapi 2

Mësuesi/ja vendos në tabelë një fletë të bardhë të formatit A/1, ku ka ngjitur disa sende dhe ndonjë figurë me të cilat mendon që nxënësit/et mund të krijojnë një problem. Mund të jetë një foto e dy fëmijëve, dy grumbuj të vegjël me kube formuese (jo më shumë se 20) dhe një pikëpyetje e madhe. Fëmijët, të ndihmuar nga mësuesi/ja do të provojnë të krijojnë problema të thjeshta me gjërat në fletë, si për shembull: Jona dhe Eri po luanin së bashku. Secili kishte nga disa kube formuese të

madhësive të ndryshme. Vendosën t'i bashkonin kubet formuese (*Lego*) dhe të krijonin një ndërtesë më të madhe. Sa kube formuese kanë Jona dhe Eri së bashku?

Hapi 3

Pasi krijuan problemën të gjithë së bashku, mësuesi/ja do t'u tregojë se si shkruhet (në mënyrën më të thjeshtë, duke marrë parasysh moshën e nxënësve) dhe si zgjidhet problema e krijuar.

Për shembull:

JONA



/

ERI



10

?

$$7 + 10 = 17$$

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të hapin librat dhe të vërejnë figurat në tekst. Secilit grup i ndan detyrë që të vizatojnë (në fletë A/3), të nxjerrin të dhënat dhe të zgjidhin njërën prej problemave (1-5). Nxënësit punojnë në grupe, por duke marrë parasysh që është klasë e parë, vazhdimisht këshillohen se si duhet respektuar mendimet e njëri-tjetrit në grup dhe si duhen ndarë përgjegjësitë.

Hapi 5

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të vendosin punimet (e punuara në grup) në “Telin tharës” dhe secili/a nxënës/e të shohë punimet e grupeve tjera dhe të vlerësojë me “+” punimin e grupit që mendon që ka punuar më mirë (Turi i galerisë). Nga vlerësimet e nxënësve nxirret grupi më i mirë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet nga përgjigjet e dhëna për zgjidhjen e gjëgjëzës a të problemës; argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së kubeve formuese (*Legove*); vlerësimet për grupin tjetër gjatë vendosjes së shenjave vlerësuese “+” te “Turi i galerisë”.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20, duke përfshirë edhe numrin 0); - numëron në rend rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20. 	Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2, 5); Individ i shëndoshë V (2, 5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3. 3,4,5,6; 5. 1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 4.5 Numrat deri në 20	Fjalët kyçe: ditëlindja, qirinj, plastelinë, shkopinj.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - argumenton për ngjashmërinë dhe ndryshimet mes numrave njëshifrorë dhe dyshifrorë; - plotëson detyrat në libër, duke diskutuar zgjidhjet e bëra; - identifikon numrat që mungojnë në vargun e numrave 1-20. Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - trego për ngjashmërinë dhe ndryshimet mes numrave njëshifrorë dhe dyshifrorë; - plotëso detyrat në libër, duke diskutuar zgjidhjet e bëra; - identifikoj numrat që mungojnë në punimin e realizuar në grup. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: plastelinë, shkopinj, kartonë në formë rrethi me numrat 1-20 dhe ngjitës.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (komunikimi gjatë diskutimit), Shoqëria dhe mjedisi (festat).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për paqe	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja zhvillon një diskutim me nxënësit/et rreth ditëlindjes dhe festimit të kësaj dite. Gjatë diskutimit, mësuesja pyet për moshën e vëllezërve apo motrave të nxënësve, apo një të afërmi që është më i rritur se nxënësit. Diskutojmë për numrin e qirinje që vendosim në tortë dhe sa qirinj duhen vendosur në tortë për një nxënës që është në klasën e gjashtë. Përgjigjja duhet të jetë 12 ose 13. Më pas, së bashku ndajmë numrat 12 dhe 13 në dhjetëshe dhe në njëshe.

Hapi 2

Nxënësve u paraqiten numra njëshifrorë dhe dyshifrorë për shembull: 9 dhe 19, dhe u kërkohet edhe përmes pyetjeve të bëjnë ngjashmërinë dhe ndryshimet që ekzistojnë mes tyre.

Për shembull: Çfarë kanë të përbashkët?

Të zgjidhen edhe 2 numra të tjerë e të përcaktohen ngjashmëritë. Nxiten nxënësit të argumentojnë mendimin.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin tekstet dhe të vëzhgojnë detyrat e dhëna. Rëndësi të veçantë ka theksimi i drejtë i numrave prej 11-20. Pas çdo detyre të librit, mësuesi/ja zhvillon një diskutim rreth zgjidhjeve dhe vështirësive të mundshme nga ana e nxënësve/eve. Nxënësit/et përdorin copat e kartonit me ngjyrat e semaforit në rast se kanë nevojë për ndihmë apo sqarime shtesë.

Hapi 4

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në grupe plastelinë, shkopinj, kartonë në formë rrethi me numrat 1-20 dhe ngjites (nëse nuk i kanë në klasë, i udhëzojmë nxënësit t'i sjellin paraprakisht). Nxënësit/et punojnë në grupe duke u bazuar në udhëzimet e mësuesit/es.

Punimi duhet të jetë i ngjashëm me grafikën e mëposhtme.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et do të zhvillojnë një aktivitet. Njëri nxënës/e do të largojë disa shkopinj me numra dhe do të kërkojë nga shoku/shoqja të identifikojë numrat që mungojnë. Veprimtaria realizohet me të gjithë anëtarët e grupit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen argumentet individuale të nxënësve për ngjashmërinë dhe ndryshimet mes numrave njëshifrorë dhe dyshifrorë.

Vlerësimi i ndërsjellë i punimeve të njëri-tjetrit/njëra-tjetrës.

Identifikimi i numrave që mungojnë në punimin e realizuar në grup.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare:** Matematikë / **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I / **Klasa:** I**Tema:** Numrat natyrorë**Rezultati i të nxënësve të temës:**

Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore:** 4.6 Numrat deri në 20**Fjalët kyçe:** boshti numerik, numëro, domino, shufra, kube.**Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:****Nxënësi/ja:**

- gjen numrat 1-20 në boshtin numerik sipas kërkesës nga mësuesi/ja gjatë aktivitetit;
- shkruan drejt numrat nga 1-20 në ushtrimet e dhëna;
- mbledh një numër dyshifror me një numër njëshifror duke mbetur brenda dhjetëshes përkatëse.

Kriteret e suksesit:

- gjej numrat 1-20 në boshtin numerik sipas kërkesës nga mësuesi/ja;
- shkruaj drejt numrat nga 1-20 në ushtrimet e dhëna;
- mbledh një numër dyshifror me një numër njëshifror në ushtrimet e dhëna.

Burimet: libri dhe fletore pune “Matematika 1”.**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** boshti numerik, kompleti me shufra dhe kube, fleta A/4 me paraqitjet e numrave 11-20 me shufra, domino.**Lidhja me lëndët tjera mësimore:** Gjuhë amtare (komentimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje).Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për paqe**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Hapi 1**

U kërkohet nxënësve të mbajnë përpara letrën me boshtin numerik (edhe me fletë të fotokopjuara). *Kujdes* që ndarjet në boshtin numerik të kenë largësi të mjaftueshme për të lejuar nxënësit të bëjnë lëvizjen me gisht ose me ndonjë mjet tjetër nga një ndarje në ndarjen pasardhëse. Zgjidhet numri 10. Iu kërkohet nxënësve të venë një shenjë ose ta qarkojnë me laps numrin 10 dhe të vendosin lapsin aty. Kalohet në kërkesën Numëroni edhe 8. Pasi të kenë numëruar, u kërkohet të qarkojnë edhe numrin ku mbërritën. *Kujdes* që të gjithë kenë mbërritur te numri 18. Iu kërkohet nxënësve të shkruajnë fjalinë numerike $10 + 8 = 18$. Përsëritet kjo veprimtari duke zgjedhur një numër tjetër. Përdoret edhe shprehja: Numëroni... më shumë.

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17 18 19 20

Hapi 2

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve nëpër grupe fletën A/4 ku janë të paraqitura nga dy shufra për numrat nga 11-20 dhe poshtë tyre janë barazimet që japin shumën e numrave përkatës. Udhëzohen nxënësit që në grupe të vendosin aq kube sa është shuma përkatëse p. Sh. $10 + 4 = 14$ (Nxënësit vendosin një shufër dhe 4 kube).



Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën ku janë të paraqitura shufra dhe kubet. Mundësisht është mirë që nxënësit në grupe të kenë përpara shufra dhe kube, në mënyrë që t'i kenë më konkrete detyrat e dhëna në tekst.. Në ilustrimin e tekstit janë të paraqitura dy shufra ku do t'i japim theks të veçantë formimit të numrit 20 nga dy shufra ose me mbledhjen e dy numrave 10. Më pas do të vazhdojnë me plotësimin e detyrave tjera ku duhet të kthehet shuma në dy mbledhorë ku mbledhori i parë duhet të jetë 10. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte dhe në grup.

Hapi 4

Udhëzohen nxënësit që në çifte të luajnë lojën me domino të paraqitur në libër. Njëri nxënës ngrit kartën me numër kurse shoku/shoqja formon numrin e dhënë me domino. Përsëritet veprimtaria dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së numrave në boshtin numerik;

Vendosja e shufrave dhe kubeve duke u bazuar në barazimet e dhëna.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë			
Rezultati i të nxënit të temës:		Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1, 3); Mendimtar kreativ II (1, 2, 7); Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).	
<ul style="list-style-type: none"> - Tregon të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime; - Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20, duke përfshirë edhe numrin 0). 			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 4.7 Dhjetëshe dhe njëshe	Fjalët kyçe: dhjetëshe, njëshe, shufra, kube.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen zgjidhjen e gjëgjëzës duke mbledhur të dhënat gjatë leximit nga mësuesi/ja; - ndan numrat 1-20 në numrat njëshifrorë dhe dyshifrorë; - vendos shufrën dhe kubet duke u bazuar në etiketën me numër që ngrit shoku/shoqja. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej zgjidhjen e gjëgjëzës, duke dëgjuar me vëmendje kur lexon mësuesi/ja; - ndaj numrat 1-20 në numra njëshifrorë dhe dyshifrorë; - identifikoj sa shufra dhe sa kube duhet të nxirren për numrin e dhënë. 	
Burimet: libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”, libri me gjëgjëza.	Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kompleti me shufra dhe kube, etiketat me numrin nga 1-20, kartat me ngjyrat e semaforit.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe (gjëgjëza), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËSME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive. Nxënësve u lexohet gjëgjëza dhe u jepet mundësia të japin zgjidhjet.

**Tufën me lule për nënën mbloodha,
11 trëndafila dhe 7 zambakë zgjodha.
Kush nga ju më thotë sa lule përdora?**

Hapi 2

Nxënësve u kërkohet të renditin etiketat me numrin nga 1-20 dhe anasjelltas. Gjithashtu u kërkohet t'i ndajnë ato në dërrasë në dy grupe një dhe dyshifrorë.


Numra njëshifrorë	Numra dyshifrorë

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën, ku janë të paraqitura shufrat dhe kubet. Rekomandohet që nxënësit në grupe të kenë përpara shufra dhe kube, në mënyrë që t'i kenë më konkrete shifrat e dhjetësheve dhe të njësheve. Pas numërimit, nxënësit do të ndajnë shifrën e dhjetësheve dhe shifrën e njësheve. Më pas do të vazhdojnë me plotësimin e detyrave të tjera, ku duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi shkrimit të numrave dyshifrorë, shifrës së njësheve dhe shifrës së dhjetësheve. Nxënësi do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte dhe në grup. Gjatë punës, nxënësit/et do të përdorin copat e kartonit me ngjyrat e semaforit, nëse kanë nevojë për përkrahje apo nëse nuk i kuptojnë detyrat.

Hapi 4

Nxënësit/et do të luajnë me shufra dhe kube. Njëri/a nxënës/e nga grupi do të ngrejë një etiketë me një numër dyshifrorë (10-20) e detyra e dy nxënësve të tjerë është të nxjerrin aq shufra dhe kube sa tregon numri.

Për shembull:

Përsëritet veprimi edhe me numrat tjerë, si dhe nxënësit ndërrojnë rolet gjatë lojës.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet numërimi nga 1 në 20 në rendin rritës dhe zbritës; përgjigjet e dhëna në zgjidhjet e gjëgjëzës; saktësia gjatë ndarjes së numrave në dhjetëshe dhe njëshe në detyrat e tekstit dhe aktivitete.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë / Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: I / Klasa: I	
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënimit të temës: Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime; Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).
Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 4.8 Dhjetëshe dhe njëshe	
Fjalët kyçe: dhjetëshe, njëshe, numërorë, ngjyra.	
Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - ndan numrat 1-20 në numrat njëshifrorë dhe dyshifrorë; - shkruan në fletore numrin e kërkuar duke u bazuar në kërkesën me numërorë apo me ngjyra të shokut/shoqes; - plotëson detyrat e dhëna në libër duke u bazuar në kërkesat e dhëna. 	
Kriteret e suksesit	
<ul style="list-style-type: none"> - ndaj numrat 1-20 në numra njëshifrorë dhe dyshifrorë; - numëro goglat e numërores dhe ngjyrat për numrin e dhënë; - plotëso detyrat e dhëna në libër duke u bazuar në kërkesat e dhëna. 	
Burimet: libri dhe fletore pune “Matematika 1”.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kompletet me ngjyra të nxënësve, numërorët, etiketat me numrin nga 1-20, kartat me ngjyrat e semaforit.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të nxjerrin numërorët dhe në çifte të kërkojnë nga njëri-tjetri të tregojnë numrin e caktuar me goglat e numërores. Nxënësit gjatë punës në numërorë udhëzohen të shkruajnë në fletoret e tyre se sa dhjetëshe dhe sa njëshe ka numri i kërkuar. Përsëritet veprimtaria disa herë dhe kërkohet nga nxënësit të ndërrojnë rolet.	
Hapi 2	
Udhëzohen nxënësit që të nxjerrin kompletet e ngjyrave. Njëri nxënës i çiftit i ndan 10 ngjyrat e veta në kuti apo i lidh me diçka në mënyrë që të qëndrojnë grumbull. Të ndara nga 10 dhe ngjyrat tjera i lënë të ndara mbi bankë (më së shumti 10 ngjyra). Udhëzohen nxënësit që të vendosin kompletin me ngjyra (10) dhe ngjyra tjera dhe të pyesin njëri-tjetrin se sa dhjetëshe dhe sa njëshe i ka numri i dhënë.	

Numri i ngjyrave	Dhjetëshe	Njëshe	Gjithsej
	1	5	15
	1	2	12

Përsëritet veprimtaria disa herë, nxënësit duke ndërruar rolet.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën ku janë të paraqitura shufrat dhe kubet. Mundësisht është mirë që nxënësit në grupe të kenë përpara shufra dhe kube, në mënyrë që t'i kenë më konkrete shifrën e dhjetëshe dhe njësheve. Pas numërimit, nxënësit do të ndajnë shifrën e dhjetësheve dhe shifrën e njësheve.

$$1 \text{ Dh} + 5 \text{ Nj} = 15 \text{ NJ}$$

$$10 + 5 = 15$$

Më pas, do të vazhdojnë me plotësimin e detyrave tjera, ku duhet të vihet kujdes i veçantë në shkrimin e numrave dyshifrorë, shifrës së njësheve dhe shifrës së dhjetësheve. Nxënësi do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte dhe në grup. Gjatë punës, nxënësit do të përdorin kartat me ngjyrat e semaforit, nëse kanë nevojë për përkrahje apo nëse nuk i kuptojnë fare detyrat.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të ndahen në çifte, si janë të ulur në banka (eventualisht nëse mësuesi/ja ka nevojë për ndonjë kombinim ku nxënësit do të ndihmojnë njëri-tjetrin apo për barazi gjinore të mos i ndajnë djemtë dhe vajzat veçantë) dhe duke vëzhguar figurën në libër të luajnë lojën. Njëri nxënës vendos në tabelë shifrën e dhjetësheve dhe njësheve, kurse nxënësi tjetër do të gjejë sa dhjetëshe e sa njëshe ka dhe cili është numri i dhënë. Veprimtaria përsëritet disa herë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet argumenti individual se sa dhjetëshe dhe sa njëshe ka numri i kërkuar në numëror;

Plotësimi i tabelës në bazë të ngjyrave;

Respektimi i njëri-tjetrit gjatë aktiviteteve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë / Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: I / Klasa: I	
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënësve të temës: Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna;
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 4.9 Problema	
Fjalët kyçe: problema, merimanga, edhe, barazi.	
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen zgjidhjen e gjëgjzës duke mbledhur të dhënat gjatë leximit nga mësuesi/ja; - grumbullon të dhëna nga foto për të shtruar problemën; - zgjidh problemën në bazë të të dhënave nga fotot apo gjësendet e paraqitura. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - trego shumën e dy mbledhorëve gjatë lojës “Merimanga“; - gjej zgjidhjen e gjëgjzës duke mbledhur të dhënat gjatë leximit nga mësuesi/ja; - mblidh të dhënat e duhura për zgjidhjen e problemës në foto; - zgjidh problemën e dhënë duke u bazuar në të dhëna. 	
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”, gjëgjzëza.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Lëmsh me fije leshi,	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (Komunikimi gjatë zgjidhjes së problemave), Edukatë figurative(vizatimi i të dhënave)	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive për numërimin 1-20. Tregohet një situatë problemore gjëgjzë. Mund të shoqërohen edhe me foto e revista.	
<div style="border: 2px solid #ADD8E6; border-radius: 15px; padding: 10px; width: fit-content; margin: 0 auto;"> <p>10 rosa po laheshin në liqen. Filloi një erë e fortë dhe erdhën edhe 5 rosa të tjera të lahen në liqen. Sa rosa u bënë në liqen?</p> </div>	
Hapi 2	
Aktiviteti “Merimanga». Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të krijojnë një rreth në mes të klasës dhe më pas me një lëmsh me fije leshi do të fillojë aktivitetin. Së pari, mësuesja do të kërkojë nga nxënësi, të cilit do t’ia hedhë topin të tregojë sa është shumta e numrave 10 dhe 5. Nxënësi do t’i përgjigjet, nëse nuk e di, do të thotë vetëm “paso” dhe do t’ia hedhë lëmshin dikujt tjetër. Nëse e thotë shumën e saktë do të kërkojë	

nga nxënësi që ia hedh lëmshin të gjejë shumën e një barazimi p.sh.: 10 dhe 7. Kriter duhet të jetë që mbledhori i parë të jetë 10.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurat në tekst. Secilit grup iu ndan detyrë që të vizatojnë (në fletë A/3), të nxjerrin të dhënat dhe të zgjidhin njërin problemë (1-5). Nxënësit punojnë në grupe, duke marrë parasysh që është klasë e parë, vazhdimisht këshillohen se si duhen respektuar mendimet e njëri-tjetrit në grup dhe si duhen ndarë përgjegjësitë.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të vendosin punimet (e punuara në grup) në “Telin tharës” dhe secili nxënës të shikojë punimet e grupeve tjera dhe të vlerësojë me “+” punimin e grupit që mendon që ka punuar më mirë. (Turi i galerisë). Nga vlerësimet e nxënësve nxirret grupi më i mirë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen përgjigjet e dhëna në zgjidhjes e gjëgjzës; përgjigjet për shumën e dy mbledhorëve gjatë lojës “Merimanga”; si dhe vlerësimet për grupin tjetër gjatë vendosjes së “+” te “Turi i galerisë”

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë / Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: I / Klasa: I	
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënësve të temës: Tregon paraardhësin, pasardhësin, qëndron ndërmjet, të numrave nga 1 deri në 20.
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 4.10 Para... Pas... Ndërmjet...	
Fjalët kyçe: para, pas, ndërmjet.	
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - rendit numrat 1-20 nga më i vogli te më i madhi dhe anasjelltas; - identifikon numrat para dhe pas numrit të dhënë në detyrat e dhëna; - formulon shembuj të rinj në fletoren e tij/saj. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - rendit numrat e dhënë nga më i vogli te më i madhi dhe anasjelltas; - gjej numrat para dhe pas numrit të dhënë në "Shiritin e numrave"; - shkruaj në fletore një shembull të ngjashëm me shembujt e dhënë në libër. 	
Burimet: libri dhe fletore pune "Matematika 1".	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketë me numrat 1 deri në 10, "Shiriti me numrat 1-20".	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Edukatë fizike, Sportet dhe Shëndeti (kërcimi në "Shiritin e numrave 1-20"), Edukatë Figurative (vizatimi në libër dhe fletore), Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve etiketa me numra 1-20 dhe kërkon të bëjnë renditjen e numrave nga më i vogli te më i madhi dhe anasjelltas. Përsëritet disa herë veprimtaria.	
Hapi 2	
Mësuesi/ja fton tre nxënës të dalin te tabela dhe nxënësit në mes ia jep një numër p.sh.: numrin 15. Kërkon nga nxënësit të tregojnë se cili numër është para numrit 15 dhe nxënësi i parë e merr etiketën me numrin 14. Më pas, pyet se cili numër vjen pas numrit 15 dhe nxënësi i tretë merr etiketën me numrin 16. Përsëritet aktiviteti edhe me një numër tjetër p.sh.: numrin 19.	
Hapi 3	
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat, të vërejnë boshtin numerik të numrave 1-20 dhe të identifikojnë numrat para dhe pas numrit të dhënë. Më pas do të vazhdojnë me plotësimin e detyrave tjera ku duhet të vihet kujdes i veçantë komentimit gjatë plotësimit të detyrave dhe përsëritjes së shpeshtë ë fjalëve: Para,	

pas dhe ndërmjet. Gjatë punës nxënësit do të përdorin kartat me ngjyrat e semaforit nëse kanë nevojë për përkrahje apo nëse nuk i kuptojnë fare detyrat.

Hapi 4

Vendoset shiritin me numrat 1-20 (I mbaruar me fleta A/4 të ngjitura 1-20 ose i gatshëm nga materiali) në mes të klasës dhe kërkohet që një nxënës të qëndrojë mbi njërin numër, si dhe të pyesë shokët/shoqet se cilin numër e ka para e cilin numër ka pas. Një nxënës shënon në tabelë numrat e përzgjedhur dhe numrat para dhe pas tyre.

Hapi 5

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të vizatojnë një tabelë të ngjashme me tabelat e detyrës 3, por të ndërrojnë numrat. Pasi plotësojnë tabelën nxënësit ndërrojnë fletoret dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. (vlerësimi i ndërsjellë)

Para		Pas


VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet renditja e numrave nga më i vogli te më i madhi dhe anasjelltas.
Identifikimi i numrave që janë para dhe pas numrit të dhënë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: I Klasa: I	
Tema: Bashkësitë dhe relacionet	Rezultati i të nxënësve të temës: Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet; më shumë, më pak, aq sa;
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (2, 4,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1,3; 3.3,4,5,6; 5.1; 6.1,2.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 4.11 Krahasimi i numrave	
Fjalët kyçe: më i madh, më i vogël, rregullat e lojës.	
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - dallon bashkësitë që kanë më shumë apo më pak shufra dhe kube; - krahason numrat 1-20 duke vendosur shenjat “më e madhe” apo ”më e vogël” në bazë të kërkesës së detyrës; - luan lojën duke respektuar rregullat e vendosura më parë. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej se kush ka më shumë apo më pak shufra dhe kube; - vendos shenjën ”më e madhe” apo ”më e vogël” në detyrat e dhëna në tekst; - shkruaj numrin më të madh ose më të vogël se numri që të ka shkruar shoku/shoqja. 	
Burimet: libri dhe fletore pune “Matematika 1”.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me numrat 1-20, ilustrime me shenjat më e madhe dhe më e vogël, kutia lapsash, ngjyra druri, shufra, kube, tabela të vogla që fshihen.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komentimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja), Shoqëria dhe mjedisi (respektimi i rregullave gjatë lojës).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Udhëzohen nxënësit që të nxjerrin kutitë e lapsave me ngjyrë mbi bankë. Secili nxënës do të numërojë lapsat me ngjyrë, si dhe do të krahasojë me shokun/shoqen e bankës. Nxënësit pyesin njëri-tjetrin: Sa ngjyra ke në kuti? Kush ka më shumë ngjyra në kuti? Kush ka më pak ngjyra në kuti?	
Hapi 2. Mësuesi/ja u shpërndan secilit çift shenjat “më e madhe”, “më e vogël” të ilustruara dhe udhëzon nxënësit të vendosin shenjën e duhur në mes të kutive të lapsave. Gjithmonë duke iu kujtuar se goja hapet te numri më i madh. Më pas, nxënësit ndërrojnë kutitë e lapsave dhe ndërrojnë shenjën në mes.	



Hapi 3

Nxënësit hapin librat dhe fillojnë të zgjidhin detyrat e tekstit. Fillimisht, numërojnë shufrat dhe kubet, si dhe gjejnë numrin e tyre duke i krahasuar cili është më i madh e cili më i vogël. Në detyrat në vijim do të ngjyrosin sipas udhëzimeve numrat më të mëdhenj dhe më të vegjël me ngjyrën e caktuar. Kujdes të theksuar mësuesi/ja vë re renditja e numrave në bazë të kërkesës dhe të kuptimi i shenjave “më e madhe” apo “më e vogël”. Mësuesi/ja u qëndron afër për çdo vështirësi të mundshme gjatë plotësimit të tekstit. Nxënësit ngjisin etiketat e kuqe apo portokalli nëse kanë nevojë për sqarime.

Hapi 4

Nxënësit pajisen me etiketa me numrat 1 deri në 20 dhe udhëzohen të vendosin secili nga një numër mbi bankë dhe më pas të vendosin shenjën adekuate, më e madhe apo më e vogël. Përsëritet aktiviteti disa herë në mënyrë që të familjarizohen me këto shenja.

Hapi 5


Udhëzohen nxënësit të luajnë lojën e paraqitur në tekst. Gjatë kësaj loje, nxënësit do të përdorin tabelat e tyre të vogla. Nxënësit do të përsërisin veprimtarinë disa herë duke respektuar rregullat e lojës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vendosja e shenjës “më e madhe” apo “më e vogël” në detyrat e dhëna në tekst.
Renditja e numrave në bazë të kërkesës.
Komunikimi me shokun/shoqen gjatë lojës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: I Klasa: I	
Tema: Bashkësitë dhe relacionet	Rezultati i të nxënimit të temës: Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet; më shumë, më pak, aq sa.
Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (2, 4,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1,3; 3.3,4,5,6; 5.1; 6.1,2.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 4.12 Krahasimi i numrave	
Fjalët kyçe: më i madh, më i vogël, rregullat e lojës.	
Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - dallon bashkësitë që kanë më shumë apo më pak fasule apo kokrra misri; - krahason numrat 1-20 duke vendosur shenjat "më e madhe" apo "më e vogël" në bazë të kërkesës së detyrës; - luan lojën duke respektuar rregullat e vendosura më parë. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej se kush ka më shumë apo më pak fasule apo kokrra misri; - vendos shenjën më e madhe apo më e vogël në detyrat e dhëna në tekst; - shkruaj numrin më të madh ose më të vogël se numri që të ka shkruar shoku/shoqja. 	
Burimet: libri dhe fletore pune "Matematika 1".	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me numrat 1-20, ilustrime me shenjat më e madhe dhe më e vogël, kokrra të fasules apo të misrit, shufra, kube.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komentimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja), Shoqëria dhe mjedisi (respektimi i rregullave gjatë lojës).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Udhëzohen nxënësit që të nxjerrin kokrra të fasules apo të misrit (u kërkohen një ditë më parë nxënësve ose i siguron mësuesi/ja) dhe në çifte të vendosin prej 10 deri 13 ose tre numra tjerë të njëpasnjëshëm.	
Hapi 2	
Mësuesi/ja u shpërndan secilit çift shenjat "më e madhe", "më e vogël" të ilustruara dhe udhëzon nxënësit të vendosin shenjën e duhur në mes të fasuleve apo kokrrave të misrit. Gjithmonë duke iu kujtuar se goja hapet ka numri më i madh.	
10 11 12 13	

Hapi 3

Nxënësit hapin librat dhe fillojnë të zgjidhin detyrat e tekstit. Fillimisht numërojnë shufrat dhe kubet, si dhe lexojnë numrin e tyre duke i krahasuar cili është më i madh e cili më i vogël. Në detyrat në vijim do të gjejnë numrat që janë më të mëdhenj apo më të vegjël, si dhe do të vendosin shenjën e duhur në mes tyre. Nxënësit do të identifikojnë tre numra më të mëdhenj se numri në fjalë. P.sh.: 3 numra më të mëdhenj se numri 17 (18,19,20).

Mësuesi/ja u qëndron afër për çdo vështirësi të mundshme gjatë plotësimit të tekstit. Nxënësit ngjisin etiketat e kuqe apo portokalli nëse kanë nevojë për sqarime.

Hapi 4

Nxënësit pajisen me etiketa me numrat 1 deri në 20 dhe udhëzohen të vendosin secili nga një numër mbi bankë dhe më pas të vendosin shenjën adekuate, më e madhe apo më e vogël. Përsëritet aktiviteti disa herë në mënyrë që të familjarizohen me këto shenja.

Hapi 5

Udhëzohen nxënësit të luajnë lojën të ngjashme si në detyrën 4 në tekst. Gjatë kësaj loje, nxënësit do të përdorin etiketat e numrave 1-20. Nxënësit do të përsërisin veprimtarinë disa herë duke respektuar rregullat e lojës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vendosja e shenjës "më e madhe" apo "më e vogël" në detyrat e dhëna;

Renditja e numrave në rendin rritës apo zbritës në bazë të kërkesës;

Komunikimi me shokun/shoqen gjatë lojës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare:** Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I**Tema:** Numrat natyrorë**Rezultati i të nxënësve të temës:**

Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore:** 4.13 Numërimi duke shtuar**Fjalët kyçe:** boshti numerik, shirit me numra, kërcim.**Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:**

- gjen numrat 1-20 në boshtin numerik dhe vazhdon numërimin sipas kërkesës nga mësuesi/ja;
- identifikon numrat ku arrin lepuri pas kërcimeve;
- kërcen në shiritin me numrat 1-20 duke zbatuar rregullat e dhëna.

Kriteret e suksesit:

- gjej numrat 1-20 në boshtin numerik dhe vazhdo numërimin sipas kërkesës nga mësuesi/ja;
- identifikoj numrat ku arrin lepuri pas kërcimeve të kërkuara në tekst;
- kërcë në shiritin me numrat 1-20 duke zbatuar rregullat e dhëna.

Burimet: libri dhe fletore pune “Matematika 1”.**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** boshti numerik, shiriti me numrat 1-20 i punuar me lule nga materiali i gomës apo letra e trashë me ngjyra.**Lidhja me lëndët tjera mësimore:** Gjuhë amtare (komentimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti (kërcimi në shiritin e numrave).Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për paqe**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Hapi 1**

U kërkohet nxënësve të mbajnë përpara letrën me boshtin numerik (edhe me fletë të fotokopjuara). Kujdes që ndarjet në boshtin numerik të kenë largësi të mjaftueshme për të lejuar nxënësit të bëjnë lëvizjen me gisht ose me ndonjë mjet tjetër nga një ndarje në ndarjen pasardhëse. Zgjidhet numri 10. Iu kërkohet nxënësve të venë një shenjë ose ta qarkojnë me laps numrin 10, si dhe të vendosin lapsin aty. Kalohet në kërkesën: numëroni edhe 8. Pasi të kenë numëruar, u kërkohet të qarkojnë edhe numrin ku mbërritën. Kujdes që të gjithë kenë mbërritur te numri 18. Iu kërkohet nxënësve të shkruajnë fjalinë numerike $10 + 8 = 18$. Përsëritet kjo veprimtari duke zgjedhur një numër tjetër. Përdoret edhe shprehja: numëroni... më shumë.

Hapi 2

Mësuesi/ja thotë një numër dhe kërkon nga një nxënës/të vazhdojë të numërojë deri në 20. P.sh. numri 16 (17, 18, 19, 20). Më pas përsëritet veprimtaria me një numër tjetër p.sh. 12 dhe i kërkohet një nxënës/ nxënese të numëroj me nga dy (14, 16, 18, 20). Përsëritet veprimtaria edhe me numra tjerë p.sh.: 3 etj.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën ku janë të paraqitura boshtet numerike, si dhe detyra e nxënësve është të vazhdojnë me numrat tjerë sipas rregullës së vënë. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte dhe në grup. Gjatë punës, nxënësit me kartat e semaforit kërkojnë ndihmë nëse kanë nevojë.

Hapi 4

Udhëzohen nxënësit që të kërcejnë në shiritin e numrave të përgatitur nga materiali prej gome me ngjyra të ndryshme dhe me formë sipas dëshirës (1-20). Nxënësi/nxënësja kërcen varësisht prej udhëzimit për shembull prej numrit 2 me nga dy, me nga një etj.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së numrave në boshtin numerik, si dhe kërcimi në shiritin me numra varësisht nga udhëzimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë / Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: I / Klasa: I	
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënësve të temës: Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20;
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 4.14 Numërimi duke hequr	
Fjalët kyçe: boshti numerik, shirit me numra 1-20, kërcim, rend rritës, rend zbritës.	
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen numrat 1-20 në boshtin numerik dhe vazhdon numërimin në rendin zbritës sipas kërkesës; - identifikon numrat ku arrin lepurin pas kërcimeve nga numri 20 te numrat më të vegjël; - kërcen në shiritin me numrat 1-20 duke zbatuar rregullat e dhëna. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej numrat 1-20 në boshtin numerik dhe vazhdo numërimin në rendin zbritës sipas kërkesës; - identifikoj numrat ku arrin lepurin pas kërcimeve të kërkuara në tekst; - kërcë në shiritin me numrat 1-20 duke zbatuar rregullat e dhëna. 	
Burimet: libri dhe fletore pune “Matematika 1”.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkumësa të trashë me ngjyra, lodër e butë (lepur apo ndonjë kafshë tjetër), shiriti i numrave 1-20.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komentimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti (kërcimi në shiritin e numrave).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Mësuesi/ja i njofton nxënësit që këtë orë të mësimi do ta mbajmë në oborrin e shkollës ose në sallën e Ed. fizike (varësisht nga kushtet atmosferike). Nxënësit marrin me vete vetëm librat, një laps dhe gomë. Fillimisht vizaton një bosht numerik në çimento dhe më pas i vendos etiketat me numrat 1-20, së bashku me nxënësit. Mësuesi/ja vendos lodrën në një numër në boshtin numerik (18) dhe kërkon nga një nxënës që të numërojë në rendin zbritës me nga një prej numrit të dhënë (18, 17, 16, 15, 15, 13...). Më pas hedh lodrën në një numër tjetër (14), si dhe kërkon nga një nxënës të numërojë në rendin zbritës me nga dy (12,10,8,6...).	
Hapi 2	
Mësuesi/ja thotë një numër dhe kërkon nga një nxënës/të vazhdoj të numërojë në rendin zbritës nga 20. Për shembull, numri 16 (15, 14, 13, 12...). Më pas përsëritet veprimtaria me një numër tjetër, për shembull 12 dhe i kërkohet një nxënës/nxënese të numërojë në rendin zbritës me nga dy (10, 8, 6, 4...). Përsëritet veprimtaria edhe me numra tjerë.	

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë boshtet numerike dhe detyra e nxënësve është të vazhdojnë me numrat tjerë sipas rregullës së vënë. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte dhe në grup. Gjatë punës nxënësit mund të afrohen te boshti numerik dhe të kërcejnë me lodër sa numra kërcen lepurit në detyrat e tekstit.

Hapi 4

Mësuesi/ja vizaton një shirit me shkumësa me ngjyra. Nxënësit do të kërcejnë në shirit sipas udhëzimit të shokut/shoqes. Pas disa kërcimeve nxënësit ndërrojnë rolet. U shpjegohet nxënësve se loja në ajrin e pastër është shumë e mirë për ne, na pastron trupin dhe na kthjell mendjen.




VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së numrave në boshtin numerik; vazhdimin të numërimit sipas kërkesave të dhëna; kërcimit në shiritin e numrave në rendin zbritës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë / Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: I / Klasa: I	
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënit të temës: Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3); Mendimtar kreativ II (1,2,7); Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); Kontribuues produktiv IV (2,5); Individ i shëndoshë V (2,5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 4.15 Numërimi deri në 20	
Fjalët kyçe: boshti numerik, shirit me numra 1-20, kërcim, rend rritës, rend zbritës, hiq, shto.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen numrat 1-20 në boshtin numerik dhe vazhdon numërimin në rendin rritës dhe zbritës sipas kërkesës; - gjen 2 më shumë ose 2 më pak se një numër deri në 20 duke pasqyruar kërcimet në një bosht numerik; - eksploron problema dhe gjëgjëza numerike. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej numrat 1-20 në boshtin numerik dhe vazhdo numërimin në rendin zbritës sipas kërkesës; - gjej 2 më shumë ose 2 më pak se një numër deri në 20 duke pasqyruar kërcimet në një bosht numerik; - eksploro problema dhe gjëgjëza numerike. 	
Burimet: libri dhe fletore pune “Matematika 1”, gjëgjëza.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkumësa të trashë me ngjyra, shiriti i numrave 1-20.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komentimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti (kërcimi në shiritin e numrave).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Mësuesi/ja vizaton një bosht të madh numerik në dysheme (ose vendos “Shiritin me numra 1-20, nëse klasa është me tapet). Me ndihmën e disa nxënësve shënon numrat. Ngre disa nxënës të cilët bëjnë kërcime në bosht duke kërkuar nga nxënësit tjerë të zbulojnë rregullën (kërcejnë duke shtuar nga një, duke hequr nga një, duke shtuar nga dy etj.).	
	

Hapi 2

Mësuesi/ja thotë një numër dhe kërkon nga një nxënësi/nxënëse të vazhdoj të numërojë në rendin rritës apo zbritës për shembull, numri 16; i kërkohet një nxënësi/nxënëse të numërojë në rendin rritës (17, 18, 19, 20). Më pas përsëritet veprimtaria me një numër tjetër për shembull 12 dhe i kërkohet një nxënësi/nxënëse të numërojë rendin zbritës me nga dy (10, 8, 6, 4...). Përsëritet veprimtaria edhe me numra tjerë.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë boshtet numerike në figurën e parë. Nxiten nxënësit të përdorin fjalët “hiq” dhe “shto”. Në detyrat në vijim, nxënësit do të plotësojnë boshtet numerike duke u bazuar në numrat e dhënë për rendin rritës apo zbritës. Nxënësit do të punojnë individualisht e më pas do të diskutojnë në çifte dhe në grup. Gjatë punës, nxënësit mund të afrohen te boshti numerik i vizatuar në dysheme ose “Shiriti me numra” nëse është klasa me tapet) dhe të kërcejnë me numrat e kërkuar në detyrat e tekstit.

Hapi 4

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive për numërimin 0-20 dhe anasjelltas si dhe duke lëvizur me nga 2,3 duke u ndihmuar nga tabela e numrave 1-20. Tregohet një situatë problemore gjëgjëzë, të cilës ia kemi ndërruar numrat në 3,6,9 që të jetë risi për nxënësit.

Nëpër shkallë hipa dhe në kat të tretë ndalova,
mora ashensorin e te kati 6 shkova, hipa
përsëri me këmbë tri kate dhe u lodha,
mund të më thoni ku ndalova. (9)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së vendosjes së numrave në boshtin numerik.

Vazhdimi i numërimit sipas kërkesave të dhëna.

Kërcimi në shiritin e numrave në rendin rritës dhe zbritës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

TEMA 5: MËSOJMË MË SHUMË PËR NUMRAT

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon numrat çift dhe tek nga 1 deri në 20.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 5.1 Çift dhe tek			
Fjalët kyçe: Çift, dyshe, tek, shifër.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore			
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - emërton numrin çift si një numër që ndahet në dy grupe të barabarta; - emërton numrin tek si një numër që, kur ndahet në dy grupe të barabarta, mbetet gjithmonë 1; - dallon numrin tek nga ai çift në një grup numrash të dhënë; - krijon ilustrime dhe punime me grupin, për numrat tek dhe çift. 			
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> - emërto numrat çift dhe tek, duke ndarë objektet me shokun/shoqen; - plotëso detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar te kërkesat; - bashkëpunoj me grupin për krijimin e punimit për numrat çift dhe tek. 			
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: objekte të ndryshme numërimi, letra me ngjyra, pjata plastike apo kartuq në formë rrethi, ngjitës letre, gërrshërë, etiketa me numrat 1-10, fleta e mëdha të formatit A/1.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Shkathësi për jetë (punimi i mjetit për numrat çift dhe tek).			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1			
Çdo dyshe ka mbi tavolinë objekte të ndryshme numërimi, kube, pipa, lapsa, fasule etj. Udhëzohen nxënësit që ndajnë në dy pjesë të barabarta grupe të ndryshme objektesh.			
<ul style="list-style-type: none"> • Çfarë vini re? • A mund të ndani në dy pjesë të barabarta të gjithë numrat? 			
Hapi 2			
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të bëjnë një grup me 4 kube/objekte dhe një grup me 9 kube/objekte. Ata çiftojnë një me një kubet/objektet e çdo grupi për të gjetur nëse numrat janë çift apo tek.			

Mësuesi/j a u thotë nxënësve se, nëse një kub ka një shok, ai është çift. Nëse kubi nuk ka një shok, ai është tek.

Nxënësit përziejnë kubet, bashkojnë duart dhe i mbushin me kube. Pastaj i ndajnë në dyshe që të zbulojnë nëse kanë pasur në duar numër çift apo tek kubesh. Nxënësit numërojnë dhe shënojnë numrin në fletore Përsëritet ushtrimi gjashtë herë. Diskutohet me nxënësit atë që kanë zbuluar dhe a kanë vënë re ndonjë rregullsi. Arrihet në përfundimin se që të gjithë numrat janë ose tek ose çift.

Numrat çift kanë “shokë”, numrat tek nuk kanë.

Hapi 3

Nxënësit vëzhgojnë figurat dhe mësuesi/ja zhvillon një diskutim se në pjesën e parë të figurës qenkan dy çifte dhe askush nuk qenka pa shok/shoqe kurse në pjesën e dytë qenkan dy çifte por edhe një vajzë, e cila paska ngelur e vetmuar, domethënë qenka tek. Nxënësit vazhdojnë me detyrat e tekstit, ku do të identifikojnë numrat çift dhe tek dhe do të vizatojnë bashkësi objektësh me numra çift dhe tek. Ata i shkëmbejnë punët/detyrat me njëri-tjetrit dhe e krahasojnë detyrën e shokut/shoqes, me listën e kriterëve të paraqitura për të gjithë nxënësit. Nxënësi-kontrollues duhet të sigurohet se janë përfshirë elementet themelore në punën e shokut/shoqes. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi – autori i përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij. (Kontrolli para fluturimit).

Hapi 4

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve nëpër grupe materialet e nevojshme për punimin e numrave 1-10 me duar, ku do të ndajnë numrat çift dhe tek. Varësisht nga numri i grupeve në klasë, mësuesi/ja do të shpërndajë punën. Materialet e nevojshme janë: letrat me ngjyra, pjata plastike apo kartuq në formë rrethi, ngjitës letre, gërhërë, etiketa me numrat 1-10, fleta e mëdha të formatit A/1. Pasi është klasë e parë, mësuesi/ja mund të përgatitë (presë format e duarve paraprakisht). Pas përfundimit, mjeti do të vendoset në një kënd të klasës dhe do t'i referohemi gjithmonë për numrat çift dhe tek. Mund të vazhdohet edhe me numrat 11-20, vetëm se shtohet numri i duarve.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Kontrolli para fluturimit”- nxënësit do të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit para dorëzimit te mësuesi/ja.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: I Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënësve të temës: Identifikon numrat çift dhe tek nga 1 deri në 20.
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 5.2 Çift dhe tek	
Fjalët kyçe: Çift, dyshe, tek, shifër.	
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - emërton numrin çift, si një numër që ndahet në dy grupe të barabarta; - emërton numrin tek si një numër që, kur ndahet në dy grupe të barabarta, mbetet gjithmonë 1; - dallon numrin tek nga ai çift në një grup numrash të dhënë; - krijon ilustrime dhe punime me grupin për numrat tek dhe çift. 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - emërto numrin çift, si një numër që ndahet në dy grupe të barabarta; - emërto numrin tek si një numër që, kur ndahet në dy grupe të barabarta, mbetet gjithmonë 1; - krijo situata me ilustrime numrash tek dhe çift; - luaj lojërat duke respektuar rregullat e caktuara paraprakisht. 	
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”, gjëgjëza.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: top i kuq dhe top blu, zar, bosht numerik.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatim e ngjyrosje).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1 Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në dyshe të luajnë një lojë shumë të njohur për fëmijë: “Tek apo çift”. Nxënësit duhet të fshehin duart mbrapa. Njëri zgjedh tekun dhe tjetrin çiftin. Ata duhet t’i nxjerrin duart në të njëjtën kohë. Numërojnë sa gishta kanë nxjerrë dhe nëse është numër çift, fiton ai që kishte zgjedhur numrin çift. Nëse është numër tek, fiton ai që kishte zgjedhur numrin tek. Përsëritet loja disa herë.	
Hapi 2 Lojë me top. Mësuesi/ja ka dy topa, një të kuq dhe një blu. Nëse nxënësit i hidhet topi i kuq, duhet të thotë një numër çift, nëse i hidhet topi blu duhet të thotë një numër tek. Përsëritet loja derisa çdo nxënës, të ketë prituri të paktën një herë topin.	

Hapi 3

Nxënësit vëzhgojnë figurën në tekst dhe duke filluar nga numri 1-10, i qarkojnë numrat që janë çift dhe numrat që janë tek. Më pas, në detyrat në vijim, shkruan numrat tek deri në 10 (1, 3, 5, 7, 9) dhe numrat çift deri në 10 (2, 4, 6, 8, 10). Në fletën e dytë nxënësit do të gjejnë numrat çift dhe tek të numrave deri në 20, sipas kërkesës së detyrave. Nxënësit e shkëmbejnë punën/detyrën me njëri-tjetrin dhe ata e krahasojnë detyrën e shokut/shoqes me listën e kritereve të paraqitura për të gjithë nxënësit. Nxënësi-kontrollues duhet të sigurohet se janë përfshirë elementet themelore në punën e shokut/shoqes. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi – autori përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij. (Kontrolli para fluturimit)

Hapi 4

Brenda dyshes, nxënësit vendosin se kush është personi “tek” dhe kush është personi “çift”. Çdo lojtar hedh zarin dhe numrat e hedhur mblidhen. Nëse përgjigja është numër tek, lojtari tek merr një pikë. Nëse përgjigja është numër çift, lojtari çift merr një pikë. Fitues është lojtari që merr i pari 5 pikë.

Hapi 5

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive për numrat çift me anë të gjëgjësës. Nxënësit provojnë të gjejnë zgjidhjen me shpejtësi dhe më pas zbulojnë se në gjëgjësë po përmenden vetëm numra çift.

Nëpër shkallë hipa dhe në kat të dytë ndalova, mora ashensorin e tek kati 4 shkova, hipa përsëri me këmbë dy kate dhe u lodha , mund të më thoni ku ndalova . (6)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Kontrolli para fluturimit”- nxënësit do të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit para dorëzimit te mësuesi/ja. *Përgjigjet e nxënësve për zgjidhjen e gjëgjësës.*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: I / Klasa: I	
Tema: Bashkësitë dhe relacionet	Rezultati i të nxënësve të temës: Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet; më shumë, më pak, aq sa;
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (2, 4,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1,3; 3.3,4,5,6; 5.1; 6.1,2.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 5.3 Vlerësimi me sy	
Fjalët kyçe: me përaftrim, me numërim, më shumë, më pak.	
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjen me përaftrim numrin e disa sendeve deri në 20, që më pas mund të verifikohet nëpërmjet numërimit; - zgjidh situata numërimi, duke përdorur relacionet: “më shumë”, “më pak”; - eksploron problema dhe gjëgjëza numerike. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - gjej me përaftrim numrin sendeve dhe më pas, ky numër, verifikohet nëpërmjet numërimit; - zgjidh situata numërimi duke përdorur relacionet “më shumë”, “më pak”; - eksploro problema dhe gjëgjëza numerike. 	
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”, gjëgjëza.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube, kopsa, lapsa për numërim, enë të tejdukshme për numëruarit (tre për çdo grup), letra ngjitëse.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komentimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja), Shoqëria dhe mjedisi (respektimi i rregullave gjatë lojës).	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Përsëritja e renditjes me nga 1, 2, 5 të numrave 1-20 dhe anasjellas, si dhe zgjidhja e problemës gjëgjëzë:	
<div style="border: 1px solid #ADD8E6; border-radius: 15px; padding: 10px; width: fit-content; margin: 0 auto;"> <p>Mami bleu dy lëpirëse, dy karamelle dhe dy kinder surpriza për fëmijët? Sa ëmbëlsira bleu mami?</p> </div>	
Hapi 2	
Merret një grusht kubesh/kopsash/fasulesh. Tregohen përpara klasës dhe u kërkohet nxënësve të thonë: “Ka më shumë se... kube. Ka më pak se... kube”. U kërkohet disa nxënësve që të thonë atë për të cilën ata janë të sigurt. Numërohen dhe shihen nëse ata kanë të drejtë. Nxënësit punojnë në dyshe. Ata marrin disa kube... secili dhe përsërisin veprimtarinë.	

Hapi 3

Nëpërmjet këtij ushtrimi, nxënësit duhet të përdorin frazat: “më shumë se” dhe “më pak se”, për të marrë një kuptim fillestar të ndryshesës. Vendoset një kuti me kube/lapsa në dysheme dhe u kërkohet nxënësve që të marrin me mend sa kube të kuqe janë. Shkruhet numri në tabelë. Përsëritet veprimi për kubet blu. Zgjidhen dy nxënës që të numërojnë kubet e çdo ngjyre. Shkruhet shuma e vërtetë pranë asaj të gjetur me përafrim. Diskutohet nëse hamendësimet ishin të përafërta me vlerën reale. Në fund të ushtrimit, pyeten nxënësit se si e gjetën me përafrim. Për shembull, i morën me mend të gjitha apo numëruan disa prej kubeve dhe gjetën me përafrim numrin e pjesës tjetër të kubeve?

Hapi 4

Nxënësit hapin librat dhe fillojnë të zgjidhin detyrat e tekstit. Fillimisht hamendësojnë se sa topa të basketbollit janë në foto e më pas i numërojnë. Pas numërimit, gjejnë sa më shumë apo më pak kanë menduar. Do të vazhdojnë ushtrime të njëjta me kube, kokrra fasule e plastelinë. Përsëritin veprimtaritë disa herë, me sasi të ndryshme gjësendesh. Nxënësit punojnë individualisht, por gjatë gjithë kohës, e diskutojnë punën e bërë në çift dhe në grup. Nëse kanë nevojë për ndonjë qartësim të aktivitetit, nxënësit udhëzohen të përdorin kartat e semaforit.

Hapi 5

Vendosen disa numërues në tavolinë apo në dysheme. Duam t'i largojmë këta numërues. Sa mendoni se janë? Rreth 10? Më shumë se 10? Mund të jenë 20? U kërkohet nxënësve që të shkruajnë numrat e tyre në një etiketë dhe ta ngjitin atë në tabelë. Numërohen numëruesit dhe, ndërsa numërohen vendosen mënjanë. Ndërsa numërohen, mund të pyeten nxënësit nëse dëshirojnë që ta ndryshojnë numrin që shkruan. Nëse po, PSE?



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Përdorimi i ngjyrave të semaforit.

Hamendësimi dhe vendosja e numrave të saktë në bazë të kërkesës.

Komunikimi me shokun/shoqen gjatë lojës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		Rezultati i të nxëniet të temës: Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet: “më shumë”, “më pak”, “aq sa”.	
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (2, 4,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1, 3; 3.3, 4, 5, 6; 5.1; 6.1, 2.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 5.4 Vlerësimi me sy
Fjalët kyçe: marr me mend sa janë, gjej me përaftrim, afërsisht, rreth, pothuajse aq, pothuajse njësoj, pak mbi, pak nën, tepër, shumë pak.
<p>Rezultati/et e të nxëniet për orë mësimore</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen me përaftrim numrin e disa sendeve deri në 20, që më pas mund të verifikohet nëpërmjet numërimit; - zgjidh situata numërimi duke përdorur relacionet: “më shumë”, “më pak”; - përcakton numrin e saktë, duke kryer numërimin; - eksploron problema edhe gjëgjëza numerike. <p>Kriteret e suksesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjej me përaftrim numrin sendeve dhe më pas, ky numër verifikohet nëpërmjet numërimit; - parashiko një numër të përafërt mbi sasinë e vërtetë të një grupi të dhënë; - përcakto numrin e saktë, duke kryer numërimin; - eksploro problema dhe gjëgjëza numerike.
<p>Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografi ose figura të sendeve për vlerësim, etiketa ngjitëse, letra me numra për punë në dyshe, kavanoz me fasule (deri në 50 kokrra) dhe një kaush për punën në klasë, tre kavanoza të tejdukshëm me sende të ndryshme (p.sh: automobila lodër, toptha leshi ose laps, figura/fotografi /copa letre mbështjellëse që tregojnë sende që mund të numërohen.</p> <p>Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komentimi gjatë aktiviteteve), Shkathtësi për jetë (drithëra të ndryshme dhe kokrra fasule në kavanoz).</p> <p>Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</p>

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. U paraqitet një fotografi e një tufe me lule dhe u kërkohet të gjejnë sa janë pa u numëruar. Shkruhet numri në dërrasë. Më pas kalohet në numërimin e tyre dhe bëhet krahasimi i numrave.

Përsëritet veprimtaria me fotografi ose figura të sendeve të ndryshme dhe u kërkohet nxënësve që të marrin me mend numrin e tyre. Ashtu si në mësimin e fundit, nxënësit duhet të përdorin frazat: “ka më shumë se...” dhe “ka më pak se...”.

Hapi 2

Vendoset përpara klasës kavanozi me fasule. U kërkohet nxënësve që të përdorin frazat: “më shumë se”, “më pak se” për të marrë me mend numrin e kokrrave. Diskutohen përgjigjet kur është e përshtatshme ta gjejmë me përafrim (sa fasule ka në një kavanoz) dhe kur nuk është e përshtatshme (gjatë peshimit të ilaçeve). Kthehet veprimtaria të kavanozi me fasule. Merret një kaush me fasule dhe numërohen 20 kokrra. Bëhen pyetje, të tilla si: Përafërsisht, sa kaushë të tjerë me fasule janë në kavanoz? Vazhdohet me numërim me sasi, që ka deri në 20 kokrra.

Hapi 3

Nxënësit hapin librat dhe fillojnë të zgjidhin detyrën e tekstit. Fillimisht, hamendësojnë rreth numrit të objekteve dhe nxënësve që gjenden në klasë dhe plotësojnë kolonën “Mendoj se janë...” të tabelës. Më pas numërojnë gjësendet dhe nxënësit e paraqitur në fotografi dhe plotësojnë kolonën “Gjej me numërim” të tabelës.

Nxënësit punojnë individualisht, por gjatë gjithë kohës e diskutojnë punën e bërë në çifte dhe në grup. Nëse kanë nevojë për ndonjë qartësim të aktivitetit, nxënësit udhëzohen të përdorin kartat e semaforit.

Hapi 4

Mësuesi/ja vendos në mes të klasës një enë me lodra, në katër forma të ndryshme. Fillimisht, nxënësit do të gjejnë me përafrim se sa janë nga secila formë dhe do të shkruajnë numrat në etiketa ngjitëse dhe më pas do të ndajnë secilën formë në qesen prej letre të përgatitur më parë. Pas ndarjes, do të shkruajnë në etiketa ngjitëse numrin e dalë të secilës formë dhe do të ngjitin afër numrave që gjetën me përafrim. Vazhdohet procedura e pyetjeve si në aktivitetet paraprake.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Përdorimi i ngjyrave të semaforit.

Përafrimi dhe vendosja e numrave të saktë në bazë të kërkesës.

Komunikimi me shokun/shoqen gjatë aktiviteteve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë
	Shkalla e kurrikulës: I
	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënit të temës: Përcakton radhën (numrat rendorë).
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 5.5 Numrat rendorë	
Fjalët kyçe: numër rendor, vendndodhje, ndodhet para, pas.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> - emërton objekte të vendosura në radhë, njëri pas tjetrit, me numra rendorë; - dallon vendndodhjen e objekteve, duke përdorur numra rendorë; - përdor numrat rendorë në situata praktike. 	
Kriteret e suksesit:	
<ul style="list-style-type: none"> - emërto objekte të vendosura në radhë, njëri pas tjetrit, me numra rendorë; - dallo vendndodhjen e objekteve, duke përdorur numra rendorë; - përdor numrat rendorë në situata praktike. 	
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: letra të mëdha me numra nga 1 në 10, letra të mëdha me numra rendorë (i pari, i dyti, i treti...i dhjeti).	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë fizike, sporte dhe shëndeti (aktivitetet).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Mësuesi/ja nxjerr para klasës disa nxënës dhe i rreshton. Drejton pyetjen:	
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Cili është i pari?</i> • <i>Cila është e treta?</i> • <i>I sati është Joni?</i> • <i>Po Besa, e sata është?</i> 	
Shpjegon se këta janë numra rendorë dhe shërbejnë për të treguar vendndodhjen në një garë, rresht etj.	
Hapi 2	
Vizatohet në tabelë një rresht me 10 shtëpi. Zgjidhet një letër nga 1 në 10 dhe vendoset në shtëpinë e parë. U kërkohet nxënësve që të marrin letrat dhe t'i vendosin ato sipas një radhe çfarëdo mbi shtëpitë e vizatuara. <i>Unë jam postieri. Kam një çantë me letra për të shpërndarë. Letra ime e parë do të shkojë te shtëpia me numrin 1 (ballafaqojeni me numrin e shtëpisë).</i>	

Vazhdon duke shpërndarë edhe pesë letra të tjera.

A është kjo një ide e mirë për postierin? Ai ka shumë rrugë për të bërë. Çfarë mund t'ia lehtësojë punën postierit? (T'i vendosim numrat sipas radhës.)

Ku është numri 1? Hiqeni numrin fillestar të vendosur mbi shtëpinë e parë dhe vendoseni numrin 1 mbi atë shtëpi. Vazhdoni derisa të gjithë numrat të jenë sipas radhës. Numëroni me mua deri në 10: 1, 2, 3, 4...10.

Hapi 3

Hapet libri dhe nxiten nxënësit të vërejnë figurën dhe ta përshkruajnë atë. Ndhmon nxënësit me pyetjet:

- Ç'po bëjnë fëmijët?
- *Cili është i pari?*
- *Po djali me kapelë të kuqe i sati është?*

Në ushtrimin e parë nxënësit do të ngjyrosin topat, varësisht nga pozita që kanë në figurë. Tek ushtrimi i dytë, nxënësit mund të ngjyrosin bluzat, duke u bazuar në pyetjet e tekstit.

Nxënësit e shkëmbejnë punën/detyrën me njëri-tjetrin dhe e krahasojnë detyrën e shokut/shoqes me listën e kriterëve të paraqitura për të gjithë nxënësit. Nxënësi – autori i përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij. (Kontrolli para fluturimit)

Hapi 4

Kjo lojë mund të zhvillohet në palestër ose oborr. Nxënësit pajisen me nga një fletë, në të cilën është shkruar një nga numrat, 1-10 dhe numri rreshtor, i pari, i dyti etj. Ndahet klasa në grupe me nga 10

U jap 10 nxënësve nga një letër me numra nga 1 në 10 dhe kërkoni që ata të vendosen në rresht sipas radhës.

Cili numër duhet të vendoset i pari? (1) Cili numër vjen pas njëshit?

Dyshi është numri i dytë. Vazhdoni derisa të arrini te dhjeta. Tregon që, kur bisedohet për rendin sipas të cilit vendosen numrat, numrat quhen numra rendorë. Përsëritet në korr numrat rendorë: I pari? I dyti? I treti? etj.

Përsëritet veprimtaria në mënyrë që të përfshihen të gjithë nxënësit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Kontrolli para fluturimit”- nxënësit do të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit para dorëzimit te mësuesi/ja. Renditja në rresht sipas radhës gjatë aktiviteteve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Vizato një garë vrapimi ku të rendisësh 10 nga shokët e klasës. Shkruaj numrat rendorë për secilin.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Numrat natyrorë

Rezultati i të nxënimit të temës:

Përcakton radhën (numrat rendorë).

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 5.6 Numrat rendorë

Fjalët kyçe: numër rendor, vendndodhje, ndodhet para, pas.

Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- emërton objekte të vendosura në radhë, njëri pas tjetrit, me numra rendorë;
- dallon vendndodhjen e objekteve, duke përdorur numra rendorë;
- përdor numrat rendorë në situata praktike;
- krijon ilustrime për përrallën e parapëlqyer.

Kriteret e suksesit:

- emërto objekte të vendosura në radhë, njëri pas tjetrit, me numra rendorë;
- dallo vendndodhjen e objekteve, duke përdorur numra rendorë;
- përdor numrat rendorë në situata praktike;
- ilustro përrallën e preferuar dhe rendit ilustrimet.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: letra të mëdha me numra nga 1 në 10, letra të mëdha me numra rendorë (i pari, i dyti, i treti...i dhjeti).

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (ilustrimi i përrallës), Edukatë fizike, sporte dhe shëndeti (pemët e sjella në klasë).

Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për paqe

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Nxënësit janë njoftuar një ditë më parë të marrin nga shtëpitë objekte të ndryshme, si: lodra, fruta.

Udhëzohen që t'i renditin ato sipas dëshirës.

Secili nxënës do të thotë renditjen e objekteve të shokut të bankës, p.sh.:

Molla- e para

Arushi – i dyti

Topi – i treti etj.

Mësuesi/ja përpiqet të angazhojë sa më shumë nxënës. Përsëriten në kor numrat rendorë.

Hapi 2

Zhvillohet një lojë shpejtësie. Mësuesi/ja paraqet etiketën e një numri dhe nxënësit do të thonë **numrin rendor përkatës, p.sh.:**

1 – i pari

2 – i dyti etj.

Zhvillohet edhe veprimtaria e anasjellë, paraqet numrin rendor dhe nxënësit do të thonë numrin themelor. Fiton nxënësi që përgjigjet më shpejt. Mësuesi/ja bën një tabelë ku shënon pikët dhe liston nxënësit sipas radhës së përgjigjeve.

Hapi 3

Hapet libri. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për kryerjen e ushtrimeve. Në detyrën e parë do të ngjyrosin shtëpitë sipas udhëzimeve të dhëna në tekst. Nxënësit do të diskutojnë në **çifte** dhe në grup zgjidhjen e bërë. Nxënësit që kanë nevojë për sqarime, **përdorin kartat e kuqe dhe portokalli të semaforit, kurse ata që kanë përfunduar**, ngrenë kartat e gjelbra. Mësuesi/ja ndihmon individualisht nxënësit që kanë vështirësi në leximin e numrave rendorë.

Hapi 4

Në pjesën e fundit të orës, nxënësit do të ilustronjë një përrallë që u pëlqen, **përmes tri vizatimeve dhe në secilin vizatim do të shkruajnë**: i pari, i dyti, i treti. Më pas, do t'i vendosin librat në bankë **dhe do të zgjedhin punimet më të mira brenda grupeve, duke i mbledhur + që i kanë vënë punimit të pëlqyer.**

Shënim: Për veprimtarinë kryesore, sigurohuni që numrat rendorë të përsëriten gjatë gjithë kohës nga ju dhe nga nxënësit. Përsëritja e çdo numri sa më shpesh që të jetë e mundur, *do t'i ndihmojë nxënësit që t'i shqiptojnë fjalët në mënyrë të saktë*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësojmë emërtimin e objekteve të vendosura në radhë njëri pas tjetrit me numra rendorë.

Përdorimin e numrave rendorë në situata praktike.

Organizimin e veprimtarive zbatimëse për radhitjen e objekteve njëri pas tjetrit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënësve të temës: Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë me shembuj nga jeta e përditshme
------------------------------	---

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 5.7 Gjysma

Fjalët kyçe: gjysmë, gjysmat, e plotë, pjesë.

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- tregon gjysmën e çdo numri çift deri në numrin 10;
- gjen gjysmën e formave me anë të palosjes dhe dallon se cilat forma ndahen përgjysmë;
- krijon forma të ndryshme me plastelinë, duke i ndarë më pas në dy gjysma.

Kriteret e suksesit:

- ngjyros gjysmat e figurave të dhëna në tekst;
- qarko figurat ku është e ngjyrosur gjysma;
- ndaj figurat e dhëna në dy gjysma të barabarta.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: nga një gjysmë molle për çdo nxënës, objekte të ndryshme numërimi, figura, plastelina.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (bashkëbisedimi gjatë aktiviteteve), Njeriu dhe natyra (ushqimet me prejardhje bimore).

Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja u tregon nxënësve një kokërr mollë. Merr dy nxënës.

- Si mund t’u jap të dy nxënësve mollën në mënyrë të barabartë?

Mësuesi/ja ndan mollën në dy pjesë të barabarta.

- Themi që e ndaj përgjysmë.

Hapi 2

Secila bankë ka nga një mollë dhe mësuesi/ja i ndihmon për ta ndarë përgjysmë. Ndërkohë, nxënësit hanë gjysmën e mollës. Nxënës të thonë që secili po ha nga një gjysmë molle.

Kur një objekt e ndajmë në dy pjesë të barabarta, themi që e kemi ndarë përgjysmë.

Kur diçka ndahet përgjysmë, bëhet një (pjesë) që përftohet nga ndarja në dy pjesë të barabarta e së tërës.

Në ndonjë rast, mësuesi/ja nuk e ndan mollën në dy pjesë të barabarta. Pyet nxënësit:

- Mendoni që ndarja është e drejtë?

Që ndarja të quhet e drejtë, pjesët e ndara duhet të kenë të njëjtën madhësi.

Mësuesi/ja i drejton klasës pyetje të tilla:

Unë ndava një mollë në dy pjesë të barabarta.

- *Si quhet çdo pjesë e ndarë? (një gjysmë)*
- *Sa gjysma ka në një portokall? (2)*
- *Sa gjysma ka në dy mollë?(4)*
- *Sa mollë bëjnë dy gjysma? (1)*
- *Sa portokaj bëjnë katër gjysma? (2)*

Hapi 3

Hapen librat. Nxënësit vërejnë figurën ku është e paraqitur një picë e tërë dhe dy gjysma. Diskuton me shokun/shoqen që ka afër rreth gjysmës dhe të tërës. Më pas, vazhdon me ngjyrosjen e figurave sipas udhëzimeve të dhëna në tekst. Në detyrën e dytë, nxënësit do të qarkojnë vetëm figurat e ndara përgjysmë. Pas përfundimit të detyrave, nxënësit do të ndërrojnë librat me shokun/shoqen që ka në bankë dhe kontrollojnë detyrat e njëri- tjetrit. (vlerësimi i ndërsjellë)

Hapi 4

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve figura të ndryshme dhe i udhëzojnë për t'i presin në dy pjesë të barabarta. U shpjegohet nxënësve që me ndarje kuptojmë *se figurat e dhëna ndahen të gjitha përgjysmë. Udhëzohen nxënësit të formojnë njërën nga figurat me plastelinë dhe më pas ta ndajnë përgjysmë.*



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i ndërsjellë, ku nxënësit do të vlerësojnë njëri-tjetrin;
Argumentet e dhëna gjatë diskutimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Numrat natyrorë

Rezultati i të nxënit të temës:

Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë me shembuj nga jeta e përditshme.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 5.8 Çereku

Fjalët kyçe: Çereku, gjysma, çerekët, e plotë, pjesë.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- tregon çerekun e çdo numri çift, deri në numrin 20;
- gjen çerekun e formave me anë të palosjes dhe dallon se cilat forma ndahen në çerek;
- krijon forma të ndryshme me fletë $A/4$, duke e ndarë më pas në katër çerekë.

Kriteret e suksesit:

- ngjyros çerekun e figurave të dhëna në tekst;
- qarko figurat ku është e ngjyrosur çereku;
- ngjyros çerekun e figurës së krijuar gjatë prerjes së fletës $A/4$.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: mollë (nga një çerek për çdo nxënës), objekte të ndryshme numërimi, fletë $A/4$, gërshërë.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (bashkëbisedimi gjatë aktiviteteve), Njeriu dhe natyra (ushqimet me prejardhje bimore).

Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukim për paqe

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja u tregon nxënësve një kokërr mollë. Merr katër nxënës.

- Si mund t’u jap katër nxënësve, mollën në mënyrë të barabartë?

Mësuesi/ja ndan mollën në katër pjesë të barabarta.

- Them i që e ndaj në çerek.

Hapi 2

Secila bankë ka nga një mollë dhe mësuesi/ja i ndihmon për ta ndarë në çerek. Ndërkohë, nxënësit hanë çerekun e mollës. Nxit nxënësit të thonë që secili po ha nga një çerek molle.

Kur një objekt e ndajmë në katër pjesë të barabarta, themi që e kemi ndarë në katër çerekë.

Kur diçka ndahet në çerek, bëhet një (pjesë) që përftohet nga ndarja në katër pjesë të barabarta të së tërës. Në ndonjë rast, mësuesi/ja nuk e ndan mollën në katër pjesë të barabarta. Pyet nxënësit:

- Mendoni që ndarja është e drejtë?

Që ndarja të quhet e drejtë, pjesët e ndara duhet të kenë të njëjtën madhësi.

Mësuesi/ja i drejton klasës pyetje të tilla:

Unë ndava një mollë në katër pjesë të barabarta.

- *Si quhet çdo pjesë e ndarë?* (çerek)
- *Sa çerek ka në një portokall?* (4)
- *Sa çerek ka në dy mollë?*(4)
- *Sa mollë bëjnë dy çerek?* (gjysmë)
- *Sa portokaj bëjnë tetë çerek?* (2)



Hapi 3

Hapen librat. Nxënësit vërejnë figurën ku është e paraqitur një picë e tërë dhe katër çerek. Diskuton me shokun/shoqen që ka afër rreth çerekut dhe të tërës. Më pas, vazhdon me ngjyrosjen e figurave sipas udhëzimeve të dhëna në tekst. Në detyrën e dytë nxënësit do të qarkojnë vetëm figurat ku është ngjyrosur çereku. Pas përfundimit të detyrave, nxënësit do të ndërrojnë librat me shokun/shoqen që ka në bankë dhe i kontrollojnë detyrat njëri-tjetrit. (vlerësimi i ndërsjellë)

Hapi 4

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fleta A/4 të cilat do t'i palosin dy herë. Nxënësit do të vizatojnë një vijë si në figurë dhe më pas do të presin fletën me gërshtë sipas vijës. Nxënësit hapin pjesën e prerë të letrës dhe ngjyrosin vetëm çerekun e figurës. Nëse premtan koha, nxënësit do të përsëritin veprimtarinë, duke prerë një formë tjetër.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i ndërsjellë, ku nxënësit do të vlerësojnë njëri-tjetrin;
Argumentet e dhëna gjatë diskutimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

TEMA 6: MBLEDHJA E NUMRAVE ME SHUMË DERI 20

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: I Klasa: I	
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3; 3.1,2,3,4,5,6; 5.1.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 6.1 Mbledhje me shumë deri në 19	
Fjalët kyçe: mbledhje, mbledhorët, shuma, më shumë.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - paraqet mbledhjen e një numri dyshifror me një numër njëshifror, me shumë deri në numrin 19; - plotëson detyrat e dhëna sipas kërkesës; - lidh mbledhorët dhe shumën me llastik në mjetin e përgatitur. 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - paraqit mbledhjen e një numri dyshifror me një numër njëshifror, me shumë deri në numrin 19; - plotëso detyrat e dhëna sipas kërkesës; - lidh mbledhorët dhe shumën me llastik në mjetin e përgatitur. 	
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube, shufra, fletë A4 me ushtrime, karton i madhësisë së fletës A4, gjilpëra, llastik.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Shkathësi për jetë (kartoni i prerë për aktivitet).	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për paqe	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1	
Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive për numërimin 1-20. Me nxënësit tregohet gjëgjëza:	
<p>Pulat në oborr numërova, ishin 15 të bardha dhe 4 të vogla në kotec zbulova. Kush nga ju më thotë: Sa pula gjithsej numërova?</p>	

Hapi 2

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në grupe, shufra dhe kube. Udhëzohen që të paraqesin mbledhjen e një numri dyshifror me një numër njëshifror, që japin shumën deri në numrin 19. Nxënësit punojnë në dyshe, e më pas paraqesin në fletore me vizatim dhe barazim, punën e bërë.



$$15 + 2 = 17$$

Nxënësit përsëritin veprimtarinë me numra tjerë që japin shumën deri në 19.

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë detyrat e dhëna në tekst dhe i ndan secilit grup nga një detyrë. Nxënësit do të punojnë detyrën në grupe, më pas do të shkruajnë në fletë A3 (secili grup detyrën e vet) dhe një pjesëtar i grupit do të prezantojë punën e bërë. Nxënësit do të plotësojnë të gjitha detyrat gjatë prezantimeve të grupeve.

Hapi 4

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve një fletë për ushtrim si më poshtë, të cilën do ta vendosin në një karton të fortë të madhësisë së fletës. Ata do të vendosin gjilpërat dhe do të lidhin mbledhorët dhe shumën e duhur me llastik. Nxënësit nuk i kanë numrat e njëjtë dhe është mirë të ketë shembuj me 2 dhe 3 mbledhorë. Pas përfundimit, në çifte, nxënësit shkëmbejnë mjetin dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. (Vlerësimi i ndërsjellë).

$12 + 5$	19
$13 + 6$	17
$16 + 2$	16
$15 + 1$	18
$17 + 2$	14
$11 + 3$	19

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Vlerësimi i ndërsjellë” - kontrollimi i detyrave të njëri-tjetrit;
Prezantimi dhe argumentimi i punës së bërë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënit të temës: - përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3; 3.1,2,3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


Njësia mësimore: 6.4 Mbledhja me shumë 20
Fjalët kyçe: mbledhje, mbledhorët, shuma.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - dallon numrat njëshifrorë nga ata dyshifrorë; - mbledh një numër dyshifror me një numër njëshifror, duke mbetur brenda dhjetëshes përkatëse; - paraqet mbledhjen e një numri dyshifror me një numër njëshifror, me kube dhe shufra; Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - mbledh një numër dyshifror me një numër njëshifror, duke mbetur brenda dhjetëshes përkatëse; - paraqit mbledhjen e një numri dyshifror me një numër njëshifror, me kube dhe me shufra; - luaj lojën duke respektuar rregullat e caktuara.
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: daulle, boshti numerik, shufra dhe kube, etiketa me numra 1-20, kartat me ngjyrat e semaforit.
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Shoqëria dhe mjedisi (rregullat e lojës).
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

<p>Hapi 1</p> <p>Përdoret boshti numerik i klasës për të bërë shënime në të. Zgjidhen dy nxënës që të dalin përpara klasës. Kërkoheq që nxënësi i parë t'i bjerë daulles/përplasë duart dhjetë herë dhe të shënojë goditjet në boshtin numerik. Rrethon numrin 10. Kërkoheq që nxënësi i dytë të përplasë lehtësisht dhjetë herë duart, duke shënuar kërcimet në boshtin numerik. Rrethon numrin ku arrihet nga shtimi i vargut me dhjetë njësi (10). Shkruhet në tabelë $10 + 10 = 20$. Përsëritet veprimtaria me numrat 15 dhe 5, 17 me 3 etj., e rëndësishme është që shuma të na dalë 20.</p>

Hapi 2

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në grupe, shufra dhe kube. Udhëzohen që të paraqesin mbledhjen e një numri dyshifror me një numër njëshifror, që japin shumën 20. Do të plotësojnë dhjetëshen e dytë me mbledhjen e njësheve të dy mbledhorëve. Nxënësit punojnë në dyshe, e më pas paraqesin në fletore me vizatim dhe barazim, punën e bërë.



Nxënësit përsëritin veprimtarinë me numra tjerë që japin shumën deri në 20.

Hapi 3

Hapen librat. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vërejnë mbledhjen në shtyllë, theks të veçantë vendos te mbledhja e njësheve së pari, e më pas e dhjetësheve.

$$\begin{array}{r}
 \text{Dh Nj} \\
 1 \\
 16 \\
 + 4 \\
 \hline
 20
 \end{array}$$

Diagram showing the addition of 16 and 4 to get 20. Arrows point from the '1' in 16 to the '1' in 20, and from the '6' in 16 to the '0' in 20. Another arrow points from the '4' in 4 to the '2' in 20.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të zgjidhin detyrat e dhëna në tekst në mënyrë individuale e më pas të diskutojnë në çifte dhe në grup. Gjatë punës, nxënësi do të përdor kartat me ngjyrat e semaforit për të treguar sa është në gjendje të zgjidhë detyrat.

Hapi 4

Udhëzon nxënësit të luajnë në dyshe lojën e paraqitur në detyrën 6. Përsëritet veprimtaria disa herë dhe udhëzohen të ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen në bazë të përdorimit të ngjyrave të semaforit.
Vlerësohet respektimi i rregullave gjatë lojës me etiketat e numrave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I / **Klasa:** I

Tema: Numrat natyrorë

Rezultati i të nxënit të temës:

- kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3; 3.1,2,3,4,5,6; 5.1.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 6.5 Mbledhje me një mbledhor 9

Fjalët kyçe: mbledhorë, shumë, mbledhje, nëntë.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- plotëson dhjetëshen duke ndarë mbledhorin e dytë në shumë të dy mbledhorëve;
- zgjidh detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre;
- luan lojën në dyshe, duke respektuar rregullat e vendosura më parë.

Kriteret e suksesit:

- ndaj mbledhorin e dytë në shumë të dy mbledhorëve për të plotësuar dhjetëshen;
- zgjidh detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre;
- luaj lojën në dyshe, duke respektuar rregullat e vendosura më parë.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”, gjëgjëza.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube, kokrra fasule, kartat me ngjyrat e semaforit, kartat me numrat 1-20.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë orës dhe gjëgjëza), Edukatë figurative (paraqitja me vizatim).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive. Renditen numrat 1-20 dhe anasjellas. Nxënësit zgjidhin gjëgjëzën:

Ani kishte nëntë libra,
Motra e saj katër .
Kush më thotë
Sa libra kanë së bashku dy motrat?

Hapi 2**Mësuesi/ja pyet nxënësit:**

- Si kryhet mbledhja $9 + 3$?

Nxënësit japin përgjigjet e tyre dhe asnjë përgjigje e nxënësve nuk gjykohet. Nga përgjigjet e nxënësve, arrijmë të përfundimin se gjatë mbledhjes, kur mbledhori i parë është 9, së pari plotësojmë dhjetëshen d.m.th. e ndajmë mbledhorin e dytë (në këtë rast në 1 dhe 2).

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vëzhgojnë figurën në tekst. Do të konkretizohet mbledhja me një mbledhor 9, me anë të kubeve apo kokrrave të fasuleve.



$$\begin{array}{r} 1 \quad 2 \\ 9 + 3 = 10 + 2 \\ = 12 \end{array}$$

Nxënësit vazhdojnë të zgjidhin detyrat e dhëna në tekst, në mënyrë individuale. Pas çdo detyre, zhvillojmë një diskutim me anë të pyetjeve. Nxënësit që kanë nevojë për ndihmë, përdorin kartat e kuqe apo portokalli për të kërkuar ndihmë.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të ndahen në dyshe dhe të zhvillojnë së bashku aktivitetin e detyrës 5.

Në mes të bankës vendoset karta me numrin 9. Detyra e nxënësit të parë është të nxjerrë kartën me mbledhorin e parë, kurse nxënësi i dytë do të nxjerrë shumën. Përsëritet veprimtaria disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Përgjigjet e dhëna në zgjidhjet e gjëgjës.

Vlerësimi me shprehje i fletës së tekstit që ka punuar nxënësi individualisht.

Angazhimi gjatë aktivitetit duke respektuar rregullat e caktuara më parë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënit të temës:		
	<ul style="list-style-type: none"> - kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0). 		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3; 3.1,2,3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 6.7 Mbledhje me një mbledhor 8
Fjalët kyçe: mbledhorë, shumë, qarkim, tetë.
<p>Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - plotëson dhjetëshen duke ndarë mbledhorin e dytë në shumë të dy mbledhorëve; - zgjidh detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre; - luan lojën në dyshe duke respektuar rregullat e vendosura më parë. <p>Kriteret e suksesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndaj mbledhorin e dytë në shumë të dy mbledhorëve për të plotësuar dhjetëshen të mbledhja me një mbledhor 8; - zgjidh detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre; - kontrollon detyrat e shokut/shoqes me teknikën “Kontrolli para fluturimit”; - luan lojën në dyshe, duke respektuar rregullat e vendosura më parë.
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube, fije peri dhe etiketa me “+”, etiketa me numrat 1-20.
<p>Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (paraqitja me vizatim dhe ngjyrosja).</p> <p>Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</p>

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

<p>Hapi 1</p> <p>Loja me numërim: Përdorni kubet për numërim. Rregulli është që gjatë numërimit, mund të përdoren vetëm fjalët “1” deri “20”. Në lojë, çdo lojtar shton një kub më shumë në grumbullin e tavolinës. Çdo lojtar thotë me zë emrin e numrit. Sapo kalojnë 10, ata thonë “dhjetë dhe një” (11), “dhjetë” dhe “dy” (12). Kur ata arrijnë te 20, thonë “dy dhjetëshe”.</p> <p>Hapi 2</p> <p>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që me kube, fije peri dhe etiketa me “+” të paraqesin mbledhjen me një mbledhor 8.</p>
--



$$\begin{array}{r} 2 \quad 3 \\ \diagdown \quad / \\ 8 + 5 = 10 + 3 \\ = 13 \end{array}$$

Nxënësit përzgjedhin numra të ndryshëm për të mbledhur me mbledhorin e parë 8 dhe pas aktivitetit, secili nxënës viziton bankat e shokëve/shoqeve për të parë punën e bërë. Nxënësit shkruajnë barazimet e dala nga puna e çifteve, në fletoret e tyre. Barazimeve u bashkohet edhe një përshkrim me fjalë, si p.sh.:

- 8 i shtojmë 2 për të qarkuar 10;
- 10 i shtojmë 3 që mbeten jashtë qarkimit.

Hapi 3

Nxënësit vëzhgojnë figurën në tekst, numërojnë kubet dhe lexojnë barazimin dhe përshkrimin me fjalë. Nxiten të tregojnë me fjalë se barazimi 8 plus 5 arrihet së pari duke plotësuar dhjetëshen (8+ 2) dhe më pas duke mbledhur me 3. Më pas, vazhdojnë me plotësimin e detyrave 1, 2, 3 dhe 4, ku mësuesi/ja lexon kërkesat e detyrave dhe nxënësit punojnë individualisht e më pas, me anë të teknikës “Kontrolli para fluturimit”, kontrollojnë librat e njëri- tjetrit. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi – autori i përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të ndahen në dyshe dhe të zhvillojnë së bashku aktivitetin e paraqitur në detyrën 5. Veprimtaria përsëritet disa herë me numra të ndryshëm.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Kontrollimi i librave të njëri tjetrit me tekniken: “Kontrolli para fluturimit”.

Vlerësimi me shprehje i fletës së tekstit që ka punuar nxënësi individualisht.

Angazhimi gjatë aktivitetit duke respektuar rregullat e caktuara më parë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë		Rezultati i të nxënit të temës: kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20, duke përfshirë edhe numrin 0).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3; 3.1,2,3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 6.9 Mbledhje me një mbledhor 7
Fjalët kyçe: mbledhorë, shumë, qarkim, bosht numerik.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - plotëson dhjetëshen duke ndarë mbledhorin e dytë në shumë të dy mbledhorëve; - zgjidh detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre; - krijon boshtin numerik, rendit e mbledh numrat në të.
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - plotëso dhjetëshen duke ndarë mbledhorin e dytë në shumë të dy mbledhorëve; - zgjidh detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre; - mbledh numrat në boshtin numerik ku njëri mbledhor duhet të jetë 7.
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: boshti numerik, kartat e vogla me numrat 0-20 për bosht, kartat me ngjyrat e semaforit.
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (Vizatimi i boshtit numerik). Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Klasa ndahet në grupe me nga 10. Secili nxënës merr nga një letër me numrat 1-10. Fillon muzika, nxënësit vrapojnë nëpër klasë, sapo ndalon ata duhet të rreshtohen sipas radhës, një herë në rendin rritës dhe një herë në rendin zbritës. Përsëritet loja me të gjithë nxënësit.

Hapi 2

Veprohet me klasën për paraqitjen në boshtin numerik të mbledhjes $7+5 = \underline{\quad}$ dhe bëhen komente rreth saj:

- Si mund të mbledhim më lehtë kur njërin mbledhorë e kemi 7?



- **Çfarë** na duhet të plotësojmë së pari?
- Po numri që mbetet jashtë qarkimit?

Përsëritet veprimtaria edhe me boshte të tjera ose jepen fletë të përgatitura më parë. Gjithsesi, mbledhori i parë duhet të jetë 7 dhe kërkohet paraqitja në fjali numerike.

Hapi 3

Hapen librat. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vëzhgojnë figurën në tekst, ku është e paraqitur mbledhja e numrave 7 dhe 5. Zhvillohet një diskutim rreth qarkimit të numrit 10 dhe barazimit të paraqitur. Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat 1, 2, 3 dhe 4 në mënyrë individuale dhe pas çdo detyre, zhvillohet një diskutim rreth zgjidhjes së bërë. Nxënësit që kanë nevojë për sqarime shtesë, i udhëzojmë të kërkojnë ndihmë me kartat e semaforit.

Hapi 4

Bëhet një veprimtari për 3-4 minuta. Ndërtohet bosht numerik 1-20 me segmente të barabarta, vendosen në të numrat dhe paraqitet një ose dy mbledhje me operatorë. Në fund të punës bëhet komenti për të, si dhe shkruhet fjalia numerike.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Renditja e vargut të numrave në boshtin numerik si një zhvendosje me nga një njësi.
Plotësimi i numrave që mungojnë në boshtin numerik.
Krijimi i boshtit numerik, renditja e mbledhja e numrave në të.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Krijimi i një boshti numerik dhe paraqitja e dy mbledhjeve ku njëri mbledhor është 7.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënësve të temës: - kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).
------------------------------	---

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3; 3.1,2,3,4,5,6; 5.1.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 6.11 Mbledhje me një mbledhor 6

Fjalët kyçe: mbledhje, plotësim i dhjetës, shumë, mbledhorë.

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:

- shpjegon mbledhjen me një mbledhor 6 gjatë aktivitetit me nxënës;
- zgjidh detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre;
- luan lojën në dyshe duke respektuar rregullat e vendosura më parë.

Kriteret e suksesit:

- shpjego si arrihet mbledhja më e lehtë me një mbledhor 6 gjatë aktivitetit me nxënës;
- zgjidh detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar në kërkesat e tyre ;
- luaj lojën në dyshe, duke respektuar rregullat e vendosura më parë.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numrat 1-20 dhe zare.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Shoqëria dhe mjedisi (respektimi i rregullave të lojës dhe mendimeve të njëri-tjetrit).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja nxjerr para klasës 6 nxënës.

- *Sa nxënës janë ngritur para klasës?*

Shkruan numrin në tabelë.

Ngre edhe 5 nxënës të tjerë.

- *Sa nxënës ngritëm?*
- *Sa nxënës u bënë gjithsej?*

Shkruhet barazimi në tabelë.

Përsëritet veprimtari me nxënës të tjerë, por gjithmonë, **së pari duke ftuar 6 nxënës**, e më pas ndryshohet numri. Barazimet shkruhen në tabelë nga nxënësit dhe lexohen me zë të lartë.

Hapi 2

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si mund të mbledhim numrin 6 me një numër tjetër më lehtë?
- Sa i duhen numrit 6 për të plotësuar 10?

Me përgjigjet e nxënësve, arrijmë në përfundim se te mbledhja me një mbledhor 6, na duhet:

- Numrit 6 i shtojmë 4 për të **qarkuar 10**.
- Numrit 10 i shtojmë numrin që mbetet jashtë qarkimit.

Hapi 3

Hapen librat. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vëzhgojnë figurën në tekst ku është e paraqitur mbledhja e numrave 6 dhe 5. Zhvillohet një diskutim rreth qarkimit të numrit 10 dhe barazimit të paraqitur. Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat 1, 2 dhe 3 në mënyrë individuale dhe pas çdo detyre zhvillohet një diskutim rreth zgjidhjes së bërë. Nxënësit që kanë nevojë për sqarime shitesë, i udhëzojmë të kërkojnë ndihmë me kartat e semaforit.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të luajnë lojën e paraqitur në detyrën 4. Ata zhvillojnë veprimtarinë në dyshe. Në mes të bankës vendoset etiketa me numrin 6. Nxënësi i parë gjuan me zare, kurse nxënësi i dytë do të gjejë shumën e numrit gjashtë me numrin që del nga gjuajtja e zareve. Përsëritet veprimtaria disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Argumentet individuale të nxënësve rreth mbledhjes me një mbledhor 6.

Vlerësimi me shprehje për punën e bërë gjatë plotësimit të tekstit.

Angazhimi gjatë aktivitetit, duke respektuar rregullat e caktuara më parë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë		Rezultati i të nxënit të temës: - zbaton vetinë e ndërrimit dhe të shoqërimit për mbledhjen e numrave nga 1 deri në 20.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3; 3.1,2,3,4,5,6; 5.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 6.13 Vetia e ndërrimit e mbledhjes
Fjalët kyçe: mbledhorë, ndërrim i vendeve, shumë, pa ndryshim.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - identifikon numrin e elementeve në grupime që shtohen me një numër të caktuar elementesh të tjerë; - argumenton faktin që ndryshimi i rendit të mbledhjes nuk ndryshon shumën totale; - gjen shumën e dy mbledhorëve duke iu ndërruar vendet.
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - krijo një situatë të thjeshtë problemore me materialet e sjella nga shtëpia; - argumento faktin që ndryshimi i rendit të mbledhjes nuk ndryshon shumën totale; - gjej shumën e dy mbledhorëve duke iu ndërruar vendet.
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: lapsa me ngjyra, etiketa të prera në formë trekëndore dhe rrethore me numrat 1-20, etiketat me numrat 1-20 për lojën e detyrës 4.
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve).
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

<p>Hapi 1</p> <p>Mësuesi/ja merr një tufë me 12 lapsa në dorën e djathtë dhe një tufë me 3 lapsa në dorën e majtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Sa lapsa kam unë në dorë? $12 + 3 = 15$</i> • <i>Po nëse unë i ndërroj vendet? (kalon 12 lapsa në dorën e majtë dhe 3 lapsa në dorën e djathtë).</i> • <i>Sa lapsa do të kem? $3 + 12 = 15$</i> • <i>A ndryshoi shuma?</i> <p>Arrijmë në përfundimin se nëse i ndërrojmë vendet, shuma nuk ndryshon. Nxiten nxënësit të japin shembuj.</p>
--

Hapi 2

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në grupe materialet e nevojshme për aktivitetin e radhës, **të cilat janë: etiketa me numrat 1-20 në formë rrethore dhe fleta me ngjyra të prera në formë trekëndëshi me numrat 1-20** (kaushët e akullores). Nxënësit do të vendosin akulloret mbi kaushë dhe shuma e tyre duhet të jetë sa numri në të (trekëndëshin në formë kaushi). Më pas udhëzohen nxënësit të ndërrojnë vendin e numrave në etiketat rrethore dhe u parashtrijmë pyetjet:

- A ndërroi shuma kur u ndërruat vendet numrave në etiketave rrethore?
- Çfarë mund të vijmë në përfundim?

Kur u ndërrojmë vendet e mbledhorëve, shuma nuk ndryshon.

**Hapi 3**

Nxënësit vëzhgojnë figurën në tekst, numërojnë lapsat me ngjyrë dhe lexojnë barazimin dhe përshkrimin me fjalë. Nxiten të tregojnë me fjalë se kur u ndërrojmë vendet e mbledhorëve, shuma nuk ndryshon. Më pas vazhdojnë me plotësimin e detyrave 1, 2 dhe 3 ku mësuesi/ja lexon kërkesat e detyrave dhe nxënësit punojnë individualisht e më pas me anë të teknikës “Kontrolli para fluturimit”, kontrollojnë librat e njëri-tjetrit. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi – autori i përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të ndahen në dyshe dhe të zhvillojnë së bashku aktivitetin e paraqitur në detyrën 4. Veprimtaria përsëritet disa herë me numra të ndryshëm.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Përgjigjet e dhëna gjatë aktivitetit me lapsa me ngjyra.

Vlerësimi me shprehje për punën e bërë gjatë plotësimit të tekstit.

Angazhimi gjatë aktivitetit, duke respektuar rregullat e caktuara më parë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Numrat natyrorë

Rezultati i të nxënësve të temës:

- zbaton vetinë e ndërrimit dhe të shoqërimit për mbledhjen e numrave nga 1 deri në 20.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3; 3.1,2,3,4,5,6; 5.1.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 6.14 Vetia e shoqërimit e mbledhjes

Fjalët kyçe: mbledhorë, makineri e mbledhjes, shoqërimi, shuma.

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- mbledh numrat e futur në makinën e mbledhjes, duke respektuar rregullin e vënës;
- argumenton faktin që shoqërimi i mbledhorëve nuk ndryshon shumën totale;
- gjen shumën e tre mbledhorëve duke i shoqëruar.

Kriteret e suksesit:

- mbledh numrat e futur në makinën e mbledhjes, duke respektuar rregullin e vënës;
- argumento faktin që shoqërimi i mbledhorëve nuk ndryshon shumën totale;
- gjej shumën e tre mbledhorëve duke i shoqëruar.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”, fleta e ushtrimit.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: makineria e mbledhjes, etiketat me numrat 1-20, zari.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve),

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Si përgatitet akullorja?


Futet qumështi, sheqeri, gjalpi etj., dhe prej andej del akullorja.

Kështu funksionon edhe makina e mbledhjes. Futim një numër, p.sh. te makina + 4, atij numri do t'i shtohet 4 dhe prej andej del shuma. Pra, nëse futim 6 te makina + 4, na del numri 10, pra $6 + 4 = 10$

Zhvillohen disa veprimtari të ngjashme, për të kujtuar se si funksionon makina e mbledhjes.

Në makinën e mbledhjes vendoset rregulla, p.sh. +5, +7 etj.

Hapi 2. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë detyrat e dhëna në tekst, ku do të zbatohet vetia e shoqërimit e mbledhjes.



$$\begin{aligned} 7 + 3 + 2 &= (7 + 3) + 2 \\ &= 10 + 2 \\ &= 12 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} 7 + 3 + 2 &= 7 + (3 + 2) \\ &= 7 + 5 \\ &= 12 \end{aligned}$$

- Së bashku me nxënësit arrihet këto përfundime:
- Së pari grupojmë dy nga mbledhorët.
- Gjejmë shumën brenda kllapave.
- Gjejmë shumën përfundimtare.

Më pas, mësuesi/ja i ndan secilit grup nga një detyrë. Nxënësit do të punojnë detyrën në grupe, më pas do të shkruajnë në fletë A3 (secili grup detyrën e vet) dhe një pjesëtar i grupit do të prezantojë punën e bërë. Nxënësit do të plotësojnë të gjitha detyrat gjatë prezantimeve të grupeve.

Hapi 3

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve një fletë ushtrimi, ku nxënësit do të gjejnë shumën e tre mbledhorëve. Fillimisht nxënësit do të formojnë 10, duke shoqëruar dy nga mbledhorët, e më pas do të mbledhin 10 me mbledhorin e mbetur. Fleta e ushtrimit do të plotësohet individualisht e më pas, nxënësit në dyshe, do të shkëmbejnë fletat dhe do të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. (Vlerësimi i ndërsjellë). Nxënësit që kanë vështirësi do të përkrahen nga mësuesja apo shoku/shoqja gjatë korrigjimit (pa u gjykuar).

1+9=10 2+8=10 3+7=10 4+6=10 5+5=10

4+3+6=13 7+3+6=_____ 5+8+5=_____

2+6+8=_____ 1+9+6=_____ 3+7+2=_____

6+1+4=_____ 9+1+4=_____ 4+3+6=_____

5+3+5=_____ 7+3+2=_____ 8+7+2=_____

4+7+6=_____ 1+9+2=_____ 7+3+2=_____

4+3+6=_____ 8+2+6=_____ 9+1+1=_____

5+5+5=_____ 7+3+9=_____ 4+9+6=_____

Hapi 4

Nxënësit luajnë në dyshe aktivitetin e paraqitur në detyrën 4. Nxënësi i parë hedh zarin 3 herë, kurse nxënësi i dytë mbledh numrat që ranë. Gjatë lojës ndërrohen rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vëzhgohet veprimtaria në makinën e mbledhjes.

Vlerësimi i ndërsjellë gjatë korrigjimit të punës së njëri-tjetrit.

Mbledhja e numrave që rezultojnë gjatë gjuajtjes së zarit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet në Fletore Pune

TEMA 7: GRUPET E BARABARTA

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë		Rezultati i të nxënit të temës: - përdor materiale konkrete për të hetuar shumëzimin dhe pjesëtimin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3; 3.1,2,3,4,5,6; 5.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 7.1 Ndarja në grupe të barabarta			
Fjalët kyçe: ndaj, ndaj në mënyrë të barabartë, nga një secilit, nga dy secilit, nga tre secilit... grup në dyshe, treshe...dhjetëshe, grupe të barabarta.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore			
Nxënësi/ja: - ndan në dy apo më shumë grupe të barabarta një sasi objektesh të dhëna; - zgjedh strategji të përshtatshme për të zbatuar llogaritjet, duke shpjeguar zgjidhjen; - plotëson ushtrimet nga teksti, duke u bazuar në kërkesat e dhëna.			
Kriteret e suksesit: - ndaj në dy apo më shumë grupe të barabarta një sasi objektesh të dhëna; - plotëso ushtrimet nga teksti, duke u bazuar në kërkesat e dhëna.			
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube, çantë e vogël, objekte të ndryshme numërimi, fletë ushtrimesh të përgatitura.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Shoqëria dhe mjedisi (respektimi i rregullave).			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1			
Mësuesi/ja vendos shtatë kube (ose objekte të tjera numërimi) në një çantë. U kërkon dy nxënësve që të dalin përpara klasës. U jepet detyrë të ndajnë kubet, në mënyrë që ata të kenë të njëjtin numër secili, por që ndonjë kub mund të ketë mbetur në çantë. Nuk u tregon nxënësve se sa kube janë në çantë.			
Nxënësit duhet të zgjidhin problemën:			
<ul style="list-style-type: none"> • Sa kube mund të jenë në çantë? • Sa kube mori secili në mënyrë të barabartë? • Sa kube mbetën në çantë? 			
Përsëritet veprimtaria për tre nxënës. Çdo nxënës merr një numër të barabartë kubesh dhe sheh se në fund ka mbetur një kub mënjane.			

- Sa kube ishin në çantë? (7)
- Sa kube mori secili?
- Sa kube mbetën pa u shpërndarë?

Jepini klasës pak minuta kohë për të punuar me shokët e tyre dhe për të menduar se si mund të zgjidhet problema.

- Sa nxënës ishin gjithsej, kur ndanë kubet herën e parë? (2)
- Sa nxënës ishin gjithsej, kur ndanë kubet herën e dytë? (3)
- Cili mund të jetë numri më i vogël i kubeve?

Hapi 2

Nxënësit punojnë në dyshe për ndarjen e objekteve në pjesë të barabarta. Ata do të krijojnë grupe të ndryshme me nga...elemente.

Përdorin shprehjet.

Unë ndava në pjesë të barabarta 6 kube në 3 grupe me nga 2 kube secili grup.

Unë ndava në pjesë të barabarta 9 kube në 4 grupe me nga 2 kube secili grup dhe teproi 1 kub.

Hapi 3

Hapen librat. Mësuesi/ja nxit nxënësit të ndajnë 8 qershi në 2 grupe të barabarta (2 fëmijëve), më pas në 3 grupe (3 fëmijëve). Vërtetojnë që në rastin e dytë mbeten 2 qershi.

Nxënësit vazhdojnë të plotësojnë detyrat tjera në tekst në mënyrë individuale, ku do të bëjnë ndarjen e gjësendeve varësisht nga kërkesat e detyrave. Më pas do të diskutojnë në çifte, duke i ndërruar librat për të kontrolluar punën e njëri-tjetrit. (Vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 4

Mësuesi/ja mund të shpërndajë disa fletë me ushtrime për të kontrolluar nivelin e përvetësimit të njohurive për shumëzimin si grupime dhe rreshtim i objekteve dhe pjesëtimin si ndarje në pjesë të barabarta.

Ushtrimi 1:

Një zog ka ____ krahë.

Sa krahë kanë 4 zogj? ____ + ____ + ____ + ____ = ____



Ushtrimi 2:

Ani ka 10 mollë. Ai do t'ua ndajë në pjesë të barabarta 5 shokëve.

Sa mollë do të marrë secili? ____ + ____ + ____ + ____ + ____ = ____



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen argumentet individuale të nxënësve rreth mënyrës së ndarjes së gjësendeve në grupe të barabarta. "Vlerësimi i ndërsjellë" - kontrollimi i detyrave të njëri-tjetrit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Numrat natyrorë

Rezultati i të nxënësve të temës:

- përdor materiale konkrete për të hetuar shumëzimin dhe pjesëtimin.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3; 3.1,2,3,4,5,6; 5.1.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 7.4 Mbledhim grupe të barabarta

Fjalët kyçe: rreshtim, shumëzim, grupe me nga, mbledhje.

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- ndan në dy grupe të barabarta një sasi objektesh të dhënë;
- zgjedh strategji të përshtatshme për të kryer llogaritjet, duke shpjeguar si ka vepruar;
- rreshton objekte në rreshta dhe në shtylla;
- gjen numrin e elementeve në një rreshtim.

Kriteret e suksesit:

- ndaj në dy grupe të barabarta sasinë e objekteve të dhëna;
- rreshtoj objekte në rreshta dhe shtylla;
- gjej numrin e elementeve në një rreshtim me mbledhje të njëpasnjëshme dhe shumëzim.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kuti e vezëve, materiale ricikluese për të demonstruar rreshtimet.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (përdorimi i shprehjeve adekuate për shumëzimin), Edukatë figurative (vizatimi i rreshtimeve me gjësende të ndryshme).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja u tregon nxënësve kutinë e vezëve dhe pyet se çfarë shohin në të. Nxënësi nxënësit që të përdorin terma, të tillë, si: “rreshta”, “kolona”, “grupe” “grupe me nga”. Mësuesi/ja bën pyetje të tilla, si:

- Sa janë në çdo rresht?
- Sa rreshta me nga 2 mund të shihni? (5)

Shkruan fjalinë numerike, që tregon këtë $(2 + 2 + 2 + 2 + 2)$ dhe vizaton rreshtimin.

Kthen kutinë e vezëve në mënyrë që ajo të tregojë 2 rreshta me nga 5. Përsërit pyetjen.

Pyet nxënësit se çfarë vënë re te këto dy fjali numerike dhe te rreshtimi.





Hapi 2

Mësuesi/ja kujdeset që çdo nxënës të ketë fletë me kuti me qëllim përshtatjen e problemave të shumzimit me figura drejtkëndore.

Përdoren letra me ndarje katërkëndëshe dhe të ngjyrosura, për shembull, me 3×4 për të treguar 3 grupe me nga 4. Nxënësit ngjyrosin 3 rreshta me 4 katrorë në secilin rresht ($4 + 4 + 4$).

Për të treguar 4×3 (4 grupe me nga 3), ngjyrosni 4 rreshta me 3 katrorë për çdo rresht ($3 + 3 + 3$).

Nxënësit mund të krahasojnë këta dy katërkëndësha dhe të shikojnë se, në të dyja rastet, janë ngjyrosur 12 katrorë, por njëri katërkëndësh ngjason me tjetrin nëse rrotullohet me 90 gradë.

**Hapi 3**

Hapen librat. Mësuesi/ja orienton nxënësit për mënyrën se si duhet të punojnë dhe plotësojnë ushtrimet.

Përdoret shprehja: *...grupe me nga...*

Nxënësit punojnë të pavarur për plotësimin e ushtrimeve.

Bëhet kontrolli individual dhe vlerësimi. Nxënësit mund të krahasojnë përfundimet me njëri-tjetrin.

Hapi 4

Zhvillohen veprimtari të ndryshme rreshtimi. Nxënësit mund të vizatojnë në fletore rreshtime të ndryshme dhe shkruajnë barazimet.

Hapi 5

Në **dyshe**, nxënësit realizojnë aktivitetin e paraqitur në detyrën 4.

Shënime: Lidhni grupet me shumzimin, në mënyrë që nxënësit të mund të shohin një lidhje të qartë midis grupimit dhe shumzimit. Kërkojuni nxënësve që të punojnë në dyshe për të ndërtuar, vizatuar dhe shkruar rreshtime.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet plotësimi i ushtrimeve në mënyrë individuale.

Shkrimi i fjalisë numerike dhe vizatimi i rreshtimit.

Realizimi i aktivitetit duke zbatuar rregullat e lojës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR


Punohet rubrika: Tani është radha jote!

TEMA 8: ZBRITJA E NUMRAVE BRENDA 20

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxënësve të temës: <ul style="list-style-type: none"> - argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave nga 1 deri në 20; - zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale). 		
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1, 3), Mendimtar kreativ II (1, 2, 7), Nxënës i suksesshëm III (1, 2, 3, 4, 6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1. 8.1,2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 8.1 Zbritje në dhjetëshen e dytë			
Fjalët kyçe: zbritja, mbledhja, problema, veprim i kundërt.			
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - kryen zbritjen si veprim i kundërt i mbledhjes; - përdor situatat me fjalë dhe me figura për të kuptuar zbritjen; - kryen zbritjen e numrave me heqje të elementeve duke u ndihmuar nga figurat. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - jep opsione për zgjidhjen e gjëgjëzës problemore; - plotëso detyrat e dhëna, duke bashkëpunuar në dyshe dhe në grup; - krijo situata problemore me ilustrime me figura dhe etiketa me numra. 			
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”, gjëgjëza.			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketat me numrat nga 0-10 për secilin nxënës, ilustrime me figura, etiketa me veprime, shufra dhe kube.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (gjëgjëza problemore), Edukatë figurative (paraqitja me vizatim e problemave).			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Bëhet një bisedë e shkurtër për veprimin e zbritjes si veprim i kundërt i mbledhjes. Nxënësve u kërkohet të veprojnë dhe zinxhir për kryerjen e veprimit të zbritjes përmendësh. Njëri thotë numrat e shoku/shoqja e radhës gjen rezultatit e zbritjes, p.sh. $10 - 3 = 7$, $10 - 5 = 5$.			
Hapi 2 Jepet gjëgjëza problemore:			
Me kube, një kala 12-katëshe ndërtova. Kur motrës ia tregova, 2 kate rrëzova. Kush më thotë me sa kate, kalanë e përfundova?			

Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të nxjerrin një shufër dhe 10 kube dhe në dyshe të punojnë zbritjen në rresht dhe në shtyllë. Nxënësit punojnë duke vëzhguar detyrën në libër dhe më pas përsërisin aktivitetin edhe me më shumë kube, deri në 20.



1 Dh 3 Nj

 - 3 Nj

1 Dh 0 Nj

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të punojnë detyrat e dhëna. Secilit grup i ndahet nga një detyrë (nëse janë më shumë se 4 grupe, përgatiten nga mësuesi/ja shembuj të njëjtë si detyra 3 dhe 4, por me numra tjerë). Udhëzohen grupet (heterogjene për nga gjinia dhe niveli i të nxënit) që të shkruajnë detyrën e zgjidhur në fletën A3 dhe një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë. Nxënësit plotësojnë të gjitha detyrat gjatë prezantimeve të grupeve.

Hapi 4

Kërkohet që nxënësit të veprojnë sipas modelit për paraqitjen e zbritjes si veprim i kundërt i mbledhjes. P.sh $7 - 5 = 2$ sepse $2 + 5 = 7$... Më pas ndërrojnë fletoret dhe kontrollojnë detyrat e njëri- tjetrit. (Vlerësimi i ndërsjellë).

Hapi 5

Në dyshe, nxënësit vizatojnë me figura situata me zbritjen dhe bëhen problema e shkruhen fjalitë numerike përkatëse (ose u shpërndajmë ilustrime me figura dhe etiketa me veprime). Bëhet leximi dhe komentimi i tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Punimi i detyrave të dhëna në tekst duke bashkëpunuar në grup dhe respektuar mendimet e njëri- tjetrit. Vlerësimi i ndërsjellë i punimeve të njëri-tjetrit në fletore. Paraqitja e zbritjes si veprim i kundërt i mbledhjes.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë		Rezultati i të nxënit të temës:	
		<ul style="list-style-type: none"> - argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave nga 1 deri në 20; - zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale). 	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).			

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1. 8.1,2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 8.3 Zbritja brenda 13
Fjalët kyçe: zbritja, boshti numerik, problema, ndryshimi.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
<ul style="list-style-type: none"> - zbulon numrat e kërkuar gjatë realizimit të aktiviteteve; - plotëson detyrat në tekst duke u bazuar në kërkesat e dhëna; - përgjigjet për “Pyetjet rrufe” duke bashkëpunuar me shokët/shoqet e grupit.
Kriteret e suksesit:
<ul style="list-style-type: none"> - zbulon numrat e kërkuar gjatë realizimit të aktiviteteve; - plotëso detyrat në tekst duke u bazuar në kërkesat e dhëna; - bashkëpunon me shokët/shoqet e grupit për t’u përgjigjur për “Pyetjet rrufe”.
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”, “Pyetjet rrufe”.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube/libra/fletore, boshti numerik.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatimi i boshtit numerik).
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Në oborrrin e shtëpisë sime ndodhet një mur shumë i lartë. Ndërtoni një kullë me 12 kube/libra/fletore etj. Numëroni kubet.

Imagjinoni sikur ky është muri që ndodhet në oborrrin e shtëpisë. Unë kam qejf që të shikoj përtej murit, por muri

është shumë i lartë. Në mur, janë 12 tulla. Më duhet që të heq 2 tulla nga muri. Hiqen dy kube nga kulla dhe vendosen në tavolinë.

Sa tulla janë tani në mur? Numëroni me mua: 1,2, 3 ... 10.

Mësuesi/ja tregon se si mund të shkruhet kjo: $12 - 2 = 10$. Muri vazhdon të jetë shumë i lartë. Duhet që të hiqet edhe një tullë tjetër. Heq një kub nga kulla. Muri kishte 10 tulla, unë hoqa edhe 1 tullë tjetër. Sa mbetën? Numëroni me mua 1, 2, 3 ... 9. Tregon si mund të shkruhet kjo: $10 - 1 = 9$.

Tani muri është aq i lartë sa më duhet mua.

Hapi 2

Mësuesi/ja vizaton në tabelë një bosht numerik dhe shënon në të 0 dhe 13, por asnjë numër ndërmjet këtyre dy numrave. U kërkon disa nxënësve që të vijnë në tabelë, të shkruajnë në boshtin numerik një numër nistor (në pozicionin e tij të përafërt) dhe të vizatojnë një kërcim mbrapa. Ai shkruan sipër shigjetës sa ka kërcyer dhe pjesa tjetër e klasës duhet të thotë numrin ku duhet të ndalen. Përsëritet ushtrimi disa herë.

Hapi 3

Hapen librat. Mësuesja orienton nxënësit se duhet të plotësojnë ushtrimet e librit.

Tek ushtrimet e tekstit, kryesisht duhet të ndahet zbritësi në dy numra, në mënyrë që numri i parë që zbret, **të na japë ndryshimin 10**. P.sh.

$$\begin{array}{r} 3 \quad 1 \\ \diagdown \quad / \\ 13 - 4 = 13 - 3 - \underline{1} \end{array}$$

Nxënësit përfundojnë të pavarur fletën e detyrave dhe më pas i ndërrojnë librat dhe i kontrollojnë detyrat e njëri- tjetrit.

Hapi 4

Klasa ndahet në tri grupe të mëdha. Mësuesja ka përgatitur nga 6 “Pyetje rrufe” **për secilin grup si p.sh:**

1. Gjej shumën për numrat 9 dhe 4.
2. Vazhdo vargun, me nga 1, me nga 2, me nga 3, deri në 20.
3. Paraqet një varg mungesor dhe nxënësit të gjejnë numrat që mungojnë.
4. Rendit disa objekte në radhë dhe numëroji.
5. Sa dhjetëshe dhe sa njëshe kanë numrat 12, 19,7,10 etj.
6. Krijë një situatë problemore duke përdorur fjalën “më pak” numrat 13 dhe 4.

Pjesëtarët e grupit që përgjigjen në të gjitha pyetjet, në kohën e caktuar, shpallen fitues.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Pjesëmarrja aktive në dy aktivitetet e pjesës hyrëse të orës.

Kontrollim i detyrave të njëri- tjetrit.

Përgjigjet e dhëna për “Pyetjet rrufe”.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR


Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë		Rezultati i të nxënit të temës:	
		<ul style="list-style-type: none"> - argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave nga 1 deri në 20; - zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale) . 	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1. 8.1,2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 8.6 Zbritja brenda 16			
Fjalët kyçe: zbritje, heqje, shenjë, barazim, veprim i kundërt i mbledhjes.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore			
Nxënësi/ja:			
<ul style="list-style-type: none"> - përdor situatat me fjalë dhe me figura për të kuptuar zbritjen; - kryen zbritjen e numrave me heqje të elementeve, duke u mbështetur te figurat; - krijon situata duke zbatuar veprimin e zbritjes. 			
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> - përdor situatat me fjalë dhe me figura për të kuptuar zbritjen; - kryej zbritjen e numrave me heqje të elementeve duke u ndihmuar nga boshti numerik dhe figurat; - krijo situata duke zbatuar veprimin e zbritjes. 			
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketat me numrat nga 0-20 për secilin nxënës, ilustrime me figura, etiketa me veprime, A4, bosht numerik.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (shkrimi i situatave problemore), Edukatë figurative (puna me boshtet numerike).			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1			
Shkruhet në dysheme një bosht numerik dhe paraqiten dy zbritje në të (kujtohet formulimi nisemi nga numri i parë dhe kthehemi mbrapsht aq sa është numërori i dytë). Punohen disa barazime në boshtin numerik.			
Hapi 2			
Paraqitet në dërrasë një fjali numerike dhe një bosht me veprimin e zbritjes dhe nxënësit, të ndarë në grupe, bëjnë krijimin e një situatave problemore. Bëhet argumentimi i tyre dhe vlerësimi ose jepen fletët e fotokopjuara si situata më poshtë:			

1- SITUATA PROBLEMORE.

ANA KA 12 LULE. 3 LULE IA MORI OLA. SA LULE I MBETËN ANËS?

ANËS I MBETËN LULE.

**Hapi 3**

Hapen librat. Në figurën e paraqitur në tekst, nxënësit vrojtojnë paraqitjen e zbritjes me anë të kubeve dhe shufrës. Mësuesi/ja zhvillon një diskutim me nxënës rreth ndarjes së numrit të dytë (zbritësit) në dy numra dhe gjatë diskutimit arrijmë në përfundimin se:

Për të zbritur nga 14 numrin 6, kryejmë dy zbritje njëra pas tjetrës:
në fillim zbresim 4, pastaj zbresim 2.

$$\begin{array}{r} 4 \quad 2 \quad 10 \\ 14 - 6 = 14 - 4 - 2 \\ = 8 \end{array}$$

Më pas udhëzohen nxënësit të plotësojnë detyrat e dhëna në vijim. Nxënësit e shkëmbejnë punën/detyrën me njëri-tjetrit dhe ata e krahasojnë detyrën e shokut/shoqes. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi – autori i përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij. (Kontrolli para fluturimit).

Hapi 4

Në detyrën 3 është përshkruar loja, **të cilën do ta realizojnë nxënësit në dyshe. Përsëritet veprimtaria disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.**

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Kontrolli para fluturimit”- nxënësit do të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit para dorëzimit te mësuesi/ja. Përgjigjet e nxënësve gjatë prezantimit të situatave problemore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë		Rezultati i të nxënësve të temës:	
		<ul style="list-style-type: none"> - argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave nga 1 deri në 20; - zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale) . 	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).			

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1. 8.1,2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 8.9 Zbritja brenda 19
Fjalët kyçe: zbritje, heqje, shenjë, barazim, veprim i kundërt i mbledhjes.
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore
Nxënësi/ja:
<ul style="list-style-type: none"> - përdor situatat me fjalë dhe me figura për të kuptuar zbritjen; - kryen zbritjen e numrave me heqje të elementeve, duke u bazuar te boshti numerik dhe te figurat; - krijon situata duke zbatuar veprimin e zbritjes.
Kriteret e suksesit:
<ul style="list-style-type: none"> - përdor situatat me fjalë dhe me figura për të kuptuar zbritjen; - kryej zbritjen e numrave me heqje të elementeve duke u ndihmuar nga boshti numerik dhe figurat; - krijo situata duke zbatuar veprimin e zbritjes.
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”, ushtrimi në fletë A/4.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkurtesa me ngjyra, etiketat me numrat nga 0-20 për secilin nxënës.
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve).
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesja vizaton një bosht të madh numerik në dysheme. Me ndihmën e disa nxënësve, shënon numrat. Ngre disa nxënës, të cilët bëjnë kërcime në bosht, duke paraqitur këto barazime:

$$13 + 6$$

- *Te cili numër do ta fillosh kërcimin?*
- *Sa hapa do të bësh në fillim?*
- *Nga cili drejtim do të vazhdosh kërcimin?*
- *Po më pas?*
- *Te cili numër përfundon kërcimi?*

$$18 - 9$$

- *Te cili numër do ta fillosh kërcimin?*
- *Nga cili drejtim do të vazhdosh?*
- *Sa hapa do të kërcesh?*
- *Te cili numër përfundon kërcimi?*

Hapi 2


Mësuesi/ja shpërndan fletushka, në të cilat ka paraqitur disa ushtrime për përforsimin e veprimeve në bosh-tin numerik.

Ushtrimi: Paraqit veprimet në bosh-tin numerik.

$$13 + 6 =$$



$$18 - 9 =$$



Bëhet kontrolli individual dhe vlerësimi.

Hapi 3

Hapen librat. Në figurën e paraqitur në tekst, nxënësit vrojtojnë paraqitjen e zbritjes me anë të kubeve dhe shufrës. Mësuesi/ja zhvillon një diskutim me nxënës arrijnë te përfundimi se:

Për të zbritur nga 17 numrin 8, kryejmë dy zbritje njëra pas tjetrës:
në fillim zbresim 7, pastaj zbresim 1

$$\begin{array}{r} 7 \quad 1 \quad 10 \\ \swarrow \quad \searrow \quad \curvearrowright \\ 17 - 8 = 17 - 7 - 1 \\ \quad \quad \quad = 9 \end{array}$$

Më pas udhëzohen nxënësit të plotësojnë detyrat e dhëna në vijim. Nxënësit e shkëmbejnë punën/detyrën me njëri-tjetrin dhe e krahasojnë detyrën e shokut/shoqes. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi – autori i përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij. (Kontrolli para fluturimit)

Hapi 4

Në detyrën 4 është përshkruar loja, të cilën do ta realizojnë nxënësit në dyshe. Përsëritet veprimtaria disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Kontrolli para fluturimit” - nxënësit do të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit para dorëzimit të mësuesi/ja. Përgjigjet e nxënësve gjatë aktiviteteve në bosh-tin numerik.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Numrat natyrorë	Rezultati i të nxëniet të temës: <ul style="list-style-type: none"> - argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave nga 1 deri në 20; - zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale) .
------------------------------	--

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.3,4,5,6; 5.1. 8.1,2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 8.11 Zbritja nga numri 20

Fjalët kyçe: zbritje, heqje, shenjë, barazim, “Peshqit dhe peshkaqeni”.

Rezultati/et e të nxëniet për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- formon grupet në bazë të udhëzimeve, duke respektuar rregullat e lojës;
- plotëson detyrat e dhëna në tekst, duke u bazuar në kërkesat e dhëna;
- krijon situata duke zbatuar veprimin e zbritjes.

Kriteret e suksesit:

- formo grupet në bazë të udhëzimeve nga mësuesi/ja në lojën “Peshqit dhe peshkaqeni”;
- plotëso detyrat e dhëna në tekst duke u bazuar në kërkesat e dhëna;
- krijo situata duke zbatuar veprimin e zbritjes.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”, ushtrimi në fletë A4.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketat me numrat nga 0-20 për secilin nxënës, fleta A3.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të ngrihen në këmbë dhe të dalin në mes të klasës. I njofton nxënësit me rregullat e lojës “**Peshqit dhe peshkaqeni**”.


- Dy nxënës do të përzgjedhin që të luajnë rolin e peshkaqenit, kurse të tjerët janë peshqit.
- Gjatë gjithë kohës do të kemi vëmendjen tek udhëzimet që jep mësuesi/ja.
- Krijoni grupet sipas udhëzimeve.
- Nxënësit që nuk do të arrijnë të krijojnë grupet do të ulen në banka.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të grupohen 12 minus 6 (6), nxënësit që mbesin pa grupe humbin lojën.

Më pas i udhëzojmë të grupohen 10 minus 7, 14 minus 9 etj.

Hapi 2

Nxënësve u shpërndahet një ushtrim i shpejtë për të ndërlidhur shufrat dhe kubet me numrat përkatës.



Hapi 3

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë detyrat e dhëna në tekst. I ndan secilit grup nga një detyrë. Nxënësit do të punojnë detyrën në grupe, më pas do të shkruajnë në fletë A3 (secili grup detyrën e vet) dhe një pjesëtar i grupit do të prezantojë punën e bërë. Nxënësit do të plotësojnë të gjitha detyrat gjatë prezantimeve të grupeve.

Hapi

Në detyrën 5 është përshkruar loja, **të cilën do ta realizojnë nxënësit në dyshe. Përsëritet veprimtaria disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.**

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Respektimi i rregullave të lojës, të vendosura paraprakisht;
Prezantimi dhe argumentimi i punës së bërë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

TEMA 9: FORMAT DHE ORIENTIMI

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Figurat gjeometrike		Rezultati i të nxënit të temës: - vizaton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 2; 6.1,2,3,4.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 9.1 Llojet e vijave			
Fjalët kyçe: vijë e lakuar, vijë e drejtë, vijë e mbyllur, vijë e thyer.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - identifikon llojet e vijave të dhëna në figurën e tekstit; - plotëson detyrat e dhëna në tekst duke diskutuar në çifte dhe në grup; - realizon aktivitetin duke u bazuar në udhëzimet e dhëna.			
Kriteret e suksesit: - identifikoj llojet e vijave të dhëna në figurën e tekstit; - plotëso detyrat e dhëna në tekst, duke diskutuar në çifte dhe në grup; - luaj lojën, duke u bazuar në udhëzimet e dhëna.			
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fije peri me pesë ngjyra të ndryshme.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë realizimit të aktiviteteve), Shkathtësi për jetë (punimi me fije peri). Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve 4 ngjyra të ndryshme të fijeve të perit dhe i udhëzon të formojnë: ❖ Vijën e drejtë – fije peri të kuqe ❖ Vijën e lakuar – fije peri të kaltër ❖ Vijën e thyer – fije peri të gjelbër ❖ Vijën e hapur – fije peri të verdhë ❖ Vijën e mbyllur – fije peri portokalli Pasi të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit (vlerësimi i ndërsjellë) nxënësit udhëzohen të ngjiten fjetet e perit në fletën A4 (me ngjitës letre) dhe të shkruajnë nën secilën fije, llojin e vijës. Punimet e përfunduara i ruajnë në portfolion individuale.			



Hapi 2

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe zhvillohet një diskutim rreth figurës së dhënë në tekst. Nxënësit vrojtojnë llojet e vijave në figurë dhe u përgjigjen pyetjeve se cilët fëmijë mbajnë litarin që tregon vijën përkatëse.

Më pas, udhëzohen nxënësit të plotësojnë detyrat e dhëna në vijim. Nxënësit e shkëmbejnë punën/detyrën me njëri-tjetrin dhe ata e krahasojnë detyrën e shokut/shoqes. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi – autori i përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij. (Kontrolli para fluturimit).

Hapi 4

Në detyrën 5 është përshkruar loja që do të realizojnë nxënësit në dyshe. Përsëritet veprimtaria disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Kontrolli para fluturimit”- nxënësit do të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit para dorëzimit te mësuesi/ja. Përgjigjet e nxënësve gjatë diskutimit të figurës në tekst.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Figurat gjeometrike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - emërton figurat gjeometrike siç janë: trekëndëshi, katrori, drejtkëndëshi dhe rrethi; - vizaton me dorë të lirë katrorin, trekëndëshin dhe figura të tjera.
----------------------------------	--

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (5), Qytetar i përgjegjshëm VI (6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 2; 6.1,2,3,4.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 9.2 Figura gjeometrike

Fjalët kyçe: figura, katrori, drejtkëndori, trekëndori, rrethori.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- përdor fjalor të thjeshtë matematikor për t'u shprehur për format gjeometrike;
- emërton figurat duke përdorur tipare të tilla, si: numri i brinjëve, të lakuara apo të drejta;
- ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet.

Kriteret e suksesit:

- emërto figurat duke përdorur tipare të tilla, si: numri i brinjëve, të lakuara apo të drejta;
- realizo aktivitetin/detyrën që kërkohet duke ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material;
- kontrollo detyrat e shokut/shoqes pas plotësimit të tekstit.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”, gjëgjëza.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: figura, forma, rrathë, katrorë, drejtkëndësha, trekëndësha, toptha plasteline, shkopinj të hollë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Shkathtësi për jetë (puna me plastelina dhe shkopinj të hollë).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1 U jepet nxënësve gjëgjëza për figurat gjeometrike.

Jam e vogël me tri cepa, më thonë i ke këmbët e drejta, më përdorin si kapele, më vendosin në kordele. (Trekëndësh)

Hapi 2

Nxënësve u shpërndahen figurat gjeometrike dhe kërkohet që pasi të emërtohen ato, të punojnë në mënyrë individuale, derisa të krijojnë me kunga e llastiqe, forma të ndryshme, me madhësi të ndryshme.

Çfarë formash mund të krijohen? Mund të krijohen **katrorë**? **Trekëndësh**? Sa trekëndësha të ndryshëm mund të formohen? A ka ndonjë formë që nuk realizohet dot? (Rrethi) Përse jo?

I tregohet klasës se do të shqyrtojnë sa më shumë katrorë të madhësive të ndryshme në tabelën me kunja. Shkruhet fjala “katror” në tabelë, në mënyrë që të gjithë të kenë mundësi ta shohin. Vizatohet një katror në krah të fjalës. KATROR

Ndërsa nxënësit thonë diçka rreth katrorit, shkruhet ajo që ata thonë dhe ilustron me një vizatim ose diagram. Veprohet njësoj me trekëndëshin, rrethin dhe drejtkëndëshin. U kërkohet nxënësve që të punojnë në tabelën me kunja bashkë me një shok për të gjetur katrorin më të madh dhe më të vogël të mundshëm. Mund të përdoren edhe letrat me pika për t'i shënuar figurat.

Hapi 3

Hapen librat. Në figurën e paraqitur në tekst, nxënësit vrojtojnë format në vizatimin e robotit. Mësuesi/ja zhvillon një diskutim me nxënës rreth formave të paraqitura në robot dhe gjatë diskutimit, nxënësit përgjigjen në pyetjet e dhëna në detyrën e parë.

Më pas, udhëzohen nxënësit të plotësojnë detyrat e dhëna në vijim. Ata e shkëmbejnë punën/detyrën me njëri-tjetrit dhe e krahasojnë detyrën e shokut/shoqes. Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet. Nxënësi – autori i përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij. (Kontrolli para fluturimit)

Hapi 4

Në detyrën 6 është përshkruar loja, **të cilën do ta realizojnë nxënësit në dyshe. Përsëritet veprimtaria disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.**

VLERËSIMI I NXËNËSVE

“Kontrolli para fluturimit”- nxënësit do të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit para dorëzimit të mësuesi/ja. Përgjigjet e nxënësve për zgjidhjen e gjëgjëzës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Trupat gjeometrikë	Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera); - identifikon objekte të ngjashme me kubin, kuboidin dhe sferën.
---------------------------------	---

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (5), Qytetar i përgjegjshëm VI (6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 2; 6.1,2,3,4.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 9.4 Figura gjeometrike

Fjalët kyçe: kubi, kuboidi, sfera, trupat gjeometrikë.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- emërton trupat e zakonshëm duke përdorur tiparet e tyre, si: numri i faqeve, faqe të sheshta ose të harkuara;
- identifikon marrëdhëniet e thjeshta midis formave të trupave;
- përdor trupat për të ndërtuar rregullsi dhe modele;
- krijojn trupa gjeometrikë (kubin, kuboidin dhe sferën) me plastelinë.

Kriteret e suksesit:

- emërto trupat e zakonshëm duke përdorur tiparet e tyre;
- përdor trupat për të ndërtuar rregullsi dhe modele;
- krijo trupa gjeometrikë (kubin, kuboidin dhe sferën) me plastelinë.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: blloqe druri, kuti ushqimesh, konservash, kube druri, complete me trupa gjeometrikë, plastelinë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë amtare (përdorimi i foljeve për përshkrimin e trupave), Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive të marra një ditë më parë. Nxënësve u paraqiten format gjeometrike dhe disa trupa dhe u **kërkohet të tregojnë disa ngjashmëri dhe ndryshime mes tyre.**

Hapi 2

Nxënësit duhet të vendosin enët dhe blloqet për të ndërtuar një strukturë sa më të lartë që të jetë e mundur. Pyeten: Cilat blloqe do të vendosen në bazë? Cilat blloqe do të vendosen në majë? Demonstronhet me anë të formave, ndërsa përshkruhen disa nga vetitë e tyre.

Do të ishte një ide e mirë vendosja e një sfere ose cilindri në bazën e ndërtimit? Pse jo? Ju mund të provohet dhe të zbulohet se çfarë do të ndodhë. Çfarë mendoni se e bën ndërtesën më të lartë? Sipas mendimit tuaj, cila duhet të jetë ena ose blloku që ju duhet të përdorni më shumë? Nxiten nxënësit për të prekur sipërfaqet e enëve dhe të blloqeve, si dhe për të vendosur që të përdorin sipërfaqe të sheshta në ndërtimin e tyre për të pasur një konstruksion të qëndrueshëm.

Zgjidhen disa nga dyshet/grupet e nxënësve që t'u tregojnë nxënësve të tjerë të klasës se si e realizuan ndërtimin e tyre. Për të ndihmuar nxënësit, sugjerohet përdorimi i fjalive model në tabelë, të tilla si: "Ne përdorëm një _____ në bazë të kullës sonë. Ne përdorëm një _____ në majë. Ne përdorëm edhe _____." Bëhen pyetje, të tilla, si: Cila ishte kulla më e lartë që ndërtoat? Si mund të ndërtoni një kullë më të lartë, me më pak enë ose blloqe? etj.

Hapi 3

Hapen librat. Në ilustrimin e paraqitur në tekst, nxënësit dallojnë kubin, kuboidin dhe sferën. Së bashku nxirren karakteristikat e secilës prej tyre dhe **çfarë** i bën të dallojnë nga njëra-tjetra. Udhëzohen nxënësit të plotësojnë detyrat e dhëna në tekst dhe gjatë punës të përdorin kartat me ngjyrat e semaforit, **nëse kanë nevojë për përkrahje nga mësuesi/ja**.

Hapi 4

Në detyrën 5 është përshkruar loja të cilën do ta realizojnë nxënësit në dyshe. Përsëritet veprimtaria disa herë dhe nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Përdorimi i trupave për të ndërtuar rregullsi dhe modele.

Përcakton nga mjedisi rrethues trupa të ngjashëm me ata gjeometrikë.

Realizimi i lojës duke respektuar rregullat e vendosura.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Figurat gjeometrike

Rezultati i të nxënit të temës:

- ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrie.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (5), Qytetar i përgjegjshëm VI (6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 2; 6.1,2,3,4.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 9.6 Simetria

Fjalët kyçe: gjysmë, ndarje në pjesë të barabarta, palosje, shndërrim.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- përcakton gjysmën e një figure, duke u mbështetur te ndarja në dy pjesë të barabarta;
- dallon vijën bazë të simetrisë;
- identifikon marrëdhëniet e thjeshta midis formave.

Kriteret e suksesit:

- përcakto gjysmën e një figure duke u mbështetur te ndarja në dy pjesë të barabarta;
- dallo vijën bazë të simetrisë;
- identifikoj marrëdhëniet e thjeshta midis formave.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: modele me blloqe ose forma kartoni, pasqyra, fletë me kuti.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Shkathësi për jetë (prerja e letrës).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Bëhet një përmbledhje e shkurtër e njohurive të marra një ditë më parë. Nxënësve u shpërndahen fletë me figura të ndryshme dhe u kërkohet palosja me puthitje.

Hapi 2

Prezantohet përpara klasës ideja e simetrisë duke treguar një model të thjeshtë, të bërë nga modelime me figura të cilët janë simetrike nga palosja. Pyetet klasa se çfarë vëren në lidhje me modelin. Udhëhiqet diskutimi, duke u bërë nxënësve pyetje rreth pozicionit të formave.

- A mund të shihni dy forma, të cilat janë së bashku?
- A mund të gjeni dy forma, të cilat janë të njëjta dhe të dyja të formojnë një trekëndësh?

Lëvizni ngadalë sendet nga njëra anë e vijës së simetrisë, në mënyrë që aty të ketë një hapësirë midis dy gjysmave. Pyetni nxënësit se çfarë vunë re.

- A kemi të njëjtat forma si nga kjo anë, ashtu edhe nga ana tjetër?

Vendosni një pasqyrë përgjatë vijës së simetrisë. Kërkojuni nxënësve që të shohin në pasqyrë dhe të thonë se çfarë dallojnë. Ata mund të thonë që e gjithë forma ngjan sikur është e gjitha së bashku. Vendin ku vendosëm pasqyrën do ta quajmë **vija e simetrisë**.

Hapi 3

U kërkohet nxënësve që të plotësojnë faqen përkatëse në Librin e nxënësit, ku fillimisht do të diskutojmë rreth ilustrimit të paraqitur në fillim të tekstit. Vijnë në përfundim se dy krahët e fluturës janë të njëjtë dhe ata puthiten. Pra, mund të themi se krahët e fluturës janë simetrikë.

Nxënësit vazhdojnë detyrat tjera të dhëna në tekst në mënyrë individuale dhe gjatë plotësimit të detyrave përdorin kartat e semaforit kur e ndiejnë nevojën për përkrahje.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të përcjellin udhëzimet e detyrës së 5 dhe nën përkujdesin e vazhdueshëm të mësueses, **të realizojnë aktivitetin që kërkon këta hapa.**

Krijo figura simetrike me prerje.

- a. Palos një letër.
- b. Vizato një vijë si në figurë.
- c. Prit me gërshërë sipas vijës.
- d. Hape pjesën e prerë të letrës.
- e. Dallo dy anët simetrike të figurës dhe vizato vijën e simetrisë.

Nxënësit vendosin punimet e tyre në “Telin tharës” dhe vlerësojnë punimet që plotësojnë të gjitha kriteret.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Plotësimi i detyrave në tekst.

Vlerësimi i punimeve në “Telin tharës”.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Orientimi	Rezultati i të nxënimit të temës: - përshkruan rrugën nga një vend (pikënisja) në një vend tjetër (pikërritja) dhe anasjellas.
------------------------	--

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (5), Qytetar i përgjegjshëm VI (6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2,3,4,5,6.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 9.8 Lëvizja dhe vendndodhja

Fjalët kyçe: lëvizje, drejtim, lart, poshtë, sipër, rreth e qark, nën.

Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- përdor gjuhën e përditshme për drejtimin dhe distancat në përshkrimin e lëvizjes së sendeve;
- identifikon marrëdhëniet e thjeshta midis formave;
- tregon lëvizjen si një zhvendosje nga një vend në një tjetër.

Kriteret e suksesit:

- përshkruaj lëvizjen e sendeve në drejtime dhe distanca të ndryshme;
- trego lëvizjen si një zhvendosje nga një vend në një tjetër;
- vizato rrugën që bën nga shtëpia në shkollë me disa detaje të rëndësishme.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: vetura dhe kamionë lodër, fotografi të tabelave reklamuese të zonës, nëse është e mundur, përndryshe përdorni tabela treguese, si: “Urë”; “Supermarket” etj., etiketa me fjalë e ilustrime.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatimi dhe ngjyrosja e rrugës).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Nxënësve u paraqiten fotografi nga trafiku i qytetit dhe u kërkohet që me imagjinatë, **të tregojnë vendndodhje të mjeteve të udhëtimit**, si dhe kalimin e shpejtë të trafikut në kryqëzim të bllokuar përmes shigjetave (majtas, nën, poshtë, përbri). I kërkohet nxënësve që të dalë përpara klasës. I jepen udhëzime se si mund të realizojnë një udhëtim përreth klasës. Kjo duhet të përfshijë numërimin e të gjithë hapave që ata bëjnë si për të vajtur, ashtu edhe për t’u kthyer. Ndërsa udhëtojnë, duhet të thonë sa herë që ndalojnë: “Unë jam pranë...”. Ndërsa ecin, nxënësit duhet të përdorin: “Unë po kaloj...”.

Hapi 2

Secili nga grupet duhet të marrë 4 ose 5 kamionë/makina në bankat e tyre. Ata duhet ta bëjnë këtë duke ndërruar rolet, që të organizojnë veturat dhe kamionët duke ndjekur udhëzimet nga nxënësit e tjerë të grupit. Nxënësit duhet t’i japin udhëzimet një e nga një. Për shembull, nxënësi i parë mund të thotë:

“Vendose veturën blu përpara”. Më pas, nxënësi tjetër mund të shtojë: “Vendose kamionin e verdhë pas veturës blu”. Nxënësit mund të përdorin lodra të tjera për të formuar vendosje, që ata mund t’i përshkruajnë duke përdorur fjalorin për pozicionin dhe për lëvizjet.

Hapi 3

Më pas, nxënësit do të vëzhgojnë figurën në librin e nxënësit. Ata do të evidentojnë vendndodhjen e objekteve të ndryshme dhe do të tregojnë me vijë në vizatim, rrugën që bën Drilona nga shtëpia për në shkollë.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë në dyshe. Njëri nxënës paraqet me vizatim rrugën që bën nga shtëpia në shkollë. Nxënësi mund të përgatitë harta të udhëtimit të tij. Ai mund të shtojë detaje duke vizatuar rrugën ose tipare të tjera të hartës (tabela e shigjeta drejtimi me etiketa të shkruara). Shoku/shoqja përshkruan rrugën që bën nxënësi i parë duke u bazuar në vizatim. Më pas, nxënësit ndërrojnë rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Përshkrimi i lëvizjes së sendeve në drejtime dhe distanca të ndryshme.
 Vizatimi i rrugës që bën nga shtëpia në shkollë me disa detaje të rëndësishme.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

TEMA 10: ALGJEBRA DHE FUNKSIONI

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë /		Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I Klasa: I
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		Rezultati i të nxënitorëve të temës:	
		<ul style="list-style-type: none"> krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet: më shumë, më pak, aq sa. 	
Rezultatet e të nxënitorëve për kompetencat kryesore të shkollës: komunikues efektiv I (1,3); mendimtar kreativ II (2, 4,7); nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6); kontribues produktiv IV (2,5); individ i shëndoshë V (2,5); qytetar i përgjegjshëm VI (2,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1,3; 3.3,4,5,6; 5.1; 6.1,2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 10.3 Krahasimi i bashkësive			
Fjalët kyçe: kube, më shumë, më pak, po aq sa.			
Rezultati/et e të nxënitorëve për orë mësimore:			
<ul style="list-style-type: none"> grumbullon një grup sendesh në bazë të udhëzimeve; krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve (më pak, më shumë, aq sa); lidh format një për një në bazë të modelit të dhënë; krijon bashkësi në bazë të kërkesës në tekst. 			
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> grumbullo një grup sendesh apo figurash në bazë të udhëzimeve; krahaso bashkësitë e krijuara duke përdorur shprehjet “më shumë”, “më pak” dhe “po aq sa”; lidh format një për një në bazë të modelit të dhënë; krijoh bashkësi në bazë të kërkesës në tekst. 			
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me numra, materiale të riciklueshme, ngjyra, kube, fleta A3.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve).			
Çështjet ndërkurrikulare: arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1. Tregojini klasës kubet bashkuese.			
Ngrini lart letrën me numrin 7.			
Cili është ky numër?			
Sa kube duhen që unë të përfitoj numrin 7?			
Zgjidhni një nxënës që të dalë përpara klasës dhe të mbledhë aq kube sa tregon numri 7. Kemi numrin 7 dhe kemi 7 kube.			
Tregoni numrin 3.			
Cili është ky numër?			

Sa kube duhen që unë të përftoj numrin 3?

Zgjidhni një nxënës që të dalë përpara klasës dhe të mbledhë aq kube sa tregon numri 3.

A kam më shumë kube me numrin 7? Apo kam më shumë kube me numrin 3? Si mund ta gjejmë këtë?

Lejojini nxënësit që të bëjnë sugjerimet e tyre. Ne mund t'i numërojmë ose mund t'i krahasojmë ata. Cila është kulla më e lartë? Kulla më e lartë ka më shumë kube se kulla më e ulët. Kulla më e ulët ka më pak kube se kulla më e lartë. Mund të themi se 7 tregon më shumë se 3, dhe 3 tregon më pak se 7.

Hapi 2. Hapen librat. Nxiten nxënësit të shohin figurën në faqen e *Librit të nxënësit*.

Nxënësit krahasojnë lulet dhe fluturat, duke treguar çfarë ka më shumë e çfarë ka më pak. Të njëjtën procedurë e vazhdojnë edhe me lule dhe nuselale, ku do të tregojnë që lule ka po aq sa nuselale dhe anasjelltas.

Mësuesi/ja u ndan detyrat e dhëna në tekst secilit grup (nëse janë 6 grupe, përsëriten detyrat) dhe, pasi të bëjnë zgjidhjen e tyre, udhëzohen t'i paraqesin në fletë A3.

Një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë.

Hapi 3. Udhëzohen nxënësit të luajnë lojën e dhënë në tekst:

Nxirr një sasi të caktuar lapsash. Shoku ose shoqja jote nxjerr më shumë, më pak ose aq lapsa sa ti.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Grumbullimi i sendeve dhe krijimi i bashkësive; krahasimi i bashkësive në bazë të kërkesës; përdorimi i shprehjeve: “më shumë”, “më pak” dhe “po aq sa” për të krahasuar dy bashkësi; respektimi i njëri-tjetrit gjatë aktiviteteve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: I
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		Rezultati i të nxënësve të temës:	
		<ul style="list-style-type: none"> - paraqet bashkësinë përmes diagramit të Venit; - krijon bashkësi bazuar në cilësitë e objekteve (elementeve). 	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (2, 4,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,6).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1,3; 3.3,4,5,6; 5.1; 6.1,2.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 10.5 Diagrami i Venit
Fjalët kyçe: mbledh, paraqes, grafik, listë, tabelë, klasifikoj, Diagram Veni.
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore
Nxënësi/ja:
<ul style="list-style-type: none"> - grumbullon një grup sendesh apo figurash në bazë të një cilësie ose dy cilësive; - diskuton rezultatet e të dhënave të grafikut; - zgjedh strategjitë e përshtatshme për të bërë llogaritje, duke shpjeguar zgjidhjen e tyre.
Kriteret e suksesit:
<ul style="list-style-type: none"> - grumbullo një grup sendesh apo figurash në bazë të një cilësie ose dy cilësive; - diskuto rezultatet e të dhënave të grafikut; - zgjidh strategjitë e përshtatshme për të bërë llogaritje, duke shpjeguar zgjidhjen e tyre.
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografi të ndryshme ilustruese.
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve).
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja paraqet në tabelë dy rrrathë të mëdhenj bosh dhe shpjegon se në to do paraqiten të dhëna për disa grupe kafshësh p.sh.:

Mësuesi/ja vendos në një vend të dukshëm, foto të disa kafshëve që jetojnë në tokë, në ujë, në ujë dhe tokë.

Nxënësit vendosin brenda rrethit të parë, kafshët e tokës, brenda rrethit të dytë kafshët e ujit. Mbeten pa u futur kafshët që jetojnë edhe në ujë, edhe në tokë. Mund të nisë një diskutim. Disa nxënës kërkojnë



që t'i futim te rrethi i parë dhe disa te rrethi i dytë. Mësuesi/ja ndërhyt duke i zhvendosur pak rrathët dhe duke i treguar se këto mund të hyjnë dhe tek i pari dhe tek i dyti. Ky quhet Diagrami i Venit.

Hapi 2

Hapen librat. Nxiten nxënësit të shohin figurën në faqen e Librit të nxënësit.

Me anë të veprimtarisë, shpjegohet se si bëhet ndarja e frutave duke u bazuar në një dhe në dy cilësi.

Mësuesi/ja u ndan detyrat e dhëna në tekst secilit grup (nëse janë 6 grupe përsëriten detyrat) dhe pasi të bëjnë zgjidhjen e tyre, udhëzohen t'i paraqesin në fletë A3.

Një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë.

Hapi 3

Udhëzohen nxënësit të punojnë Diagramin e Venit të paraqitur në rubrikën “Sot mësova”.

Nxënësit do të diskutojnë në dyshe dhe do të përgjigjen për pyetjet:

- Tregojini klasës se çfarë bëtë dhe se çfarë zbuluat?
- *Çfarë informacioni kishit në dispozicion?*
- *Çfarë duhet të zbuloni në këtë Diagram të Venit?*
- Si e zbuluat se çfarë ju nevojitej të dinit?

Shënim: Sigurohuni që të gjitha diagramet të jenë të etiketuar qartë dhe secili nxënës të kuptojë se çfarë do të thotë kriter klasifikimi.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Diskutimet e rezultateve të të dhënave të grafikut.

Zgjedhja e strategjive të përshtatshme për të bërë llogaritje, duke shpjeguar zgjidhjen e tyre.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Matematikë /	Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: I Klasa: I
Tema: Modelet	Rezultati i të nxënësve të temës: <ul style="list-style-type: none"> · vizaton figurën e radhës duke vëzhguar vargun e figurave paraprahe.
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: komunikues efektiv I (1); mendimtar kreativ II (2,7); nxënës i suksesshëm III (1,2,6); kontribues produktiv IV (2,5); individ i shëndoshë V (5); qytetar i përgjegjshëm VI (6).	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1,2,3,4.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 10.6 Krijimi i modeleve	
Fjalë kyçe: model, rregull, varg, përsëritje.	
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - diskuton për rregullat e përsëritjes së figurave të ndryshme; - krijon modele të ndryshme në mjedisin ku jeton; - zbulon rregullat dhe aplikon modelet në situata të ndryshme. 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - diskuto për rregullat e përsëritjes së figurave të ndryshme; - krijo modele të ndryshme me sende që të rrethojnë; - zbuloj rregullat dhe aplikoj modele në situata të ndryshme. 	
Burimet: Libri dhe fletorja e punës “Matematika 1”.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Matematika 1B, letra të prera me figura të ndryshme, fletë të bardha A4, laps, gomë, ngjyra të ndryshme.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve). Çështjet ndërkurrikulare: arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
<p>Hapi 1 – Aktivitet me figura të pemëve e perimeve</p> <p>Mësimdhënësi/ja ka përgatitur paraprakisht disa figura të pemëve dhe perimeve në copat e letrave të prera. Së bashku me nxënësit diskutojnë për rregullat e përsëritura, me anë të të cilave fitohen modelet dhe në të njëjtën kohë ndërtojnë së bashku modele të ndryshme me radhitjen dhe përsëritjen e figurave nga copat e letrës. Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë rreshtimet dhe modelet e krijuara.</p> <p>Hapi 2. Hapen librat. Nxiten nxënësit të shohin figurën e paraqitur në tekst.</p> <p>Së bashku analizohet ilustrimi në faqen 127 dhe diskutohen e përshkruhen rregullat që janë përdorur. Mësuesi/ja u ndan detyrat e dhëna në tekst secilit grup dhe pasi të bëjnë zgjidhjen e tyre, udhëzohen nxënësit t’i paraqesin në fletë A3.</p> <p>Një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë.</p>	

Hapi 3. Udhëzohen nxënësit që secili të nxjerrë ngjyrat mbi bankë dhe të krijojnë modele të ndryshme. Bashkërisht të gjejnë rregullën që është ndjekur.

Hapi 4. Më pas lihen nxënësit të lirë që të krijojnë modele duke përdorur sende të ndryshme nga ambienti që i rrethon. Detyra e shokut apo shoqes që është afër është të zbulojë rregullën, sipas së cilës është krijuar modeli.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Krijimi i modeleve me materialet e dhëna; zbulimi i rregullës sipas së cilës është krijuar modeli; vlerësimi i shokut/shoqes për punën e bërë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

TEMA 11: MATJET

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Njësitë matëse

Rezultati i të nxënit të temës:

- rendit ngjarje që kanë lidhje me jetën e tyre të përditshme, brenda një periudhe kohore prej një dite, disa ditësh, disa muajsh.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,3,4,5; 2.1,2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 11.6 Ngjarje brenda ditës

Fjalët kyçe: kohë, para, pas, ditët e javës, mëngjes, pasdite, mbrëmje, kohë gjumi, kohë dreke, kohë loje, orë.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- orientohet në kohë, duke përdorur fjalët e duhura në përcaktimin e kohës së shkuar, të tashme ose të ardhme;
- ilustron me shembuj, veprime që kryhen në kohë të ndryshme;
- përdor disa njësi të kohës për të renditur ngjarjet familjare.

Kriteret e suksesit:

- rendit fotot sipas radhës së kryerjes së veprimeve;
- ilustron me shembuj, veprime që kryen në kohë të ndryshme;
- përdor disa njësi të kohës për të renditur ngjarjet familjare.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: figura që përfaqësojnë mëngjesin, pasditen, mbrëmjen, mbrëmjen vonë, letër format A4.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (kohët e foljeve, dje, sot, nesër, ditët e javës).


Çështjet ndërkurrikulare: Globalizmi dhe ndërvarësia (çështjet shëndetësore).

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja mund të përgatitë fotografi, ose ka porositur nxënësit që të sjellin fotografi që tregojnë veprime të ndryshme gjatë ditës.

Shembull



Nxënësit duhet t'i renditin fotot sipas radhës së kryerjes së veprimeve.

Hapi 2

Vendosen dy karrige përballë klasës. Vendoset karta “Mëngjes” në një nga ato dhe kartën “Pasdite” në tjetrën. Lexohet karta një e nga një dhe u kërkohet nxënësve që të qëndrojnë në këmbë, përballë karrigeve, të cilave mendojnë se u përket veprimtaria.

- *Ngrihemi nga shtrati, është një veprimtari mëngjesi apo një veprimtari pasditeje?*

Nxënësit lëvizin për te figura për veprimtarinë e mëngjesit. Disa nga veprimtaritë në listë mund të mos i përkasin ndonjë veprimtarie, p.sh.: “Shkojmë në shtrat”. Kërkohet nga klasa se çfarë do të bënin për këtë.

Nëse nuk ka etiketë, ku mund ta vendosim këtë veprimtari?

Pranohet çdo përgjigje. Nëse “përdorimi i një karrigeje të re” nuk përmendet, pyeten:

- *Çfarë mendoni për një karrige tjetër?*
- *Ku duhet të vendoset karrigia?*
- *Do të vendoset në mes apo në fund?*
- *Çfarë mendoni?*
- *Pse?*

Nxit përdorimin e fjalorit dhe të fjalëve korrekte, të tilla si: “**përpara**”, “**pas**”, “**tjetër**”. Vazhdohet me listimin e veprimtarive, derisa të jenë katër karrige përballë klasës: mëngjes, dreke, mbrëmje, mbrëmje vonë.

Hapi 3

Hartohet një listë të gjërave që nxënësit bëjnë në orë të ndryshme të ditës.

Shembull

Mëngjes: *ha mëngjes, vishem, shkoj në shkollë.*

Pas shkolle: *ha drekë, luaj jashtë shtëpisë, lexoj libra.*

Mbrëmje: *ha darkë, bëj një banjë, shikoj TV.*

Mbrëmje vonë: *shkoj në shtrat, bie të fle.*

Çdo nxënës ka një fletë format A4, të cilën duhet ta palosin në katër pjesë të barabarta.

Në pjesën e parë, vizatohet një figurë të diçkaje që bëni në mëngjes. Në pjesën e dytë, vizatoni një figurë të diçkaje që bëni pas shkolle, më pas përsëriteni veprimin për mbrëmjen dhe mbrëmjen e vonë.

Nxënësit duhet të tregojnë vizatimet e tyre klasës dhe të zgjedhin një orar të caktuar të ditës dhe të tregojnë se çfarë bëjnë ata në atë **orar**. Përdoret kjo si një mundësi për të korrigjuar ose përforcuar gjuhën e përdorur. “Në **mëngjes**, unë laj dhëmbët me furçë”. Duhet të mbulohen të gjitha oraret e ditës.

Hapi 4

Nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet në libër. Për detyrën e dytë, nxënësit do të bëjnë në një fletë tri vizatime, me të cilat do të tregojnë sipas radhës tri ngjarje që ndodhin brenda një dite.

Hapi 5

Nxënësit vendosin punimet e tyre në “Telin tharës” dhe vlerësojnë punimet më që pëlqejnë më shumë.

Shënime: *Vrojtoni për të gjetur se sa mirë identifikuan nxënësit veprimtaritë që ndodhin në një orar të caktuar të ditës. Ç'njohuri të atij orari demonstruan, kur ndanë përvojat me njëri-tjetrin? A ishin të aftë që të përdornin në mënyrë korrekte fjalorin dhe shprehjet gjuhësore që lidhen me atë orar?*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Orientimi në kohë duke përdorur fjalët e duhura në përcaktimin e kohës së shkuar, të tashme ose të ardhme; Ilustrimi me shembuj i veprimeve që kryen në kohë të ndryshme; Përdorimi i disa njësive të kohës për të renditur ngjarjet familjare.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Njësitë matëse	Rezultati i të nxënit të temës: <ul style="list-style-type: none"> - përdor njësi matëse standarde si: m, cm, kg, orë, ditë, javë, muaj, vit dhe të monedhave; - orientohet në kohë duke përdorur fjalët e duhura (p.sh., dje, para një jave, tani, nesër, pas disa ditësh, pas dy muajsh etj.) në përcaktimin e kohës së shkuar, të tashme ose të ardhme.
-----------------------------	---

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3,6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,3,4,5; 2.1,2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 11.8 Koha dhe ditët e javës

Fjalët kyçe: kohë, para, pas, ditët e javës.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- rendit ngjarje që kanë lidhje me jetën e tyre të përditshme, brenda një periudhe kohore prej një dite, disa ditësh, disa muajsh;
- orientohet në kohë duke përdorur fjalët e duhura (p.sh., dje, para një jave, tani, nesër, pas disa ditësh, pas dy muajsh etj.) në përcaktimin e kohës së shkuar, të tashme ose të ardhme;
- ilustron me shembuj, veprime që kryen në kohë të ndryshme.

Kriteret e suksesit:

- rendit ngjarje që kanë lidhje me jetën e tënde të përditshme, brenda një periudhe kohore prej një dite, disa ditësh, disa muajsh;
- orientohet në kohë duke përdorur fjalët e duhura në përcaktimin e kohës së shkuar, të tashme ose të ardhme;
- ilustron me shembuj, veprime që kryen në kohë të ndryshme.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: karta të mëdha plastike me ditët e javës të printuara në to: ditët e shkollës me të zezë, ditët e tjera me të kuqe; lista e ditëve të javës si referencë, e shkruar horizontalisht, karta me çdo muaj të vitit të printuar në një kartë të ndarë.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (shkrimi drejt i ditëve të javës), Edukatë figurative (vizatim dhe ngjyrosje).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja nis një diskutim me nxënësit.

- *Çfarë dite është sot?* Sot është _____.

Tregon kartën që tregon emrin e ditës.

Çfarë thotë kjo?

Sa ditë ka një **javë**? Java ka shtatë ditë.

Unë kam emrat e tyre këtu.

Ngre lart sipas radhës, i tregon klasës cila ditë është dhe i kërkon që ta përsëritin atë.

Zgjedh shtatë nxënës që të dalin përpara klasës.

Secili nga ata të mban nga një kartë dhe i tregon nxënësve se çfarë thotë ajo. Nxënësit qëndrojnë sipas radhës së duhur.

Mësuesi/ja mund të gjejë video në *YouTube* për ditët e javës në linkun e mëposhtëm.

<https://www.youtube.com/watch?v=BdPUKKFmoac>

Hapi 2

Lexohen me zë të lartë dhe kërkon që klasa të bashkohet në kor. Duke përdorur një çantë apo një kuti të madhe, vendosen të gjitha kartat me ditët e javës në të, duke i numëruar ndërsa futen brenda. Një nxënës nxjerr një nga kartat.

Ky është emri i ditës së sotme?

Nëse po, vendoset në vijën horizontale të ditëve të javës, në mënyrë që të mbulojë emrin poshtë. Nëse jo, vendoset ajo në tavolinë.

Zgjidhet një nxënës tjetër që të zgjedhë një kartë tjetër dhe bëhen të njëjtat pyetje derisa të zbulohet emri i ditës së javës.

- *Është përpara apo pas kësaj që është këtu?*

Vazhdohet derisa të gjitha kartat të jenë vendosur sipas radhës së duhur. Lexohen ato dhe kërkohet që klasa të bashkohet në kor.

Hapi 3

Hapen librat. Nxënësit vërejnë detyrat e dhëna në libër dhe pas një diskutimi rreth fotos, udhëzohen të punojnë në mënyrë individuale.

Bëhet korrigjimi individual.

Hapi 4

Mësuesi/ja tregon një kalendar dhe prezanton muajt e vitit. Përsëriten disa herë në kor. Vendos në një vend të dukshëm dhe i rendit sipas radhës. Zhvillohen lojëra të ndryshme për të përvetësuar renditjen e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Renditja e ditëve, e javës, muajt e vitit.

Renditja e ngjarje që kanë lidhje me jetën e tyre të përditshme, brenda një periudhe kohore prej një dite, disa ditësh, disa muajsh.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë **Lënda:** Matematikë **Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I

Tema: Njësitë matëse

Rezultati i të nxënit të temës:

- Përdor monedhat, nga 1€ deri në 20€ për të llogaritur çmimet e sendeve nga jeta e tij e përditshme;
- zgjidh problema nga situata me blerje të njohura për ta.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (1,3), Mendimtar kreativ II (1,2,7), Nxënës i suksesshëm III (1,2,3,4,6), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (2,5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2, 3, 6).

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,3,4,5; 2.1,2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 11.10 Monedhat

Fjalët kyçe: monedha, euro, para, kusur, monedha metalike, kartëmonedha.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- njeh të gjitha monedhat dhe gjen mënyrën si paguhet një shumë, duke përdorur monedha më të vogla;
- eksploron problema dhe gjëgjëza numerike;
- zgjidh problema të thjeshta me fjalë dhe i ilustron me sende;
- kryen këmbime të thjeshta me monedha.

Kriteret e suksesit:

- zgjidh problema të thjeshta me fjalë dhe i ilustron me sende;
- kryej këmbime të thjeshta me monedha.

Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë të fotokopjuara për sasi parash p.sh.: 1 euro , 2 euro, 5 euro, 10 euro, 20 euro, disa lapsa, vizore, goma, blloqe shënimesh.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (komunikimi gjatë aktiviteteve), Edukatë figurative (vizatimi i monedhave), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti (llojet e ushqimeve dhe rekuizitat).

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Bëhet një bisedë për monedhat dhe njohuritë e nxënësve për to. Nxënësit diskutojnë për situata të ndryshme në supermarket dhe ndryshimet e monedhave në monedha metalike dhe kartëmonedha. Vëzhgohen monedhat para dhe prapa. Lexohet gjëgjëza numerike.

Në mëngjes u Çova dhe gjyshit 7 euro për një libër i kërkova. Kush më thotë cilat monedha mora?
(pranohen disa alternativa).

Hapi 2

U tregohet nxënësve se do të duhet të shkojnë në pazar për të blerë disa gjëra për klasën: lapsa të rinj, vizore, goma dhe blloqe shënimesh. Ata bisedojnë me njëri-tjetrin dhe zgjedhin një **çmim** për secilin prej tyre. *Sa mendoni se do të kushtojnë ato?* U jepet koha e nevojshme për diskutim. Mblidhni përgjigjet nga nxënësit. Shkruhen tabela të ndryshme çmimesh, siç janë sugjeruar nga nxënësit. Ndërkohë zgjidhet një artikull dhe vendoset një çmim. Diskutohet: *Do të kushtojë më shumë ose më pak se kjo? Disa gjëra mund të kushtojnë njëjloj sa të tjerat.*

Kur të gjithë artikujt të jenë etiketuar, veprohet me një situatë për të bërë mbledhje dhe zbritje. Për shembull: *Dua të blej dy lapsa, sa do të kushtojnë?* Përsëritet ushtrimi disa herë, duke kombinuar artikujt.

Hapi 3

Veprohet konkretisht me monedha ose fletë të fotokopjuara monedhash. *Çfarë mund të blej me këto? A kam mjaftueshëm? Apo kam më tepër? Sa kusur do të marr?* Diskutohet me klasën çmimi i artikujve dhe çfarë mund të blej nga artikujt e etiketuar të vendosur para klasës. Krijohen situata shitblerjeje ku ata llogarisin sa para kanë në **total** dhe zgjedhin çfarë dëshirojnë që të blejnë. Nxënësit veprojnë duke vizatuar apo shkruar ato që blejnë dhe çmimin e tyre.

Hapi 4

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë detyrat e dhëna në tekst. Mësuesi/ja i ndan secilit grup nga një detyrë. Nxënësit do të punojnë detyrën në grupe, më pas do të shkruajnë në fletë A3 (secili grup detyrën e vet) dhe një pjesëtar i grupit do të prezantoj punën e bërë. Nxënësit do të plotësojnë të gjitha detyrat gjatë prezantimeve të grupeve.

Hapi 5

Në klasë, bëhet një dyqan për lojë, ku nxënësit të jenë ose shitës ose blerës. Kërkohet që të argumentojnë si situata problemore marrëdhëniet midis shitësit dhe blerësit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Prezantimi dhe argumentimi i punës së bërë.

Vizatimet e gjësendeve që blejnë, çmimin e tyre dhe këmbimet.

Argumentet për situata problemore, marrëdhëniet midis shitësit dhe blerësit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

TEMA 12: TË DHËNAT DHE PROBABILITETI

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla e kurrikulës: I / Klasa: I
Tema: Puna me të dhëna	Rezultati i të nxënit të temës: - lexon të dhënat e grumbulluara në tabelë dhe i paraqet ato në grafik dhe anasjelltas.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (2), Nxënës i suksesshëm III (1,6), Kontribuues produktiv IV (5), Individ i shëndoshë V (5), Qytetar i përgjegjshëm VI (6).		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1,2,3,4; 7.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: 12.1 Klasifikimi dhe regjistrimi i të dhënave		
Fjalët kyçe: kohë, para, pas, ditët e javës.		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - grumbullon grup sendesh apo figurash në bazë të një cilësie ose dy cilësive të përbashkëta; - diskuton rezultatet e të dhënave të grafikut; - zgjedh strategjitë e përshtatshme për të bërë llogaritje, duke shpjeguar zgjidhjen e tyre.		
Kriteret e suksesit: - grumbullo kubet sipas ngjyrës; - numëro kubet me nga dy ose me nga pesë; - shkruaj në tabelë të dhënat e grumbulluara; - shpjego zgjidhjet e gjetura gjatë punës.		
Burimet: Libri dhe fletore pune “Matematika 1”.		
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube me ngjyra të ndryshme, ngjyra, fleta A3.		
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë amtare (argumentimi gjatë diskutimeve), Edukatë figurative (ngjyrat, format, vizatimi i tabelave). Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Hapi 1 Prezantohet veprimtaria duke u treguar nxënësve si mbushen të dyja duart me kube. Pyetet klasa se, sipas mendimit të tyre, sa kube ka marrë. Merren disa përgjigje dhe më pas pyeten se si e gjetët. Mund: - T’i numëroni; - T’i seleksiononi sipas nga ngjyrës, të numëroni çdo ngjyrë dhe më pas të bëni totalin; - Numëroni në grupe dyshe ose pesëshe dhe më pas t’i numëroni me hapa të rregullt me nga dy ose me nga pesë. Pasi të keni provuar secilën rrugë, nxitet një diskutim se cila rrugë mendojnë ata se ishte më e thjeshta dhe pse? - A ishte ajo një zgjidhje e mirë? - Përse jo?		

Tregohet klasifikimi i tyre duke u nisur nga ngjyrat dhe nga numërimi. Tregohet numërimi në grupe të një numri të dhënë. Kjo mund të mos jetë e përshtatshme për disa nxënës, të cilët janë në hapat e parë të numërimit.



Hapi 2

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën e dhënë në tekst dhe bashkërisht me nxënësit zhvillon një diskutim se si mund të bëjmë grumbullimin e të dhënave.

Për të grumbulluar të dhëna rreth luleve, veprojmë në këtë mënyrë:

- grupojmë lulet sipas ngjyrave;
- numërojmë lulet e çdo grupi;
- shkruajmë në tabelë të dhënat e grumbulluara.

Hapi 3

Nxënësit ndahen në 3 grupe dhe mësuesi/ja i ndan secilit grup nga një detyrë. Nxënësit do të punojnë detyrën në grupe, më pas do të shkruajnë në fletë A3 (secili grup detyrën e vet) dhe një pjesëtar i grupit do të prezantojë punën e bërë. Nxënësit do të plotësojnë të gjitha detyrat gjatë prezantimeve të grupeve. Gjatë punës, ata mund të përdorin kartat me ngjyrat e semaforit për të kërkuar ndihmë apo sqarim shtesë.

Hapi 4

Udhëzohen nxënësit të ndahen në dyshe dhe të realizojnë rubrikën “Luajmë së bashku”

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Grumbullon, zbulon ose klasifikon grup sendesh apo figurash në bazë të një cilësie ose dy cilësive të përbashkëta (ngjyra, forma, trashësia etj.). Përdor piktogramet; Diskuton rezultatet e të dhënave të grafikut; Zgjedh strategjitë e përshtatshme për të bërë llogaritje, duke shpjeguar zgjidhjen e tyre.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

Referenca:

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2018), Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (e rishikuar).

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2018), Udhëzues për zbatimin e kurrikulës, i rishikuar, prill, 2018.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2018), Plani dhe Programi lëndor për klasën e parë në arsimin fillor në Republikën e Kosovës (i rishikuar).

Vlerësimi Formativ, BEP/MASHT, botimi i ri, 2013.

Vlerësimi sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca, Udhëzues për mësimdhënës, MASHT/ USAID, botimi i parë, korrik, 2016.

Matematika dhe mësimdhënia e matematikës, Udhëzues për klasat 1-5, GIZ- KEC (2012).

<https://www.scribd.com/document/382821308/BEP-Udhezues-Vleresimi-Sipas-Kurrikules>

http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/06/21-st-Century-Classroom_shq1.pdf

<http://www.cdbe.info/wp-content/uploads/2015/08/Matematika-dhe-mesimdhenia-e-matematikes-per-klasen-5.pdf>

